ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 3 PRILL 2021. NUMËR 124 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Isha me Skënder Luarasin në rreshtat e para të sallës. Ai e kishte parë Erenburgun në një mbledhje shkrimtarësh revolucionarë në Spanjë, – Heminguej, Malro, plot të tjerë.-Qenka plakur ca,- tha Skënderi. Ai ishte atëherë 54 vjeç dhe si me kurriz; me fjalën të avashtë, që gjatë Luftës ia ndizte flakë reportazhet, ndofta me keqardhjen se në Shqipëri nuk do të mund të kalonte më shumë se tri ditë, apo i lodhur, më së fundi, duke bredhur frontet prej mijëra kilometrash.

ILIA ERENBURGU NË SHQIPËRI

(fq. 2)

Nga Dhimitër Shuteriqi



"Të gjithë njerëzit e mi", i autorit nga Mali i Zi, Zuvdija HODŽIĆ

NJË ROMAN QË KOMUNIKON ME BOTËN SHQIPTARE

Nga Gëzim Puka (fq.7)

Gjëmimi i rënkimit të Margarita Xhepës

Nga Enver Kushi (fq.12)

MARGARITA XHEPA, zonja e madhe e skenës dhe filmit shqiptar, lindi më 2 prill të vitit 1934, sapo pranvera kishte hyrë në muajin e saj të dytë. Ndoshta protoprilli i atij viti në Lushnje, ka qënë me qiell të pastër apo dhe me re të bardha, që vinin nga hapësirat e paana të fushës së Myzeqesë dhe pasi kalonin mbi qytetin e vogël, iknin tutje kodrave të buta.

MARIA ANTONIA BRAILE, POETESHA E PARË ABËRESHE DHE LIRIZMI I SAJ

Nga Klara Kodra (fq.11)

Narracioni dhe aspekte të ndërtimit të tij në novelën "Studenti në shtëpi" të Migjenit (fq. 13)

Nga Fjorentina Balla

PJETËR BUDI DHE POEZIA E KAOSIT

Nga Behar Gjoka (fq. 5)

BIBLIOTEKË

Ismail Kadare — *Ur-Libri* (fq. 14)

Delvina Kërluku — *E di që ëndërron* (fq. 15)

Gentiana Minga — *Poezi* (fq. 16)

Samanta Schweblin — *Dyzet centimetër katrore* (fq. 20)

Stefan Çapaliku — *Po sikur të kem qenë spiun* (fq. 18)

Poetë amerikanë — *Përkthyer nga Roland Gjoza* (fq. 19)

Romani "Gjin Bardhela i arbresh & etja e gurëzuar" i Anton Nikë Berishës në 52 këndvështrime

(fq. 10)

Nga Ajete Zogaj

SI TA USHQESH MUZËN

ese nga Ray Bradbury

S'është e lehtë. Askush s'e ka bërë përgjithnjë. Kush përpiqet më shumë se të gjithë, e tremb për vdekje. Atë që e shpërfill dhe bredh duke fishkëllyer lehtë, ajo e dëgjon duke e ndjekur në heshtje nga pas, e joshur nga një lloj përçmimi i matur dhe i shfaqur me kujdes. Sigurisht që po flasim për Muzën. Termi sot ka dalë nga përdorimi i përditshëm. (fq. 22)

(fq. 22)

Dy romane të rinj në librari

Një histori dashurie *Romeo dhe Zhuljeta* afrikane

"Me lumin midis" i shkrimtarit kenian

NGŨGĨ WA THIONG'O

botuar nga "Arka e Noes" (fq. 21))

IGINIO UGO TARCHETTI

Në kthetrat e dashurisë

Nga Botimet "POLIS" (fq. 17)

Namik Dokle: Gora, pasqyrë ku reflektohet bota

Intervistë dhënë gazetarit boshnjak Almir Zalihiç

(fq. 8)

ILIA ERENBURGU NË SHQIPËRI

Kujtime të pabotuara nga Dhimitër Shuteriqi

Ilia Erenburgu ishte i pari shkrimtar i dëgjuar botëror që vizitoi Shqipërinë pas Çlirimit të vendit. Ka qenë fillimi i tetorit të vitit 1945.

Ai vizitonte atë kohë Jugosllavinë dhe u muar vesh tani gjendej në Mal të Zi. Në Tiranë po krijohej Shoqëria e Miqësisë Shqipëri-BS. A nuk e thërresim Erenburgun të vijë e të përshëndesë Konferencën? Ai nuk e bëri të gjatë, po me një kusht: që kjo kthesë nga Shqipëria të mos e pengonte që, për 2-3 ditë, të kalonte në Maqedoni. Erdhi e foli. Foli rusisht; e përkthente Koço Tashkoja. Është fotografia tek flasin të dy mbi skenën e teatrit.

Isha me Skënder Luarasin në rreshtat e para të sallës; ai e kishte parë Erenburgun në një mbledhje shkrimtarësh revolucionarë në Spanjë, – Heminguej, Malro, plot të tjerë.

-Qenka plakur ca,- tha Skënderi.

Ai ishte atëherë 54 vjeç dhe si me kurriz; me fjalën të avashtë, që gjatë Luftës ia ndizte flakë reportazhet, ndofta me keqardhjen se në Shqipëri nuk do të mund të kalonte më shumë se tri ditë, apo i lodhur, më së fundi, duke bredhur frontet prej mijra kilometrash. Është fotografia e tij tek flet e përkthen Koço Tashkoja. S'kujtohem se ç'tha, e marr me mend. Një fjalë e një sallë që duartroket në këmbë. Po riprodhoj ca rreshta që do të botonte për Shqipërinë tek "Izvestia" e Moskës e 30 tetorit 1945, për të treguar se si e pa Shqipërinë:

"Të gjitha gërmadhat i ngjasin njëra-tjetrës, po pse ka kaq gëzim në Shqipëri? Vendi është krejt i shkretuar nga lufta. Ai ka qenë tokë bejlerësh, koloni italiane. Këndi mrekullueshëm, – male, liqene, lugina të lulëzuara. Bregdeti i Adriatikut, – kryqëzim popujsh e kulturash, gërmadha qytetesh të lashtë, mermere të Romës, kupola të Bizantit, minare të Islamit. Nuk e çliroi njeri, u çlirua vetë."

M'u desh ta shoqëroj mikun nëpër Tiranë. Në Pazarin e Vjetër, që do të bëhej Pallat i Kulturës, – sot qendër biznesesh, – hahej çuditërisht mirë, po dhe çuditërisht keq në atë Pazar. Në një si guvë, mund të haje fërgesën me famë të Tiranës, që nuk hahej e mirë aq nëpër restaurantet e hoteleve "Internacional" apo "Dajti". Në rrugë kërcisnin çekanët e kallajxhinjve apo teneqexhinjve, sikur zbrazeshin mashinka e mitraloza. Te pallati që nisi të ngrinte Zogu majë kodrave dhe që e mbaruan fashistët italianë gjatë pushtimit, miku gati m'u grind:

-Ç'më solle këtu?

Ai kishte parë me qindra të tilla "vila të borgjezëve të pasur" nëpër botë. Në artikullin që përmenda, shkruan:

"Nga vendi i Donatelos e i Mikelanxhelos, as tablora, as libra... Luksi përqendrohet në dhjetë apo njëzet tualeta shumëngjyrëshe."

Për të qeshur, i propozoj të flejë atë natë në krevatin e perandorit Emanuel III. Edhe ai shkulet gazit:

-Ishte xhuxh! Do të më shpifet natën.

Dhe nxitojmë e ikim, se po i lutet kujdestari i pallatit me gjithë mend. Në krevatin e perandorit flinte, sigurisht, partizani Meke, me sa rrëfen Dritëroi.

Erenburgu ishte i nxituar të zinte Maqedoninë, ku e kishte ftuar poeti Denko Markovski, të cilin e quanin "themelues të letërsisë maqedone". Gjë më se e rrallë të shohësh një themelues letërsie në mes të shek. XX. Pandehja se e kam shpënë në Krujë, e paskësh ngjitur në Petrelë, me siguri ditën që u nisëm për në kufi, në Qafë Thanë.

I kisha thënë se, duke kaluar nga Elbasani, vendlindja ime, do ta ngjatjetonte një dramaturg i yni, që e kisha lajmëruar.

-Me dramë po e nisni letërsinë tuaj?-më pyeti dhe, për pak, desh e mora si shaka.

-Jo,-i thashë,-e kemi nisur përpara shek. XIV këtë letërsi, që e ka njohur një murg francez më 1332 të paktën. Librin e parë e kemi botuar më 1555."

Atij i hipi një të kuq e më kërkoi ndjesë, pas një shtangie.

-Rri edhe një ditë më shumë, kthehem sonte në Tiranë, po të më tregosh ata libra në Bibliotekën tuaj të shtetit,-më tha.

Известия Советов депутатов трудящихся СССР, [газета], 1945, № 281 (8891), 30 ноября

ПЯТНИЦА, 30 НОЯБРЯ 1945 г. № 281 (8891) ИЗВЕСТИЯ СОВЕТОВ ДЕПУТАТОВ ТРУДЯЩИХСЯ СССР 3

Работа комитетов подготовительной комиссии организации Об'единенных наций

ЛОНДОН, 28 ноября. (ТАСС). Во второй половине дня 28 ноября состоялось первое заседание комитета № 2 (комитет Совета безопасности). Председатель Николас предложил, чтобы раздел первый отчета Исполнительного комитета, в котором дают-

бы постоянные члены Совета безопасности напрвляли своих начальников штабов или назначали своих представителей, которые должны будут встречаться в определенное время и в определенном месте. Собрание этих начальников штабов или их предста-

деятельность перед Национальным собранием. Депутаты ответственны перед избирателями и могут быть ими отозваны. Статья 4-я проекта конституции предусматри-

национальному флагу. В православных, мусульманских и католических храмах происходили торжественные богослужения. На площади Скандербега состоялся митинг.

туры, господствовавшей с 4 июля 1943 года».

Комитет вынес решение созвать в январе 1946 года с'езд национально-демокра-

Международный антифашистский женский конгресс в Париже

ПАРИЖ, 29 ноября.(По телеф. от корреспондента ТАСС). Сегодня Международный антифашистский женский конгресс продолжал свою работу под председательством Долорес Ибаррури. Председатель-

Заседание Учредительного Собрания Югославии

Югославия провозглашена Федеративной Народной Республикой

БЕЛГРАД, 29 ноября. (ТАСС). Сегодня здесь состоялось заседание обеих палат Учредительного Собрания. Обе палаты заслушали доклады мандатной комиссии и без обсуждения утвердили их. После при-

ходят к маршалу Тито и поздравляют его. Маршал Тито поздравляет председателей палат Симича и Видмара. В зале звучат слова государственного гимна. Депутаты с большим под'емом поют боевой гимн «Гей,

ет департамент почт и телеграфа Аргентины в том, что он не разрешает свободную пересылку по почте газет «Интрансихенте», «Эль диарио» и «Либертад».

Иранская газета о провокационной деятельности Сеид Зия-эд-Дина в Иране

ТЕГЕРАН, 27 ноября. (ТАСС). Газета «Неджате Иран» в передовой статье от 26 ноября пишет, что сейчас очень многие депутаты осознали, что враждебная Советскому Союзу пропаганда, проводимая в Иране по подстрекательству Сеид Зия-эд-

Facsimile e gazetës "Izvestia", № 281 (8891), 30 nëntor 1945

Илья ЭРЕНБУРГ

В Албании

Когда проезжаешь по странам Европы, всюду видишь страшные следы фашистского лихолетья. Все* развалины похожи одна на другую. Но почему так радостно в Албании? Ведь здесь есть развалины, страна опустошена войной. Радостно потому, что в огне и в дыму боев родилась Албания. Она была итальянской колонией, землей беков-помещиков, она стала свободным государством.

Прекрасный край — горы, озера, цветущие долины. Побережье Адриатики — перекресток народов и культур, остатки античных городов, мрамор древнего Рима, минареты ислама, купола Византии. Народ един, но долго разделяли его религиозные распри: две трети населения — мусульмане, треть — христиане, из них часть—православные, часть — католики. Мало городов. Есть патриархальные старые города, как Эльбасан, полные восточных чар. Базары, где торгуют цветистыми коврами и голубыми бусами украшают осликов, кофейни с дремлющими завсегдатаями, древние мечети, и там затейливыми буквами выведены на стенах сентенции, похожие на стихи. Есть и старая Тирана, такая же путаная, сказочная.

А рядом с нею — новый город: большие квадратные здания, чересчур просторные площади, чересчур широкие улицы, чересчур пышные колонны—вкус фашистской Италии, ее мания величия. Впрочем, новая Тирана пригодилась: во дворцах разместились и парламент, и министерства, и библиотеки.

Об одном дворце стоит поговорить. Его начал строить авантюрист Зогу, который хозяйничал долго в Албании. Строил, но пожить в нем не успел, — обновил итальянский империализм. На стенах фашистские гербы, безвкусные барельефы. Можно в точности изучить, как пала страна Донателло и Микель Анджело под владычеством пуле: не картин на стенах, ни книг, нет даже шкафов для книг—только шкафы для бутылок, а роскошь в одном—двух десятках разноцветных уборных. Может быть, этот дворец красноречивее всего говорит о культурном уровне колонизаторов и итальянских фашистов.

Были свои беки — и свирепые, и невежественные: феодал Мевкед владел одной третью всех земель Южной Албании. Он запрещал строить в Эльбасане новые дома, хотел жить во дворце рядом с лачугами. Он впустил в Албанию итальянских оккупантов. Теперь он спокойно разгуливает по улицам Рима. Вероятно, последнее озадачит читателей. Я не дам никаких об'яснений, я только добавлю, что другой фашистский сатрап — Мустафа Крум, бывший премьер-министр марионеточного правительства, который по приказу из Рима об'явил войну союзникам, также проживает в Италии.

Народ Албании мужественно боролся против сильной немецкой армии. Воистину достойно восхищения: над Тираной высится гора Дайтит, на ней партизаны недалеко от столицы разбили немецкую дивизию, которая спешила на выручку гарнизона.

Я разговаривал со многими отважными людьми и не стану сейчас пересказывать их скромных и, однако, бесподобных исповедей. Я только хочу подчеркнуть, что если албанский народ вдохновлялся борьбой Красной Армии и если он учился партизанской войне у своих соседей—югославов, то никто его не освободил,—он освободил сам себя. Отсюда в нем гордость, отсюда радость, отсюда ощущение достоинства, которое передается приезжему и которое придает особенную прелесть и горам, и городам, и людям.

Во главе освободительной армии стоит генерал-полковник Энвер Ходжа. Это — молодой энергичный человек, большой культуры и большой скромности. Он кончил университет в Монпелье, был преподавателем в средней школе. Его все знают и все любят, даже в самых отсталых горных деревушках люди говорят: «Энвер выгнал захватчиков, Энвер поможет наладить жизнь».

Через несколько дней—выборы. Впервые албанцы могут свободно выразить свою волю.

Предвыборная кампания превратилась в огромную демонстрацию народного единства. Отдельные реакционеры агитируют за бойкот выборов. Это — крупные торговцы и представители католического духовенства. Главным образом, иезуиты, издавна укрепившиеся в Скодре. Нужно отметить, что мусульманское и православное духовенство поддерживает правительство. Позицию католического духовенства можно бы об'яснить страхом перед аграрной реформой, но это об'яснение недостаточно. Ведь не только католические монастыри затронула эта реформа. В конечном счете албанские иезуиты ведут себя наивно, один поделился со мной своими надеждами: мусульманки не пойдут на выборы. Разве не очаровательна ставка господина в сутане на женщину в чадре? Однако эти надежды напрасны. Муллы в различных селах говорили мне, что мусульманки, как и мусульмане, увлечены предвыборной кампанией и не будет среди них воздерживающихся от голосования.

Для турок, а потом для итальянцев Албания была колонией, — брали, но не давали. Народ жил убого. Война разорила и без того небогатых крестьян. Захватчики отбирали овец, коз, рубили масличные деревья. Засуха больно ударила по народу. Но умная политика первого народного правительства дала результаты: за короткий срок восстановлены все взорванные мосты, работает много фабрик. Захватчики увезли большое количество ассигнаций, и это помогло укреплению албанского франка, так как правительство провело регистрацию банкнот, находящихся в стране. Курс албанского франка высок: 25 франков за доллар. В магазинах есть товары, и на базарах много всякой живности, оливкового масла, фруктов, вина. Крестьяне носят самотканную одежду, но нехватает шерсти и кожи. Есть горести, есть трудности, однако по сравнению с другими послевоенными странами Албания живет не плохо.

В селе Петреле зашел я в один крестьянский дом. Мужчин не было. Зять старой Хамиде в армии. Были невестка и внуки. Сидели мы на полу у огня. Над огнем неизменно висит медный кувшин, в нем кипятят воду для кофе. Медные тазы, большие глиняные кувшины, сохранившие чистоту линий античных амфор. Хамиде угостила нас душистым кофе, фигами, орехами. Это — средняя крестьянская семья. На десять едоков — семьдесят масличных деревьев, четыре смоковницы, две овцы и две козы. Я спросил старую Хамиде, чем отличается новый режим от режима Зогу и оккупантов. Передаю точный ее ответ:

— Об этом спросите моего внука, ему восемь лет, он вам ответит, а мне даже стыдно отвечать на такие глупые вопросы.

Я видел в деревне школу. Ее недавно открыли. Девочки и мальчики корпели над тетрадями. Видел собрание молодежи — восторженные лица. Слышал клятвы: построим народную Албанию. Разве это не чудо? Война, разорившая столько городов, обратившая государство сверхчеловеков в нагромождение руин, родила на краю Европы новое свободное государство.

Албанская литература молода. Турки не признавали албанского языка, итальянцы его отменили. Зачинателями албанской поэзии были Фаноли и Фиштра. Первым большим романом был Кристофорадий. Теперь расцвет албанской литературы. Выходит много книг, выходит литературный журнал. Слышал я первый хор, исполняющий народные песни, видел первых художников. Здесь часто слышишь это определение: первый день Албании только занимается. В государственной библиотеке было пять тысяч томов, теперь свыше ста тысяч, и в большой зале я видел молодежь, которая сидит над книгами.

Рождается албанская интеллигенция. Народ, влюбленный в свободу и добывший эту свободу ценой крови, ревнив. Он лелеет свою армию. У некоторых солдат нет обуви, но у них хватит мужества и боевого опыта. Был я в кадетской школе. Там учатся сироты, отцы которых погибли в боях, а также дети, принимавшие участие в партизанской войне. Будут у албанцев и сапоги, и хорошие офицеры. Может быть, скептика не удовлетворят ни поэты, ни кадеты. Что же, можно добавить, что в этой маленькой стране открыто двести сорок новых школ. Можно добавить, что еще год назад не знали албанские рабочие, что такое профессиональные союзы, а теперь синдикаты об'единяют двадцать пять тысяч трудящихся. Можно добавить, что я не видел женщин в чадрах. Можно добавить, что крестьяне получили керосин и букварь, плуги и свободу.

Мало кто из албанцев видел русских, про Красную Армию знают из газет, из рассказов. Бесконечно далеко от Тираны до Москвы, но для сердца нет верст. Видел я в деревнях портреты И. В. Сталина, видел портреты Героев Советского Союза казахов, татар, узбеков, вырезанные из журналов. Слышал задушевные слова: «Красная Армия и нас спасла». Слышал восторженные крики: Сталин — Москва.

Я должен сказать, что любовь маленького числом и большого сердцем албанского народа меня глубоко взволновала,— любовь к моей стране, к советскому народу. 7 ноября население Тираны пришло к зданию, где находилась советская военная миссия. Была черная, еще полетнему теплая ночь. Албанцы пришли с факелами и, разжигая, они ударяли пламенем о землю, а потом выше подымали факелы, и множество огней в черной ночи как бы выражало страстность народной любви.

После матча в Глазго

Из всех четырех встреч, которые имели советские футболисты в Англии, пожалуй, самой трудной была последняя — с командой «Рэнджерс». Игра потребовала от московских динамовцев большого физического напряжения.

Во вчерашней корреспонденции я уже говорил о том, что временами игра носила резкий характер. Вот какой вид имели московские динамовцы после матча: голова Семичасного забинтована, Карцев волочит ногу, Бесков хромает. Карцев, забивший вчера оба гола в ворота «Рэнджерса», еле ходит. У Хомича рука на перевязи, а все тело его покрыто синяками и ссадинами. Да, ничья была боевой!..

Вчерашние вечерние и сегодняшние утренние газеты Глазго и Лондона печатают большие отчеты о матче. «Дейли геральд» дает обширную информацию о встрече под заголовком: «Проигрывая 2:0, «Рэнджерс» сумел свести матч вничью». Газета оценивая итоги поездки московских динамовцев, пишет: «Общее преимущество в десять мячей говорит о высоком качестве советских футболистов». «Дейли мирор» указывает: «Московская команда «Динамо», закончив свое турне, может вернуться в Москву довольной своими результатами».

Реймонд Клейденинг, спортивный комментатор, который вел вчера радиопередачу на английском языке, согласен с тем, что второй одиннадцатиметровый удар, который судья Томпсон после совещания со своим помощником дал в ворота динамовцев, был назначен несправедливо.

Вчера вечером нам было передано письмо от мэра города Глазго, в котором он пишет:

«Многие тысячи людей Шотландии наполнили стадион «Айбрукс парк» и были очарованы московской командой «Динамо».

От жителей Глазго жителям Москвы и Советского Союза я посылаю сердечный привет и шлю наилучшие пожелания футбольному клубу «Динамо». Я выражаю надежду, что клуб «Динамо» будет иметь большие успехи в будущем».

Через несколько дней московская команда «Динамо» возвращается на родину.

Вадим СИНЯВСКИЙ.

ЛОНДОН, 29 ноября.

Библиотека им. Н. А. Некрасова electro.nekrasovka.ru



Librat tona të para s'kishin lënë asnjë rresht. Kohët e pamëshirshme kishin lënë vetëm një kopje të librit tonë të parë të botuar, që ruhej në Bibliotekën e Vatikanit. Ai më vështronte dhe s'fliste dot.

Në Elbasan nuk më kujtohet a e pimë një kafe me Et'hem Haxhiademin, që na priti me disa intelektualë. Një Faik Haxhiymer u paraqit se kishte luajtur rolin e Harpagonit të Molierit.

-Të kishte qenë në Paris,-i them mikut, - do ta kishin duartrokitur si një Dylen (Dulin – artist i madh i kohës në Francë).

Miku kërkoi sërish falje. Po kur i tregova se teatri ynë profesionist sapo ishte krijuar, ai tha:

-Mos dyshoni për "profesionistin", që ju paska lindur; shpejt bëhet burrë.

Unë vetë s'i njihja ende Loro Kovaçin, Marie Logorecin, Naim Frashërin me të tjerë.

Kur në Elbasan morëm rrugën për në Qafë Thanë, Erenburgu më tha:

-Dramaturgët i kam zili, që s'guxoj të shkruaj për skenën. Ti më paske lexuar "Juri Jureniton", që s'e prisja të jetë lexuar nga një shqiptar. Libri i parë shqip qenka shkruar "për dashurinë e popullit tuaj", më the. Dramaturgu që njohëm, për çfarë shkruan?"

I tregova se shkruan për "Andromakën".

-Si Rasini (Racine)?- u habit.

-Drama në vargje,-i thashë.

U mendua gjatë.

-Luhen?- pyeti.

-I ka luajtur teatri amator, do t'i luajë profesionisti,-iu përgjigja.

Shkumbini ishte kuqërruar mirë nga shirat e vjeshtës.

-Ky lumë e ndan Shqipërinë mespërmes,- e këmbeva bisedën unë.

-Thuaj shoferit që të qëndrojmë diku për të ngrënë drekë, se më griu. Fajin e kam vetë, që nuk qëndrova të hanim drekë me dramaturgun tuaj, i cili na ftoi. Po më mirë të hamë sa më pranë kufirit maqedon.

Te Hani i Hoxhë Karriqit në Përrenjas, jahnia ishte e famshme vërtet, "fameuse" –"e famshme" i shpjegoi ime shoqe hoxhës. Ajo erdhi me ne që nga Elbasani, ku banonte akoma. Miku la mendtë pas shakave të hoxhës pa çallmë e të bërë akçi.

Majë shkëmbit pranë, te xhamia, ishte çelur shkolla. Fëmijët, të reckosur, "po sa të bukur!" Mësuesi edhe më i reckosur se nxënësit, një imcak. Erenburgu nuk i mbajti dot lotët.

Me ata lot e kapërceu kufirin, ku e prisnin dy-tre vetë, po s'e priste Markovski. U përqafuam dhe s'e morëm vesh a e kuptoi që nuk e priste Markovski, që e kish ngutur aq. Uli kokën e i ra bereta; u kollit fort me llullën që i tymoste.

E kam njohur atë dhjetor Denko Markovskin në Hotel "Moskva" të Beogradit, kur isha atje bashkë me Mitrush Kutelin. Hante në një tavolinë pranë nesh, koran nga të liqenit të Ohrit. E kuptoi se ishim shqiptarë dhe na u paraqit.

E pyeta:

-si nuk e prite në kufi Ilia Ehrenburgun, që ish aq i ngutur takohej me të?

Ai u shkri në gaz, një gaz prej babaxhani eksentrik.

-Po s'është themelues i ndonjë letërsie, i shquari mik!-m'u përgjigj nëpër gaz.

M'u duk e gjetur shakaja.

-Po ju, si vini me themelimin e letërsisë shqipe, themelues të nderuar?-më pyeti ai flakë për flakë.

-Kjo është një histori e njohur që nga shek. XIV të paktën!-iu përgjigja unë po ashtu pak me inat.

Ai tregonte koranin me kurrizin të xhveshur e mërmëriti, i pataksur:

-Peshku i prillit!

Pandehte se bëja shaka.

Aty më parë, lexova një antologji të poezisë maqedone të botuar në Paris: nga editori i famshëm Gallimar (Gallimard). Denko Markovski mungonte me vjersha dhe me emër. Di se, i arratisur nga Jugosllavia, ai vdiq herët në Bullgari. Poezia e të arratisurve, po dhe ajo e të mërguarve që s'ktheheshin në atdhe, kishte nisur të ndalohej në republikat socialiste të Ballkanit. E kuptuam nga biseda, se Markovski nuk duhej të ishte në rregull me regjimin e Beogradit. Kur na pyeti se ç'na kishte sjellë ne buzë Danubit me ato

ILIA ERENBURG DHE PABLO PICASSO, 1966





murlane dhe i treguam se ishim ftuar për në Kongresin e Shkrimtarëve të Jugosllavisë, ai u shkul në gaz e tha:

-Mua nuk më ftuan. Po ju, që nga tri ditë rrugë, s'kishit si ta merrnit vesh se nuk bëhet kongresi i shkrimtarëve jugosllavë. Po hani në "Moskva" trofta nga të Ohrit, se vinë të gjalla me aeroplan.

Me Ilia Erenburgun jam takuar dhe nja dy herë. Në Moskë, në një kongres të Lëvizjes Botërore të Paqes, pasi ishim prishur me BS. Erenburgu, që ma kish harruar emrin, nuk ma kish harruar fytyrën. Këtë herë, kur më dha dorën, më tha, me një si qortim të hidhur:

-Ju mori djalli, more shqiptarë kokëfortë!

Ilia Kopalini, kineasti që ishte bërë mik i ngushtë i Shqipërisë, ishte dhe ai në atë kongres, po s'na avitej. Kur na shihte korridoreve, nxitonte të bënte prapakthehu. Si do të na jepte dorën? Ai kishte bërë më se dy filma mbi Shqipërinë. I qendiste. Sheshi Skënderbej i Tiranës, fill pas Luftës, zor se shkelej nga pesë vetura në ditë; Kopalini mblidhte veturat e Tiranës, në mos edhe të Durrësit, dhe i bënte të vërtiten me minuta të tëra rreth "gropës" së atij sheshi prej kryeqyteti, që "nuk binte prapa të tjerëve të Evropës". Njerëzia bënin sehir si bëhej filmi dhe admironin kryeqytetin e tyre si kishte për për të qenë në të ardhmen.

Më kishin vënë në presidium, – si vinin nga një për çdo shtet të përfaqësuar në atë mbledhje. Që nga fundi i sallës së madhe të pallatit të ri e modern të Kremlinit, që më duket se e përuroi Kongresi i Paqes, m'u pa si një siluetë e njohur: Nazim Hiqmeti, që mbahej në krah të një gruaje të re bjonde. Ai ishte rimartuar me një sovjetike. Erdhi dhe u ul gati pranë meje, duke përshëndetur me kokë. Nxitoi që nga salla të vinte e ta përshëndeste një shkrimtar nga Antilet Franceze, me të cilin njihesha, po që s'ia kujtoj tani mirë emrin (Dépré?). Ishte poet e kishte dëshirë të vizitonte Shqipërinë, po s'e kishim ftuar. Këtë radhë nuk ma përmendi dëshirën, po më tregoi me dorë, duke i thënë Nazim Hiqmetit:

-Ndofta nuk njiheni, ju prezantoj: është shkrimtari nga Shqipëria shoku aty",- dhe përmendi emrin tim, që s'e shqiptonte dot saktë.

Nazimi më përshëndeti me dorë, "gëzohem".

Kaloi atë çast përpara nesh Ehrenburgu, me llullë në gojë, që nxitoi e më dha mua dorën të parit, përpara se të përqafohej me Nazimin, "salut, albanais!"

Këmbeva karrige dhe i shtrëngova dorën poetit të madh turk, që t'i thosha pastaj se e kishim pritur në Shqipëri (e kishim ftuar me kohë).

-Ditë e lumtur për mua,- nisa bisedën,- vargjet tuaja bëjnë furore në Shqipëri".

-E kam dëgjuar shqipen, është tingëlluese, ka edhe fjalë nga turqishtja. S'e kam marrë përkthimin shqip të vjershave të mia, -hapi duart me keqardhje ai.

Ne ishim mjeshtër për të tilla impolitesa.

-Deshëm t'jua bënim surprizën në Shqipëri, - e rregullova unë gafën.

Më kërkoi ndjesë: atij nuk i lejohej të udhëtonte me avion; me tren ishte tepër larg për të; nëpër Bosfor e Dardanele, dihej se e kishte "jasak". Vdiq pas një moti a dy nga një infarkt tjetër, në Moskë (1963), Bedredini i ri turk. I vjetri kishte qenë një si dervish luftarak i madh i shek. XV, për të cilin Nazimi kishte shkruar një poemë.

Ehrenburgu do të vdiste më '76. Ai u bë edhe më i njohur më 1954, me "Shkrirjen", vepër me të cilën "do të nisnin të shkrinin akujt" në letërsinë sovjetike, siç e pritën në vendin e sovjetëve dhe nëpër botë. Romani i tij më i shquar mbeti "Rënia e Parisit", të cilën ai e kishte jetuar më 1940, kur ushtria e Hitlerit paradoi nëpër Harkun e Triumfit. E kam jetuar edhe unë atë kataklizëm. Duhen rilexuar fatosat shkrimtarë, që e bënë shpatë penën. Do të vijoj ndonjë ditë me Bedredinin.

ILIA ERENBURGU VIZATUAR NGA PABLO PICASSO

Romani "Shkrirja" (Оттепель), vepër me të cilën "do të nisnin të shkrinin akujt" në letërsinë sovjetike



ILIA ERENBURGU ME ALBERT EINSTEIN



PJETËR BUDI DHE POEZIA E KAOSIT

Nga Behar GJOKA

Kënga e dytë titullohet: "Këtu duo të thom pak fialë n që/ përmenduni që Mortësë e adhështiet/ e n që panjohuni që njerëzet", e cila ka gjithsej nëntëdhjetë e tre strofa me katërvargësh, që përbëjnë treqind e shtatëdhjetë e dy vargje. Kënga e dytë hyn në vjershat më të gjata të autorit. Më tepër se sa numri i vargjeve, nuancat rrëfimore të shtrira dhe të larme, ndihmojnë për të parë maketin e një vjershe të zgjatur, që bart brenda vetes bërthamën e një poeme homilike, sidomos nga prania e disa elementëve:

A – Thyerje rrëfimore, të kapërcimit nga njëra gjendje në tjetrën, pa humbur linearitetin e rrëfimit tregimtar.

B – Vagulli subjekti, që lëviz në qarkun: njeri, me moral të prishur, Perëndia, që verifikon gjithçka, kaosi ose fundi i botës, i merituar, që shpalon konfliktualitetin e përjetshëm midis mëkatit dhe pastërtisë morale. Në vargjet:

Aty s'prune begati,
As vistar të lëvduom,
As urtë a diekëqi,
As gurë ta paçëmuom;
(1986:65),

ku në trivargëshin bie në sy përdorimi i anforës, një stilemë poetike emocionale dhe ritmike, që në tekst sjell dy elementë:

-Numërimin e shkallëshkallshëm të vlerave të humbura.

-Sjellja në pikën e parë, pra duke e rimarrë idenë, veçse për ta përplotësuar kuadrin e shkretimit.

Anafora e funksionalizuar artistikisht, fiton vlerë edhe nga përdorimi i antitezës semantike, që gjurmët e tilla, fiksohen në vargun e tretë, si antitezim i mirëfilltë: urtë dhe diekëqi. Figurshmëria e ngjeshur në këto vargje, si dhe emocionaliteti i dëshmuar, konfirmojnë vlera të qenësishme të ligjërimit poetik në krijimtarinë e Budit. Prania e kësaj figure edhe në vergjet pasardhëse tregon se autori nuk e përdor rastësisht atë figurë. Në dy strofat e tjera thuhet:

Aty s'prune madhështi,
As dinje me ligjëruom,
As vertyt as trimëni,
As vetiu me ndihmuom;

Aty s'prune zotëni,
Kual të bukur as të çpejtë,
As dinje gjak e gjeni,
As të mirëtë as të keqtë;
(1986:67).

Tripleti poetik i këtyre tre strofave, përveç përdorimit funksional të anaforës së njëpasnjëshme, bart edhe rimarrjen në pozicion nistor të çdo strofe, që është e njëjtë.

-Konture figurash, natyrisht të universalizuara: njeriu (pa emër), ama (mëma), zoti(drita), që vijëzohen si portrete simbolike.

Sadoqë subjektiviteti autorial gjendet i mbishtresuar në çdo episod, në çdo ngjyresë, edhe si përbuzje ndaj njerëzve felëshues, edhe si përnderim e nënshtrim ndaj Zotit, nuk arrin të mbulojë kurrsesi fytyrëzimin epik (si epil) të këtij krijim, madje subjektiviteti i pohuar edhe si un identifikues i priftit-poet, e rrit ndjeshëm peshën gravitacionale të vjeshërimit të autorit.

PRIMATI POETIK

Tek kjo poezi motiv primar është kaosi, në të gjitha dimensionet ekzistenciale, në të gjitha akset e universalitetit gjallnues, në ethet e tjetërsimit dhe ringjalljes, zhgënjimit dhe besimit, vdekjes dhe jetës, ku si pikë referenciale është njeriu, të cilit Budi i drejtohet, ndër të tjera:

O i pafati njeri,
Gjithë ndë të keq harruom,
I dhani ndë madhështi,
Ndë mkat pshtiellë e ngatërruom;
(1986:65),

ku nga njëra anë shpreh dhimbjen dhe sublimitetin kreativ, përmes pasthirrmës së vargut të parë, një klithmë personale e thjeshtë, tejet njerëzore, që e vendos në aksin e humanitetit, dhe nga ana tjetër, vjen kundërvënia, menjëhershëm, ndaj tij, gjithnjë, për shkak të përqafimit të së keqes, së mbrapështive njerëzore. Thënia e tillë, pra, nëpërmjet kundërvënies së pranëvënë, është njëra nga dukuritë poetike të vetiakësisë budiane, të cilat evidentojnë edhe përthyerjet e befta emocionale edhe të mesazheve që përcillen.

ANAFORA SI FIGURË

Trajtat poetike, përveç se të hapura dhe të thjeshta, në disa raste vijnë edhe përmes figurave sterotip të arthënies poetike, si në vargjet e cituara më sipër. Madje ajo vihet në fillim të strofimit me sintagmën: "Aty s'prune", një trajtë ligjërimore e rrafshit bisedor, por që dallohet në gjërësinë e fushëpamjes që ofron:

-begati, ëndrra e merituar për njerëzit,

-madhështi, shkëlqimin e nevojshëm për jetesë,

-zotëni, dinjitet i domosdoshëm i ekzistencës së qenieve njerëzore, që shihet se përbëjnë tre binaret kruciale, të ekzistencës së njerëzores.

Pohimi i tyre, pranëvënia e humbjeve dhe mungesave të vetive morale, në kundërvënie zemërake, e largon, jo pak, ligjëratën nga trajta fetare, dhe, natyrshëm, e zbret në strukturën e ligjërimit intim, si një bashkëbisedim mes vllaznish, të poetit me njerëzit, pra, duke vënë kështu vulën e gjurmëve poetike befasuese.

PORTRET AMËSOR

Veçanërisht strofa e pestë dhe e nëntë e kësaj poezie ravizon edhe portretin fluid, amësor, që fiksohet në dy çaste:

a - Lindja e njeriut, gjithnjë, si qenie universale.

b - Ardhjen e zhurmshme në jetë, që mbetet unike për çdo foshnjë.

Përnderimi ndaj amës, që zakonisht, kryen edhe aktin e sakrifikimit, për të realizuar ardhjen në jetë të njeriut, është, pothuajse, e përafërt me nderimin që ka për krijuesin, TënZot. Afria, befasuese që bën poeti midis amësisë dhe dritës së Perëndisë është edhe tregues i tendencës për ta universalizuar ndjenjën amnore, që rezulton, gjer më tash, si kryesensualiteti njerëzor dhe ndjesia më e qëndrueshme. Këto vargje janë një pjesë e vogël e poezisë, nga më të bukurat, qoftë si artikulim, qoftë si shprehësi, të cilat shpalojnë vetëdijen autoriale në lëmin e ligjërimit poetik, po aq edhe vlershmërinë e përcjellur prej asaj kohe e gjer më sot, si atribut i mirëfilltë i vlerave artistike:

Ku janë ata pleq bujarë,
Qi qenë përpara ne,
E ata trima sqimatarë
Të çpejtë si rrufe?

Ku janë ata djelm të ri,
Të bukur të lulëzuom,
Qi pate pamë me sy,
Me ta fol e ligjëruom?

Ku janë ata perandorë,
Gjithë shekullit nalcuom
Mbë krye me një kunorë
Gurëshi të paçmuom?

Ku janë ata letërorë,
T'urtë e dies të ndëgjuom,
Të bardha posi vdorë
Letëra tue kënduom?

Ku janë ata zotëni,
Qi doinë me zotënuom,
Ndë sqimë e ndë madhështi,
Këtë jetë tue shkuom?

Ku janë ato gra e vasha,
Ndë sqimë e ndë madhështi,
Me petëkat të mëndafshta,
Nalcuom mbë zotëni?

Gjithë mortja i rrëzoi
Sikur i pret me shpatë
Për të ri s'i shukoi,
As të vobeg, as të begatë.
(1986:85).

Libri i parë i Budit, posaçërisht *Doktrina e kërshtenë* daton si botim në vitin 1618. Shtegtimi kohor, siç shihet, i ka kapërcyer katër shakujt, të komunikimit me lexuesit. Kjo ndjesi, realitet që tashmë identifikohet, nuk krijohet rastësisht, por është pjesë e truallit universal, e dobisë së bukurifaljes dhe, mbi të gjitha, një përjetim personal, origjinal si kompozim, një shestim vetiak, për gjëmën që kishte kapluar atdheun në shekullin XVII-të.

MOTIV I PASTËR BIBLIK

Vargjet e poezisë fokusojnë kaosin, si epiqendër të "merituar" për njerëzit që dinë veçse të mëkatojnë, madje pa kurrfarë vrasje ndërgjegjeje. Por duke mbetur brenda vorbullës gjigande kaotike, si një fragment esencial i saj, mu aty, mjeshtërisht, ndërkallet kaosi dinamik, që vjen përmes tablosë poetike budiane, sendërtuar në dy pamje, tronditëse dhe konkrete, në raportim kundërshtie me shoshoqen që, herazi, shkojnë deri në përjashtim ekstrem, të cilat në vargjet e mësipërme parashtrohen në dy forma:

Së pari: Mikrobota e unit poetik, tejet e pikëlluar për humbënajën e pakthimit të njerëzve.

Së dyti: Makrobata reale e njerëzimit, ku përfshihet, edhe ajo e atdheut të shembur nga mortja shkatërrimtare e pushtimit, që përplotëson unin e shqetësuar të krijuesit.

Pamja dyfish e mbingarkuar, si nëntekst i mbishtresuar, por bashkëshoqëruar edhe me kuntrapuktin e befasishëm shprehës, paraqet, afërsisht, imazhin e Shqipërisë pas pushtimit, gjë që kishte sjellë ankth dhe tmerr në popull, zi dhe kob në shpirtin e priftit poet…

PORTRETET E PREFERUARA

Gjashtë strofat e para, që ekspozojnë, veçmas dhimbjen e poetit, jo vetëm si artific poetik, por si gjendje mirëfilltas e stërpërjetuar, skalisin përmasat e humbjes përmes portreteve njerëzore:

-"pleq bujarë" me thelbin cilësor të theksuar, si "trima sqimatarë",

-"djelm të ri" me përveçimin e thukët, "Të bukur të lulëzuom",

-"perandorë", që projektuan dhe ngritën "Gjithë shekullin nalcuom"

-"Letërorë" (shkrimtarë) të mëdhenj " T'urtë e dies të ndëgjuom",

-"zotëni" të njohur (e jo pak të pa njohur) "Ndë sqimë e ndë madhështi",

-"Gra e vasha", si zana mali "Me petëkat të mëndafshta".

Të gjitha këto elementë paraqesin një format kohor të caktuar dhe të plotë. Hedhja e vështrimit, për një çast, në kohën tjetër, të dikurshmen, e afërt për Budin, që ende gjallonte gojarisht, e përcaktuar nga poeti si "shekulli nalcuom", identifikon tingëllimën e drejtëpërdrejtë të qëndresës shqiptare, në mbrojtje të atdheut dhe të Krishtërimit, duke ofruar kështu përfytyrimin e kohës së Skënderbeut që, edhe pse nuk përmendet, e ndeshim si nënshtrat i nënkuptuar i kaosit kozmik, që u ra për hise shqiptarëve, pas asaj periudhe. Humbja e shumëfishtë dhe gjurmëlënëse në deformimin e njerëzve të asaj bote jo imagjinare, përkundër, konkrete dhe gërryese, ia ka errur shikimin, veç se, mrekullisht, për ta tejndriçuar shkretimin…

SHKATËRRIMI PËRFUNDIMTAR

Përballë këtyre portreteve, të shtjelluara linearisht në vetëm gjashtë strofa, vërtet të madhnueshme, jo vetëm si konceptin fizik, por edhe si përshtesëzim logjik i grupacioneve të popullit, poeti rrëfen tashmë, si një fakt të prekshëm, me përmasa kozmike dhe të hiperbolizuara, mjerimin total; "Gjithë mortja i rrëzoi", si një tonifikim gjëmues dhe alarmant i realitetit tokësor të atdheut të shuar dhe të fikur, jo veç si parandjenjë e ankthshme e poetit. Kundërvënia dhe pranëvënia e këtij momenti kulmor poetik, menjëherë pas portretimit, shkallëshkallshëm, të kohës së ardhur gojarisht, si anektoda, legjenda, rrëfenja etj. , është një nga gjetjet poetike, përmbyllëse dhe kozmike, si konceptim autorial, jo fort të shpeshta në letrat shqipe…

STRUKTURIMI POETIK

Përkujdesja e nevojshme dhe e mjaftueshme artistike, kualitet vetëdijësues personal, duket edhe në kompozimin e materies poetike, si struktim i ngjeshur, i përbërë vetëm nga dy hallka :

A – Realiteti i shkretuar, përtharë gjer në shuarje, që zë dhe pjesën kryesore të fragmentit, njëkohësisht, tërësia e saj parashtron dhe përgatit ardhjen e episodeve të tjera.

B – Konkretizimi i fundit total, pluridimensional, i ngjeshur artistikisht në një strofë të vetme, veç se me një peshë specifike gravitacionale, tejet rënduese.

Hallkat strukturore poetike, gjenden në marrëdhënie të ndërsjella, sipërfaqësore dhe organike, njëherit, janë ngjizur si pozicionim i dytë, përjashtim i shoshoqshëm, me një formëzim konvencional të harmonisë disharmonike. Kompozimi poetik si i tillë, përveç prirjeve vetiake, pra të Budit, shpalon gjurmë moderniteti klasik në ligjërimin poetik në gjuhën shqipe…

FIGURSHMËRIA E VARGJEVE

Dimensioni autentik, para së gjithash, ekziston si realitet i figuruar ose si shkërbim i dyfishuar i realitetetit jetësor. Në rastin e pozisë, që po shqyrtojmë dhe, sidomos të vargjeve të fragmentit ilustrues, edhe nga një verifikim sipërfaqësor, dëshmohet fare shkoqur denduri dhe tepri figurshmërie. Opusi poetik budian vjen mjaft i larmishëm si substancë, mirëfilli figurativ :

-antiteza është figura themltare e kompozimit të poezisë,

-pyetjet retorike, si një parashtrim i shtrirë në poetikën e autorit, këtu ndihmojnë për të shprehur visaret e përmallimit personal,

-enumeracioni përshkallëzues, raportim logjik artistik, që, veçanërisht portreton njerëzit dhe kohën e dikurshme,

-epitet e tipit: "pleq bujarë", "trima sqimatarë", etj. , të cilët cilësojnë dhe skicojnë prototipa të njasaj periudhe,

-metaforat e gjedhës: "shekullit nalcuom", "mortja i rrëzoi", që sugjerojnë dhe krijojnë tablotë e kundërvëna,

-krahasimet tipike: "të çpejtë si rrufe", apo "të bardhat posi vdorë" të cilat, jo vetëm evidentojnë dukuri të realitetit, por artikulohen si shprehësi me ligjërimin autentik të brumit të shqipes,

-rimarrja e fillimvargut: "Ku janë ata…" për të konkretizuar ritmin shkatërrimtar, pasojë e aritmisë subjektive që synon dhe sendërgjon autori.

Mikrotabloja stilistike, e qëmtuar lehtësisht si figurshmeri, shpërfaqet jo veç si llojllojshmëri, por edhe si domëthënie funksionale, duke zbuluar poetikën autoriale, që mbruhet dhe ngjishet me figuracion të mirëfilltë letrar…

VJERSHËRIM I PËRFUNDUAR

Vargjet e kësaj poezie, përpos figurshmërisë së dëshmuar, janë edhe një sprovë shenjë e përpunuar dhe e përfunduar e vargëzimit të natyrës ligjërimore të gjuhës shqipe. Kjo sepse poezia si strukturë tërësore, por edhe si njësi më të vogla poetike, kompozohet me elementë tipikë të ligjërimit artistik të gjuhës sonë, nga të cilat mund të veçohen disa prej përbërësve:

-strofa katërshe (kuatrena), si strukturim linear i gjithë poezisë, madje, edhe pjesës dërrmuese të vjershërimit budian,

-metrikë harmonike, që presupozon dhe përfshin tërësinë dhe qelizat pjesore të saj, si rregullsi,



-rimë e alternuar (ABAB), pothuajse, në të gjitha vargjet ku bie në sy përdorimi i zanoreve:

-ë, përkatësisht, në tetë raste,

-i, respektivisht, në tetë raste,

-e, vetëm në dy raste,

-a, po ashtu në dy raste,

si dhe diftongu :

-uom, përkatësisht në tetë raste,

-tetërrokëshi trokaik, si strukturë e njëtrajtshme, si dhe tërësore.

Dhe të gjitha këto ndikojnë ndjeshëm për të krijuar ritmikën sipërfaqësore ose muzikalitetin e jashtëm, si një atribut i poezisë së këndim/këngëtim/leximit. Siç shihet, elementët bazë kompozues të thadrimit poetik të autorit në këtë vjershë, njëherazi, janë edhe themelitë e vjershërimit klasik, oral apo të kultivuar, të ligjërimit poetik në gjuhën shqipe…

TETËRROKËSHI SI PARAVAJTJE DHE PASVAJTJE

Përdorimi i vargut me tetë rrokje në të 2922 vargjet nga ana e Budit, përveçse preferencë poetike autoriale, tregon edhe për ngurtësinë e kësaj forme shprehjeje në traditën gojore poetike, si shprehje e ngulitur e botës që e rrethon, si dhe të makrobotës arbënore. Kjo përputhje, rrokëjesoro-metrike, tërësore e krijimtarisë poetike të autorit, shpalon dhe fakton vetëdijen artistike për vlerat dhe shprehësinë e vargut me tetë rrokje, sepse:

-është mjet shprehës i ngurtësuar,

-është rregullsi artikulimi, natyrisht, orale deri tek poeti,

-përtypej lehtë nga lexues/dëgjuesi.

Përputhja shtron nevojën dhe dobinë e kundrimit të vjershërimit në gjuhën shqipe, realizuar me anë të vargut tetërrokësh, së paku në dy momente:

1 – Poezia parabudiane ose fokusimi i paravajtjes në përdorimin e tij, si mjet shprehës emocional dhe artistik. Verifikimi i folkorit poetik, pavarësisht kufijve hapësinorë dhe kohorë, sjell rezultate impresionuese. Vargu tetërrokësh, trokaik, rezulton si mjeti adekuat i poezisë epike, lirike apo liriko-epike, të krijuar nga bardi popullor.

2 – Krijimtaria poetike pasbudiane evidenton përdorimin e gjerë të kësaj mënyre vjershërimi, duke filluar nga Bogdani, Jul Variboba, Konstandin Berati, pasardhësit më të afërt të autorit të Doktrinës, Pasqyrës dhe Ritualit, duke vijuar pastaj me letërsinë e bejtexhinjve, pa përjashtim, e lëvrojnë tetërrokëshin trokaik. Për të ardhur në poezinë e majave të letërsisë së kaluar, posçërisht, vepra poetike e De Radës, N. Frashërit dhe Gjergj Fishtës, që përbëjnë "tercinën poetike atdhetare", më të fuqishme, deri më sot, të kurorës letrare në gjuhën shqipe. Madje, reminishenca, jo pa vlerë të lëvrimit të këtij lloj vargu, feksin edhe në poetikën e shekullit të njëzet, pikërisht, me Çajupin, Asdrenin, Mjedën, Santorin, Poradecin, e deri tek poetë të letërsisë pas Luftës së Dytë Botërore, si Agolli, Trebeshina, Camaj, Shkreli, Podrimja etj. Pra, lëvrimi poetik me tetërrokëshin trokaik, më tepër preferencë e poetëve të veçantë, në këtë rast edhe vetë Budit, është një brum origjinal, gjenetik, i shprehjes poetike, në natyrën e shqipes.

LEKSIKEMA SEMANTIKE

Në rrafshin e përpunimit të fjalës, si semantikë leksikore e parapërpunuar stilistikisht, ku, gjithsesi, zbulohen disa shtresëzime, përgjithësuese dhe të përveçme, që sjellin pranë lexuesit botën e dikurshme shqiptare, përmes stilemash të larmishme:

-fjalë gjë gjëllojnë ende, të tipit: pleq, trima, perandorë, kunorë, zotëni (zotëri), gra, vasha, mortja, shpatë, begatë, madhështi, etj., të cilat janë njëherit të ligjërimit bisedor dhe libror,

-fjalë dialektore, si: vobeg, djelm, krye, dies, vdorë, sqimë, sqimatarë, petëkat, nalcuom, etj. , që sot ende ekzistojnë në ligjërimin bisedor, veçse, dikur, pra në kohën e Budit, ato kanë qenë të ligjërimit letrar,

-semantika e shumësit, siç është rasti i përdorimit të përemrit ne, si shumësí emërore apo trajta e shumësit të bartur edhe tek mbiemrat,

-semantika e njëjësit, siç ngjet me përdorimin emërzues: Gurëshi, ku njëjësi nënkupton shumësin.

Sintagmat leksikore të funksionalizuara në përdorimin e tyre nga poeti, të larme dhe polivalente, treguese dhe konotative, japin të qartë vetëdijen e definuar, si akt i përzgjedhjes letrare leksikore, gjithnjë, për të përshtresëzuar dhe mbishtresuar poezinë, si art që presupozon njeriun dhe i drejtohet atij.

“Të gjithë njerëzit e mi”, i autorit nga Mali i Zi, Zuvdija HODŽIĆ

Një roman që komunikon me botën shqiptare

Nga Gëzim Puka

“Të gjithë njerëzit e mi”, romani i autorit malazez Zuvdija HODŽIĆ, që vjen në sistemin tonë letrar i përkthyer, do të thoja mjeshtërish, nga Dimitrov Popoviq, mbush një hapësirë të mirë të nevojës që ka lexuesi i sotëm shqiptar për letërsinë e fqinjëve tanë të ngjashëm. Letërsia bashkëkohore malazeze këtë autor e ka vendosur në majat e saj, por për ne si dhe për shumë lexues të tjerë shqiptarë, ai është ende i panjohur. Kjo mosnjohje e një shkrimtari, që shkruan në gjuhën e fqinjëve malazezë, deri tani është justifikuar me faktorë jashtëletrar, por për fat erdhi koha të shijojmë prodhimin e freskët letrar të njëri-tjetrit.

Kur prek me sy një tekst të panjohur dhe befasohet nga ai, lexuesi çuditërisht ndihet i lumtur, për arsye sepse shpeshherë letërsia e mirë befason dhe lumturon njëkohësish. Kjo ndjesi të shoqëron deri në faqen e fundit, ndërsa shijon leximin e romanit.

E përtypëm veprën dhe ligjërimin e saj në shqip, por me këtë rast edhe ndonjë shkrim kritik të bërë për të, qoftë në pasthënien nga Et’hem Mandiq, qoftë edhe nga ndonjë recensent tjetër, duke vërejtur se ka diçka të magjishme që e lidh këtë ligjërim, jo vetëm tematikisht me botën shqiptare, por edhe për nga teknika narrative, mënyra se si e prodhon artin e fjalës ky autor dhe si fjala artistike rrezaton në kontaktin me ne. Për të mos përsëritur me citueshmëri, mund të ndalemi vetëm tek një aspekt gjuhësor, që spikat në prurjen përkthimore të kësaj vepre. Konkretisht është misteri i këndvështrimit në këtë vepër letrare, sidomos misteri se kush po rrëfen në roman.

Mendojmë se lexuesi empirik do ta kishte përgjigjen e shpejtë: është autori. Në një rast tjetër do ta trajtonte si vepër memoristike. Në pikëvështrimin tonë, është shumë më tepër se kaq. Dikush këtu e ka trajtuar këtë rrëfimtari si të ngjizur me njëmendësinë bektashiane, që rreket të paraqesë një lloj ndërmejtësimi të diskurseve religjioze, aq të ndryshme në Bjeshkët e Namuna, ku duket se më së shpeshti është skena hapësinore e këtij rrëfimi.

Si çdo tekst letrar i prozës së gjatë edhe romani “Të gjithë njerëzit e mi” i ka të dyja shtresat që përbëjnë një vepër letrare: historinë dhe rrëfimin. Duket se kjo e dyta, lidhet drejtpërdrejtë me pozicioni që zë autori, i cili na ngjan se në raport me lexuesin shqiptar ka krijuar një lidhje afërsie. Janë pikërisht lidhjet e brendshme emocionale e kuptimore nëpërmjet thënieve të rrëfimtarit dhe personazhit, që drejtojnë këtë komunikim. Le të citojmë një fragment në nisje të kreut 17.

Ja si i drejtohet autori lexuesit:

“A të kam treguar për Sheh Aganë? Njeri i mirë, tregtar i pashëm dhe i ndershëm, ka dhënë veresie, ka ndihmuar fukarenjtë, i matur, i ka besuar gjithkujt. Njeriu i mirë njihet në ditë të zymta. I erdhi një malësor që të blejë dy kile sheqer, ky ia peshoi, ndërsa u mendua...u mendua, kërkoi edhe dy.

- *E, unë nuk mund të shes më, - i tha Sheh Aga.*
- *Si nuk mundesh! Po shih se ke?*
- *Ja ku e ke këtë pranë meje, Shqepon. Blije tek ai! Le të fitojë edhe ai diçka”*[1]

1 HODŽIĆ, Zuvdija, “Të gjithë njerëzit e mi”, “Onufri”, Tiranë, 2017, f. 106

Ky lloj rrëfimi i subjektivizuar krijon një afërsi më të prekshme me lexuesin. Në këtë roman marrëdhënia e autorit me lexuesin duket e thjeshtë në pamje të parë, por në të vërtetë është shumë e përpunuar, pasi në vepër mbizotëron rrëfimi shumështresor, ku krahas zërit të autorit ndihet edhe zëri i shumë personazheve të tjera. Veç lojës vetore, në vepër ka edhe një alternim mjeshtëror të kohëve të foljeve, si dhe njëfarë shkallëzimi, që formohet mes kohës së tashme dhe kohëve të së shkuarës, sidomos kohës së kryer. Mund të theksojmë se thyerja e rrëfimit përmes kalimit nga e kryera në të tashmen është një mundësi e mirë për krijimin e botës së magjishme të veprës, por edhe mënyra më e ndjeshme për të krijuar lidhjen emocionale midis autorit dhe lexuesit. Në përdorimin e këtyre kohëve rrëfimtare ka një analogji me Ciklin e Kreshnikëve (aq të përhapur në Ballkan), të cilin autori e ka përdorur edhe si paratekst në një nga historitë e tij.

Po citoj:

“Edhe atë pasdreke dolëm shëtitje. Rrugica jonë u shkretua. Menjëherë, sikur dolën nga pylli, në rrugë dy meshkuj. Pos të tjerash, ecin, shihen, e kemi të qartë se janë nga anët tona dhe megjithëse njëri është më i bëshëm...Janë vëllezër. Duke u tallur, me gjysmë zëri shqiptova vargjet nga “krajishnikat”[2]*.*

Erë nuk ka, por bjeshka gjëmon
Ja ku kemi Mujin e Halilin...

Më dëgjuan dhe të çuditur u ndalën.

“Kush jeni dhe nga na njihni?”- disi i pasigurtë pyeti më i moshuari.

“Jemi tanët”.

U njohëm, folëm, pranuam të kthejmë një kafe. Bisedën e kemi vazhduar në çajtoren që kishim më afër. Kemi folur si më të njohurit e vjetër. Njerëz të thjeshtë dhe shpirtmirë, të vetmuar, dëshiruar për shoqëri dhe për biseda. Mujo dhe Halil Duraku u gëzuan se janë takuar me ne. Edhe ne na erdhi bukur dhe mirë. Gati me një naivitet fëminor dhe çiltërsi kanë folur për vete si me njeriun më të afërt, nga janë dhe pse kanë ardhur në Gjermani.

Kanë ardhur sapo është përzier puna në Bosnjë. Janë nga Kladusha, nga Krajina, bjeshka e gjakosur, nën Kunarë, bjeshkën e gjelbër tamam si Hrnjica Mujo dhe Halil, për trimërinë dhe famën e të cilëve di gjithkush. Gjyshi ua ka dhënë emrat, që nipat të ngjajnë me ta. Jo për luftërat dhe betejat, mos ia jep o zot askujt, por për fuqi dhe bukuri. Për njerzillëk. Kur një trimi ose bajraktari të dëgjuar i kanë uruar djalin, kanë thënë:

- *Dhashtë zoti, ngjan me të atin...*

Ai u është përgjigjur me mençuri: Jo, mos e dhëntë zoti të jetë ashtu, por le t’i ngjajë kohës...”[3]

Ky lloj rrëfimi zbulon aftësinë shpirtërore të autorit, trazimin e tij të ndjenjave, të cilat sa në mënyrë intuitive, ashtu edhe të ndërgjegjshme, gjejnë rrugën për të hyrë edhe në shpirtin e lexuesit shqiptar, që mes të tjerash është edhe lexues ballkanas, prandaj lidhet lehtësisht pas një autori tipik ballkanik.

Fatmirësisht erdhi koha që faktorët jashtëletrarë të njëmendësisë së shkuar ballkanike, shumë agresivë gjer dje, të mos i përzihen më nëpër këmbë lexuesit, i cili kërkon të shijojë letërsinë pa sinorë që kufizojnë shijen e mirë të tekstit letrar. Përemri pronor “e mi”, në titullin e romanit, merr një kuptim më të gjerë në paraqitjen e tij para publikut shqiptar. Që nga ky çast, Zuvdija HODŽIĆ përmes librit “Të gjithë njerëzit e mi” do të na flasë si “të gjithë lexuesve të tij”.

2. Cikli i Kreshnikëve
3. HODŽIĆ, Zuvdija, “Të gjithë njerëzit e mi”, “Onufri”, Tiranë, 2017, f. 153-154.

Shkrimtari, gazetari, politikani Namik Dokle në gazetën boshnjake STAV (27 mars 2021)

Namik Dokle:

Gora, pasqyrë ku reflektohet bota

Intervistë dhënë gazetarit Almir Zalihiç

A. Z.-Kush është Namik Dokle?

N.D.—Po të pyesësh dike "nga je?" dhe sidomos kur ai është shkrimtar, përgjigja më e saktë do të ishte: jam nga fëmijëria ime. Është ajo që lë gjurmë të pashlyera dhe shfaqet gjithnjë në format e palimpsestit gjatë viteve të krijimtarisë. Unë jam pra nga fëmijëria ime të cilën e kam kaluar në fshatin tim Borje, në Gorën e Shqipërise, pjesë e gjithë Gorës së ndarë në tre shtete. (Krejt rastësisht kam lindur në Durrës, por pak muaj më vonë kam filluar të thith ajrin e Bjeshkëve të Sharrit, ku edhe u rrita).

Jeta ime ka kaluar mes gazetarisë, politikës dhe letërsisë. Njëzet vjet gazetar, 24 vite në politikë si deputet i zgjedhur në tetë mandate, por gjthnjë duke bartur një ëndërr: të shkruaj një triologji për jetën e njerëzve të Gorës. Rreshtat e parë i kam filluar që në vitin e largët 1978. Dhe ato jetuan brenda meje për më shumë së tridhjetë vjet. Edhe pse kam shkruar shumë drama dhe tregime, qindra artikuj nëpër gazeta, qindra fjalime parlamentare, ëndrrën për Gorën nuk e harrova asnjëherë. Më në fund e realizova, qoftë edhe një pjesë të saj, duke botuar triologjinë, ose Sagën e Gorës.

A.Z.-Ju jeni në një kuptim shkrimtar i një "bote në kufi, i botës në tokën e askujt, i botës midis jetës dhe vdekjes, i botës së lirë në lirinë e ndaluar." Na thoni diçka më të hollësishme për këtë "botë" mbi të cilën nderet aureola e tragjedive antike...

N.D.— Kur u botua romani im i parë, VAJZAT E MJEGULLËS, në Sarajevë, nga shtëpia botuese Connectum, akademiku i shquar Tvrtko Kulenović, i kandiduar për çmimin Nobel, ka shkruar: "Të gjithë kemi dëgjuar për Goranët, por ka qenë e vështirë të mësonim diçka përsëafërmi për ata. E dimë që janë pakicë dhe që pakicat janë të nëpërkëmbura prej shumicave; i tillë është fati i tyre. Veçanërisht jeta e tyre rëndohet edhe më shumë, kur vijnë kohë të turbullta. Kur ata i vërvitin kudo e kush mundet, kur gjenden të rrethuar nga postat ushtarake dhe bunkerët. Në romanin e shkrimtarit Namik Dokle, kryesisht, trajtohet vendndodhja e Goranëve në Shqipërinë e Enver Hoxhës, në të cilën jeta ishte e vështirë për të gjithe, por për ata edhe më shumë, kudo që të ndodhen. Ky libër, për shumë arsye, është i dobishëm".

Kjo është Gora, bota e vogël për të cilën une kam shkruar triologjinë romaneske. Një krahinë me popullsi kompakte, me tradita të përbashkëta, të kultivuara në shekuj, me një identitet të formuar dhe të dallueshëm, me mitet, legjendat dhe kënget origjinale. Dhe vjen një ditë e kjo tokë dhe këta njerëz ndahen në tre shtete; Shqipëri, Maqedoni dhe Serbi (tani në territorin e Kosovës) Më keq akoma, edhe sot e kësaj dite, Gorën dhe Goranët i pretendojnë, përpiqen t'i përvetësojnë, t'i quajnë të vetet katër shtete, sepse tre të parave u është shtuar edhe Bullgaria. Kjo më kujton dramën e Brehtit "Rrethi i Kaukazit". Duket se edhe Gorën e kanë futur në rreth dhe mund ta shqyejnë, duke e tërhequr gjithsekush për vete.

Prandaj ata jetojnë dramen e tyre shekullore "në tokën e askujt, në botën midis jetës dhe vdekjes, në botën e lirë me liri të ndaluar". E prenë Gorën si me sëpatë, thotë një personazh i librit. Tito andej, Enveri këndej dhe mjegulla në mes. Dhe të mbuluar nga ajo mjegull e murrme, e ngjeshur dhe e ftohtë, jetonin Goranet, si jetimë në vendlindjen e tyre të largët. E vetmja gjë që u kishte mbetur ishte rezistenca shpirtërore kundër represionit të gjithanëshëm, për të ruajtur identitetin dhe origjinalitetin e gjuhës dhe zakoneve të tyre.

Unë kam shkruar për Gorën, por disa nga kritikët e letërsisë në Shqipëri, kanë komentuar se "Gora është pasqyra ku reflektohet bota", (Behar Gjoka), apo që "nuk jemi thjeshtë përpara historisë së një krahine; është historia e një mbijetese", (Agim Baçi) Po kështu profesoresha e letërsisë së krahasuar në universitetin e Sarajevës, Adijata Ibrišimović Šabić, ka shkruar:" Namik Dokle ia ka arritur që, nga një kronikë familjare dhe e një fshati të vetëm, të përcjellë kronikën e një krahine dhe një vendi, të end edhe një histori për popullin e tij... për vlerat e një jete të ndershme, të respektuar dhe qëndrestare." Në botën e sotme ekzistojnë 25.000 minoritete, shumë prej të cilave rrezikojnë të zhduken. E vetmja gjë që mund t'i mbrojë është rezistenca shpirtërore ndaj sfidave të djeshme dhe të sotme.

A.Z.-A mundet letërsia, me mjetet specifike të shprehjes, të paktën deri diku, të ndërtojë ura lidhjeje mbi greminat e krijuara nga ndasitë historike, ideologjike dhe nga represioni totalitar?

N.D.— Po, mundet. Letërsia dhe arti mund ta bëjnë këtë, mund t'i miqësojnë popujt, mund t'i afrojnë shtetet. Kur them kështu, kam parasysh një letërsi dhe art të vërtetë, të pandikuar nga politikat përçarëse dhe shpuzat e urrejtjes. Sidomos ne në Ballkan kemi vuajtur shumë nga këto fantazma. Dikush ka thënë se Ballkani prodhon më shumë histori se sa është i aftë të konsumojë; kuptohet që është fjala për politike të mbrapshtë, e cila ka shkaktuar mijëra e mijëra viktima të pafajshme. Kam parë një dokumentar që tregon se si ballkanasit grindeshin edhe për një kënge: grekët, shqiptarët, serbët dhe bullgarët: sikur ajo këngë ishte

e tyre dhe vetëm e tyre. Por në të vërtetë ajo ishte e të gjithëve. Dhe kultura e arti janë pasuri e të gjithëve, prandaj mund të jenë urat me të sigurta, njëherësh edhe me të bukurat për të ardhmen tonë të përbashkët. Kam vizituar dikur një katedrale të famshme në rrethinat e Strasburgut, në tokë franceze, por me një histori gjermane të saj. "Si thoni, pyeti ciceroni, e kujt është kjo katedrale; franceze apo gjermane?" Dhe po vetë u përgjigj se ajo është një vepër arti e Europës së bashkuar.

A.Z- Identiteti, ruajtja dhe transformimi i tij?

N.D.-Jetojmë në boten dhe kohën e globalizmit, në epokën e ndryshimeve të medha. Ruajtja e identitetit është shumë e rëndësishme sidomos për popujt e vegjël, për minoritetet, për ata që janë të detyruar të emigrojnë duke i lënë oborret e tyre në mëshiren e barishteve të egra, që pushtojnë hapësirat e shtëpive dhe të shpirtrave.

Të gjithë po integrohemi dhe bëjmë përpjekje të mëdha që të anëtarësohemi në Bashkimin Europian. Ashtu si ekonomia dhe politika, edhe kultura e popujve të Europës do të ketë proceset e veta integruese, por të gjithve na kërkohet të integrohemi duke ruajtur identitetin tonë. Kjo e pasuron Europën, e bën më të bukur. Bëhen përpjekje të mëdha për të ruajtur në natyre speciet e rralla të shpendeve të Europes, të gjarprinjve të Afrikes, të breshkave gjigande në Galapagos të Ekuadorit. E si mos të ruhen traditat e popujve, gjuhët e rralla, kënget dhe legjendat, veshjet dhe gjithe kultura materiale e shpirterore e popujve?

A.Z.— Goranet. Si janë ata?

N.D.— Do të doja t'u përgjigjesha me fjalët e Majkës, përsonazhi kryesor i romanit "Vajzat e mjegullës": E sa për fshatin tonë, mund të thuash apo të shkruash, se kam dëgjuar që ti shkruan... shkruaj pra se në fund të botës apo në askund, fshehur në mjegull, ndodhet një fshat i quajtur Bukojna, ku lindin burra të cilëve u zbardhen flokët që femije dhe qe shohin naten më mirë se ditën. A e di, o Mësues, se çfarë thonë për burrat dhe djemtë e fshatit tonë? Nuk i ka lindur nëna prej barkut, por i ka lindur mjegulla e Kallabakut. Qëkur lindin dhe derisa vdesin janë fëmijë të mjegullës. Në pelena mjegulle i mbështjellin, kur dalin nga barku i nënës dhe në qefin mjegulle i fusin, kur i përcjellin në varreza. Dhe e gjithë jeta mjegull u shkon nëpër botë, i rrëmbejnë erërat e vjeshtës ku të munden, përqafohen më shkëmbinjtë në grykat e lumenjve, hanë bukë me natën dhe grinden me ditën...E vrasim mendjen shumë, për këtë botë dhe për atë tjetrën..."

A.Z.-Po boshnjakët në Shqipëri?

N.D.— Boshnjakët e parë në Shqipëri kanë ardhur para më shumë se 160 vjetësh. Ishin nisur për në Turqi, por ndaluan në portin e Durrësit sepse anija e tyre pësoi një defekt të rëndë. Dhe mbetën aty e më vonë themeluan Makondon e tyre në dy fshatra, Borakë dhe Koxhas. Ikën nga Bosnja, por ajo nuk iku prej tyre, e ruajtën në shpirtin dhe zemrën e vet, ruajtën zakonet dhe traditat, këngët e tyre të përmalluara për vendin e të pareve. "Me ty jetoj në çdo pike gjaku..." ka shkruar poeti i lindur mes tyre , Fatmir Baçi.

Janë bërë shumë të njohur në Shqipëri si njerëz të ndershëm dhe punëtore, njerëz të paqtë që u rrinë larg ngatërresave, duan arsimin, kulturën, përparimin. Shume personalitete të njohura të ekonomisë dhe bujqësisë, të publicistikes, artit, arsimit në Shqipëri janë me origjine boshnjake.

Ngjajnë shumë me Goranët. Janë dy komunitete me numrin më të vogël të divorceve në Shqipëri. Për një arsye shumë të thjeshtë; martohen me dashuri dhe për dashurinë. Dasmat e tyre janë festivale të mirëfillta folklori dhe gëzimi .

Edhe Goranet që jetojnë në Kosove (në 18 fshatra) kanë marrëdhënie shumë të ngrohta e vëllazërore me boshnjaket; duket sikur i lidh e i afron një fije mëndafshi e jetës se përbashkët, të dramave dhe historisë se përbashkët dhe nuk habit shprehja e përkatësisë boshnjake të tyre, ani pse ka edhe të tjerë qe kane një këndvështrim ndryshe për identitetin e

vet. Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabarte, thotë filozofia europeiste. Askujt mos i bëni pyetje nga vjen, por pyeteni se ku dëshiron të shkojë.

A.Z.— Na thoni diçka për letërsinë e sotme shqipe?

N.D.-Tashme dihet botërisht qe shkrimtari shqiptar Ismail Kadare është prej vitesh kandidat për çmimin Nobel. Edhe në vitet tridhjete të shekullit të kaluar letërsia shqipe kishte një tjetër kandidat për Nobel, poetin e madh Gjergj Fishta (po kujtoj qe një pjese të studimeve i ka kryer në Bosnje) një letërsi qe ka emra të tille, natyrisht qe është një letërsi e mire, qe zhvillohet me hapin e kohës dhe të simotrave të saj në botë. Krahas Kadaresë në Shqipëri ka patur dhe ka edhe shumë shkrimtare të tjerë të njohur si Dritëro Agolli, Petro Marko (bashkëluftetar me Heminguein në Spanje), lirike të mëdhenj si Lasgush Poradeci e Frederik Reshpja, dhe shumë të tjerë qe tashme shkruajnë në liri, pa censure, si Zija Çela, Fatos Kongoli, Besnik Mustafaj, Luljeta Lleshanaku, Flutura Açka, Ylljet Aliçka etj. Shume autore shqiptare tashmë jetojnë neper Europe dhe Amerike dhe shkruajnë e botojnë jashtë duke e pasuruar letërsinë shqipe.

Por edhe të ne ekziston vështirësia e "letërsive të mëdha të vendeve të vogla" për të cilat nuk është e lehte të çajnë "rrethimin që sjell globalizmi".

A.Z— A ka përkthime të autoreve boshnjake në Shqipëri?

N.D.— Pak, shumë pak do të thoja. Të rrallë janë shkrimtaret boshnjake të përkthyer në shqip, po ashtu edhe shkrimtare shqiptare në Bosnje. Në shqip është përkthyer pak nga Mesha Selimović (Dervishi dhe vdekja, Keshtjella) janë përkthyer dy romane të Enes Karić (Varrezat çifute dhe Këngët e zogjve të egër) e ndonjë tjetër. Për fat të keq lexuesi shqiptar nuk ka patur mundësi të lexoje shkrimtare të tjerë të shquar boshnjake.

E njëjta ndodh edhe me autoret shqiptare në Bosnje, ka pak ose aspak përkthyes. Ismail Kadare është përkthyer nga frëngjishtja dhe jo nga origjinali në shqip. Unë kam qene me fat, fale përkthyesit Sadik Idrizi qe ka bere një punë të madhe duke i sjellë tre romanet e mia në gjuhen boshnjake.

A.Z.— Si është situata në Shqipëri?

N.D.—Si në të gjitha vendet e Ballkanit qe presin prej shumë vitesh perpara portave të Bashkimit Europian. Me ekonomi në rritje, por akoma të dobet, me veshtiresi në fushat sociale si shendetsia, arsimi, punesimi. Jane ndermarre disa reforma shpresedhenese, por rezultatet nuk jane akoma ato qe priten. Megjithate shqiptaret nga natyra jane optimiste për rrugen europiane, edhe të durueshem ndaj vonesave të politikes. Humorin na e prishin politikanet qe grinden, por njeheresh behen edhe personazhet kryesore të humorit televiziv dhe popullor.

A.Z.—Po marredheniet e Shqiperise me Kosoven?

N.D.— Me shtetet e tjera ballkanike jemi fqinj, me shtetin e pavarur të Kosoves jemi vellezer. Qe ketej percaktohet edhe natyra e marredhenieve tona, me shumë dashuri por... duhen me pak fjale dhe me shumë vepra për të ndihmuar njeri-tjetrin.

A.Z.— A ekzistojnë prirje serioze për krijimin e Shqipërisë së madhe, për bashkimin me Kosovën?

N.D.— Besoj se tashmë të gjithe e kanë të qartë se politikat e Shqiperise së madhe, Serbise se madhe, Greqise se madhe apo Bullgarise së madhe, vlejnë vetem për arkivat e historise. Ato kohe kane perenduar. Tani të gjithe synojme drejt Europës së madhe, drejt bashkimit të madh. Ka natyrisht në të gjitha vendet ballkanike idhtare dhe parti qe perkunden akoma në djepin e "megali-ideas", të asaj qe në gjuhen greke quhet idea e shteteve "të medha". Por ajo ide është e vjeteruar dhe e papershtatshme për zhvillimet e sotme integruese. Në këtë prizme shikohen aktualisht edhe idete e bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë.

A.Z.—Janë botuar tre romanet tuaja në Bosnje-Hercegovine. A keni informacion si janë pritur?

N.D.—Kritika i ka pritur mire tre romanet. Edhe lexuesit po ashtu, sikurse me kane shkruar shumë prej tyre. Siç me ka njoftuar ambasadori i Bosnjes për Shqiperine, në kohen e botimit të romanit VAJZAT E MJEGULLES, për një periudhe ka qene një nga librat e huaj më të kërkuar. Në panairin e librit ne Sarajeve, në fund të vitit 2019, isha i ftuar nderi dhe u bë një promovim i tre romaneve me logon "Atje ku dielli lind dy here", kjo sipas një legjende të Gores. Kohet e fundit, pas pushtimit të krejt botes nga armiku i padukshem covid-19, informacionet janë me të pakta. Dua të kujtoj edhe faktin që dy nga tre romanet (VAJZAT E MJEGULLES dhe DITET E LAKURIQEVE TË NATES) jane perkthyer nga gjuha boshnjake ne turqisht dhe, pas një pune krahasuese me origjinalin, janë botuar ne Turqi. Falënderoj perkthyeset Sanela Crnovršanin dhe Mirela Crnovršanin Kurtali qe mundesuan botimin e tyre ne një vend të madh. Aktualisht VAJZAT E MJEGULLËS është në proces botimi ne Bullgari dhe Spanje.

Falemnderit!

ROMANI “GJIN BARDHELA I ARBRESH & ETJA E GURËZUAR” I ANTON NIKË BERISHËS NË 52 KËNDVËSHTRIME

Nga Ajete Zogaj

Rreth vëllimit “Roman vlerash të jashtëzakonshme poetike”. 52 punime të autorëve shqiptarë dhe të huaj për romanin “Gjin Bardhela i arbresh& Etja e gurëzuar” të Anton Nikë Berishës; Zgjodhën dhe përgatitën për botim Albana Alia dhe Labinot Berisha. Botoi “Faik Konica”, Prishtinë 2019.

“Libri krijon kuptimin. Kuptimi krijon jetën.” – Roland Gérard Barthes

Vëllimi “Roman vlerash të jashtëzakonshme” i përgatitur nga Albana Alia dhe Labinot Berisha, është libër i veçantë dhe sigurisht edhe i jashtëzakonshëm.

I veçantë, ngase përfshin 52 punime për një roman të letërsisë shqipe, dhe i jashtëzakonshëm për lexuesit e shumtë, jo vetëm shqiptarë por edhe të huaj për arsye se për të deri më tani janë shkruar e botuar rreth 30 punime në italisht.

Këtë veçanti, këtë vlerë të jashtëzakonshme poetike, me stilin e mëvetësishëm, me pasurinë gjuhësore, me koloritin e kujtesës historike, me valljet, doket, zakonet, ritet... e shumëçka tjetër, autori Anton Nikë Berisha e shtjellon bukur romanin “Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar”, sikurse ‘fijet e pëlhurës së endur në vek’, duke e krijuar një vepër të mrekullueshme arti, të ‘skalitur’ bukur në artin e fjalës, mbase kryeveprën e tij!

Romani “Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar” me të drejtë është vlerësuar si i jashtëzakonshëm. Të tillë atë e bëjnë një varg elementesh si mënyra e shtjellimit të tekstit, sistemi i veçantë dhe i pasur i të shprehurit si dhe gjuha poetike, që kanë nxitur lexime dhe rilexime të shumta nga studiues të ndryshëm, përkatësisht interpretime dhe vlerësime shumëdimensionale.

Janë 52 punime të hartuara me kujdes dhe përkushtim, të autorëve shqiptarë dhe të huaj; janë 52 pamje, 52 këndvështrime të 52 autorëve, për një roman të vetëm.

Një rast i rrallë, mbase dhe i vetëm në letërsinë shqipe

A nuk është ky, një rast i rrallë, mbase edhe i vetëm në letërsinë shqipe që një libër jo shumë voluminoz të jetë kaq shumë i lexuar dhe po aq shumë i vlerësuar dhe me kaq shumë interpretime?

“Gjin Bardhelën” të Anton Nikë Berishës, sikur po e ‘rifreskojnë’ vitet, ngase, që nga viti i botimit (2002, botimi në shqip nga “Faik Konica “ e Prishtinës dhe botimi në gjuhën italiane nga shtëpia botuese “Luigi Pellegrini” e Kozencës (2013) e deri më tani mbetet aktual dhe me vlerë në letërsinë tonë dhe vazhdon të lexohet e të vlerësohet.

Leximi i 52 punimeve të këtij libri të bindë për mundësi të shumta jo vetëm interpretimi të romanit “Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar” por edhe për qasje shumëdimensionale të autorëve të punimeve, ku secili nga këndvështrimi i vet, ka ndriçuar segmente, dukuri ose veçori, qoftë të gjuhës, të stilit, të narracionit, të ambientit, të personazheve.

Sigurisht, këtë shumësi interpretimesh e ka mundësuar puna e jashtëzakonshme e autorit në hartimin e tekstit, gjuha poetike që e cilëson tekstin e tij si dhe komunikimi artistik që ai krijon me marrësin, në këtë rast me lexuesin.

Siç mund të vërehet nga leximi i punimeve të këtij vëllimi, Pasthënia e shkruar nga Amik Kasoruho, që e shoqëron botimin e parë (2002) është bërë pikë referimi për disa nga autorët e punimeve. Kasoruho shkruan: “Rrëfimi i Gjin Bardhelës është plot oht shpirti, është malli i përvëluar, është dhembje dhe kohë e ngrirë, është shpirti që zien, është shqiptim i shpresës përherë të gjallë. Shkurt është një shtegtim njerëzor jo i individit, por i breznive” (f. 18) dhe “Gjin Bardhela është secili nesh i përshkundur në detin e harbuar të jetës, nuk i përket një mendjeje të gatuar në kohë, ai jeton në një hapësirë të paanë sepse përmbyll tragjeditë e lashta dhe dyshimet e sotme, bukurinë e pamort dhe trishtimin e pashuar, mallin që rikthehet e djeg dhe ëndërrimin e guximshëm. Është legjendë dhe jetë”. (f. 20)

Janë punimet e shumë autorëve italianë dhe arbëreshë, të cilët pas leximit të romanit “Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar” e shpalosin dhe e ndriçojnë botën poetike dhe stilin e autorit, duke shfaqur dhe vlerësime me interes.

Domenico Corradini H. Broussard, në punimin e tij ““Kënga e mallit në solo violinë” thotë se “Gjini është shtegtar i durueshëm, Odiesu i ri në kërkim të Itakës së vet [...] Gjin – Anton Nikë, si një gdhendës i shkathët që prej dimrit të thatë nxjerr lulet dhe pjesët e larta ose rreth e përqark dhe nuk shqetësohet t’i lërë letër-xhamin nga druajtja që të duken falëse, rikujton me krenari legjendat, traditat dhe mitet nga Iliria e lashtë[...]. E pra le të jetë krenar Berisha, siç jam unë krenar për të”(f. 25-27). Më tej në punimin e vet ky shkrimtar dhe profesor universitar, e krahason dehjen dionisiane të Niçes dhe dehjen nga dhimbja e Berishës. Zaratrustën që i rivlerëson të gjitha vlerat dhe Gjin Bardhelën që i shndërron tragjeditë në të qeshur dhe të qeshurit në tragjedi.

Corradini ndriçon një nga veçoritë kryesore të këtij romani të Berishës: “Tek ai është një kërkim gjuhësor që nuk e gjen te shkrimtarët e tjerë [...], gjuha e përdorur nga Berisha, një gërshetim shumëngjyrësh i fjalëve të nxjerra (të peshuara) nga harresa e fjalëve të bisedimit (të përditshëm), zhburgoset nga vuajtja më e madhe: nga vuajtja për vuajtjen e të tjerëve “ (f. 31).

Për shkrimtarin e shquar, Dante Maffia-n (i propozuar për Shpërblimin Nobel), “Gjin Bardhela” është roman i rëndësishëm i cili që kur u botua në Prishtinë e pastaj, pas një dhjetëvjetëshi, në Itali, duhej të kishte zgjuar interesim të drejtpërdrejtë nga njerëz të vendeve të ndryshme, jo vetëm të Arbërisë, por edhe të mbarë Evropës: “Me aftësi të veçantë, Anton Nikë Berisha ndërlidh në kontekstin e romanit, nga njëra anë, legjendat e përrallat, si pjesë e traditave të rrënjosura të ngulimeve arbëreshe e, nga ana tjetër, edhe tërësinë e paragjykimeve që shkallë - shkallë janë shndërruar në një mënyrë të ekzistimit e të perceptimit të realitetit. Në këtë këndvështrim romani përfton kuptime antropologjike të një efikasiteti të rrallë, edhe për faktin që vendos protagonistin në brendësi të një bote gati magjike, me pasoja që vënë në dukje shkaqe tashmë të rrënjosura e të metamorfozuara në një natyrë të dytë [...] Do të duhej të flitej për shumë gjëra të këtij romani, duke filluar nga kompleksiteti i tij e të përfundohet me vëzhgimet e hollësishme për botën shqiptare dhe atë arbëreshe; do të duhej të analizohej më gjatë struktura (e tekstit të romanit) që Anton Nikë Berisha e ndërton me përsosmërinë e një arkitekti e do të duhej të diskutohej më hollësisht për qëllimet dhe përfundimet në këndvështrimin ideologjik apo idealist, por ajo që më intereson më tepër është vënia në dukje e shtresëzimit poetik të krijesës së tij të lartë artistike, e artit të vetëdijshëm të vështrimit të argumenteve nëpërmjet sugjerimit poetik, por, në të njëjtën kohë, pasional e analitik”.

Se “Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar” është roman vlerash të rralla letrare poetike, e dëshmon edhe punimi i Sergio Paolo Foresta-s, i cili fillon në formën e letrës, duke i bërë të ditur autorit se ky roman e shoqëroi në spitale nga njëri shtrat në tjetrin. Foresta e krahason romanin e Berishës me veprat e autorëve botëror. “Në rrafshin letrar është një shtegtim homerik, virgjilian, dantesk, pushkian, sipas Edgar Lee Masters”(f. 63).

Eris Rusi në punimin e tij të bërë me shumë dije për këtë roman shkruan: “Përafrimi i teknikës narrative të ndërtimit të tekstit me botëkuptimin surrealist, përroin e ndërgjegjes xhojsiane dhe introspektivën e përfytyrimit modern, e bëjnë këtë libër tejet të veçantë dhe me interes studimi.”(f. 67).

Për arbëreshin, Zef Skiro di Modika, “Leximi i romanit është intrigues, pushtues, zotërues. Në shtresat e kujtesës janë të gjitha sekuencat e historisë sonë edhe është lehtë të ridallohen në nyje të ndryshme të romanit si në një libër, ku njëra dorë e padukshme e shfleton në një atmosferë të ëndrrës” (f. 117).

Studiuesi dhe profesori universitar, Bardhyl Matraxhiut, vë në dukje njësimin e personazhit të romanit me autorin e tij: “Etja e gurëzuar e Gjin Berishës, sikundër të thuash romani i Anton Bardhelës. Duke qenë vetë Anton Bardhela rrugëtar, banor e njohës i këtyre tri botëve shqiptare, duke qenë edhe një lëvrues e njohës i gjuhës shqipe, i ka shkrirë në një në romanin e tij të tre dialektet e mëdha të gjuhës shqipe. [...] Në romanin e Bardhelës gjithçka është bërë me kompetencë e shije.” (f. 126).

Roman që të trondit

Romani “Gjin Bardhela i arbëresh & Etja e gurëzuar” nga Ragip Sylaj është vlerësuar si mozaik i shpirtit të etnisë sonë: “Ai është libër i dijes aq sa edhe i frymëzimit dhe si i tillë paraqet mozaikun e shpirtit të etnisë sonë. Në të shprehet sa krenaria, nderi, burrëria, besa e njeriut tonë, aq dhe fatkeqësia dhe tragjika” (f. 132).

Roman i magjisë së fjalës dhe i shpirtit të shqiptarit, do ta vlerësojë në punimin e tij shkrimtari arbëresh, Vinçence



Belmonte. Ai do të veçojë frymën e poezisë së pastër , 'gjë që, në të vërtetë, e bën atë një poemë moderne mbi fatin e Arbërit e mbi tragjiken e ekzistencës njerëzore."(f. 137).

"Ju shkruani hyjnisht" do t'i shkruajë autorit të "Gjin Bardhelës" shkrimtarja e shquar italiane, Nicla Morletti (Nikla Morleti) dhe se "Gjin Bardhela..." është një roman që të bën për vete, të pushton dhe të trondit, i përshkruar nga një forcë magjike, ashtu si ajo e dashurisë". (f. 184)

Për prozatorin arbëresh, Vicenzo Bruno ,"Etja e gurëzuar" nuk është vetëm një roman. Në të njëjtën kohë është ditar intim i një personi të ndjeshëm, shprehje lirike e një shpirti të thellë, këngë epike e një populli të lashtë." (f. 194).

Përmes 52 punimeve që bëjnë vëllimin "Roman vlerash të jashtëzakonshme poetike" është hedhur dritë për njërën ndër veprat më të rëndësishëm të Anton Nikë Berishës, por edhe për punën e përkushtuar të këtij studiuesi e autori të dëshmuar me një varg veprash. "Shpirti poetik i Anton Nikë Berishës nga këndi që shprehet, nuk mohon për të bërë të ditur (e do të duhej të ishte sinteza e një manifesti poetik) se edukimi i shpirtit nëpërmjet së bukurës është punë e vështirë dhe e gjatë sa edhe vetë jeta (Giuseppse Napolitano (Xhyzepe Napolitano, f. 208).

Vlerësime të rëndësishme e meritore për librin sjell edhe shkrimtari arbëresh, Francesko Fusca (Françesko Fuska) në punimin e vet, ku romanin "Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar" e cilëson një *himn për Lirinë dhe Vlerat e përgjithshme* që janë, sigurisht, ngjitja dhe dashuria për rrënjët...[...], *himn për Historinë* e lavdishme të popullit shqiptar- arbëresh, ku veçohen sidomos *shenjat, gjurmët, kodet* dalluese të Gjergj Kastritot Skënderbeut dhe të Jeronim De Radës, të Besës dhe Konstandinit të Garentinës, të Këngëve dhe të Valljeve...[...], është një instrument pedagogjik – didaktik. Në të vërtetë, kush do ta njohë mirë botën arbëreshe *tout court* dhe ta studiojë thellësisht Gjuhën shqipe (Shqip dhe Arbërisht), historinë (të përgjithshme) duhet të lexojë krijimtarinë letrare të Anton Nikë Berishës, që gërsheton botë, kultura dhe qytetërime. Harmonishëm. (f. 210). Sipas tij "Etja e gurëzuar" është një libër i mrekullueshëm, ngase të befason dhe të mahnitë, faqe pas faqeje, për atë që shkruan dhe thotë, për atë që paraqet, rrëfen, pështpërit, përfytyron....[...], pra, është një libër i mirë, një libër që vlen, një libër që të pëlqen, që shfletohet si një lule margaritë [...] që e pasuron njerëzimin. (f. 214).

Shkrimtari italian, Gianni Antonio Palumbo, vë theksin tek dy dukuri të qenësishme të romanit të Berishës: " Njerëzorja dhe hyjnorja vihen përballë njëra-tjetrës nëpër faqet e romanit *La sete pietrificata (Etja e gurëzuar)...[...]* Një prozë me një ngjyrim të veçantë, zanafillor, madhështor, të ngjizur bukur, që përbëjnë vlerat më të mira të krijimit të intelektualit të Dobërdolit." (f.230).

"Gjin Bardhela" – roman i një rrëfimi kompleks

Në punimin e tij Mateo Pulizzi e cilëson romanin "Gjin Bardhela" një rrëfim kompleks, teksti i të cilit ofron mundësi të ndryshme leximi e interpretimi, në të cilin përbërës kulturorë dhe antropologjikë ndërlidhen në aspekte psikologjike e filozofike...[...] një roman i bërë nga pamje shumë të bukura të dheut të Kalabrisë, mali, deti, pylli. Pamjet që autori i përshkruan me një ngjyrim të lartë dhe poetik, një lloj proze që bëhet poezi, për t'i lënë pastaj vendin bisedimit të rrafshët e të rëndomtë, po jo sipërfaqësor të arbëreshëve të atyre ngulimeve. (f. 261).

Në libër janë përfshirë edhe punimet e shumë autorëve, shqiptarë dhe të huaj, si Faruk Tasholli, Fatmir Minguli, Albana Alia (e cila është edhe përkthyese e shumicës se punimeve të autorëve joshqiptarë), Alessandro Guadio, Flavio Nimpo, Antonio Vanni, Casmo Azzinri, Demetrio Emanuele, Flavia D'Agostino, Albertico Guarnieri, Lazer Stani, Agron Tufa, etj.

Kënaqësia e autorit – leximi dhe vlerësimi i librit

Në përmbyllje të librit "Roman vlerash të jashtëzakonshme poetike" 52 punime për romanin " Gjin Bardhela i arbresh &Etja e gurëzuar", është dhënë fjala përmbyllëse e autorit Anton Nikë Berisha, fjalë e shkruar me ndjesi shpirti të një krijuesi të përkushtuar që 'korrë' frytet e punës së tij!

"Leximi i veprës nga tjetri, përfitimi prej saj, si njohje dhe si pasurim shpirtëror, mundësia e ndikimit estetik të saj në të – është një fakt tjetër i rëndësishëm, një ngushëllim dhe një dhuratë e madhe për autorin...[...]. 52 punimet për romanin "Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar" që botohen në këtë vëllim, të gjitha së bashku dhe secila veç e veç, për mua janë një dhuratë dhe një ngushëllim i madh..." (f. 347).

Punimet e përfshira në vëllimin "Roman vlerash të jashtëzakonshme poetike" kushtuar romanit "Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar" dëshmojnë mirëfilli për një vepër të realizuar artistikisht dhe për një autor i cili me veprat e veta ia ka siguruar vetës vendin meritor në letërsinë shqipe, ndërkaq " Gjin Bardhela" në mesin e vlerave meritore të letërsisë sonë dhe më gjerë.

MARIA ANTONIA BRAILE

POETESHA E PARË ARBËRESHE DHE LIRIZMI I SAJ



Nga Klara Kodra

Poeteshat shqiptare kanë ardhur në brigjet e poezisë, shumë më vonë se simotrat e tyre evropiane dhe botërore. Kjo nuk ndodhi, natyrisht se atyre u mungonte talenti individual në krahasim me kombësitë e tjera, por për shkak të rrethanave jashtëzakonisht të vështira historiko-sociale, një pjesë të të cilave si pushtimin otoman, ato e ndanin me bashkatdhetarët meshkuj, që edhe ata kishin mbetur relativisht prapa në krahasim me bashkëvëllezërit evropianë, ndonëse më vonë e kapërcyen prapambetjen relative me një djegie etapash. Po gratë shqiptare ishin veçanërisht të rënduara nga paragjykimet patriarkale që rëndonin mbi to, nga pozita e tyre e nënshtruar në gjirin e familjes dhe të shoqërisë shqiptare. E vetmja mundësi për të shfaqur talentin e tyre ishte letërsia gojore, në të cilën merrnin pjesë si këngëtare anonime (sidomos në këngët e vajtimit).

Poetesha e parë shqiptare, madje shkrimtarja e parë shqiptare (po qe se nuk llogarisim Dora d'Istrian, familja e së cilës ishte mërguar prej kohe në Rumani dhe e shfaqi talentin e vet më tepër si studiuese ose kritike; Kristina Xhentile Mandalanë që ishte më tepër folkloriste) qe një përfaqësuese e diasporës arbëreshe, Maria Antonia Braile që botoi vëllimin e vet "Këngë" në arbërisht dhe në italisht në vitin 1913.

Ajo pati një jetë të shkurtër (1894-1917). Ishte me origjinë na Shën Mitër Korone dhe ato pak vjersha që shkroi u botuan vetëm pas vdekjes së saj nga i vëllai Salvatore që ishte edhe ai poet, por shumë i ndryshëm prej saj me prirje satirike, më shumë se lirike.

Maria Antonia Braile nuk ka vetëm rëndësi historike, ajo ka një poetik të vetin.

Pa dyshim, ajo shkroi pak dhe ishte një poeteshë minore, po dallohet për një lirizëm të çiltër dhe fin. Mbase, po të jetonte, talenti i saj do të çelte lule të tjera lirike.

Në vëllimin e saj, çuditërisht për një vajzë të re, mungon lirika e dashurisë.

Vjershat që spikasin në vëllimin e vogël të botuar prej saj janë "Tek e keqja s'mund" ("Tek e keqja sëmundje" qartësisht autobiografike ku përshkruhen vuajtjet e saj nga sëmundja që po i merr jetën në lule të rinisë dhe ndihet etja për jetë dhe ankthi i vdekjes. Krahasimi i vetes nga autorja me një lule që lëngon është një krahasim i njohur, por që personalizohet prej saj duke i dhënë ngrohtësi lirike.

Për konçizitet dhe forcë përshkruese spikat vjersha portret që vizaton profilin e një fëmije të parakohshëm që do të jetë edhe ai jetëshkurtër, Dukagjini "Rri te froni Dukagjini/ Me ata sizit e helmuar/ Ruan zjarrin çë ë i shuar" (Rri te froni Dukagjini/ Me ato syçka të helmuara/ vështron zjarrin që është shuar).

Kjo vjershë e merr forcën shprehëse nga një epitet që karakterizon sytë e fëmijës dhe bie në kundërshtim me moshën e tij të njomë "e helmuar", pra, shpreh trishtim dhe nga një detaj, vështrimi i tij nga zjarri që është shuar dhe sikur paralajmëron shuarjen e shpejtë të djalit të vogël.

Meriton vëmendje dhe vjersha në frymë popullore me distikë të rimuar (si vjershat lirike arbëreshe të dashurisë) që i kushtohet Luftës së Parë Botërore që shihet në një optikë femërore si kositëse jetësh të reja dhe aspak në një përmasë lavdie apo heroizmi. Si shkaktar të luftës heroina lirike-autorja- akuzon Kajzerin gjerman Vilhelm.

Kjo është e vetmja vjershë me problematikë politiko-sociale e vëllimit.

Siç thamë, poetesha e sheh luftën me sytë e gruas, po edhe të njeriut të thjeshtë të popullit, duke mos u mashtruar nga parullat nacionaliste për çlirimin e Trentos dhe Triestes që qarkullonin në Itali, pra, me një realizëm dhe një largpamësi të rrallë në atë kohë.

Vëllimi i poeteshës së re nuk pati jehonë ndër bashkëkohësit, po do të përmendet shumë më vonë nga studiuesi arbëresh Gradilone, më vonë akoma nga studiuesit e tokës së origjinës, Shqipëri si Nasho Jorgaqi dhe ne vetë.

Më vonë, më 1995 studiuesi kanadez Robert Elsie do t'i jepte një vend të vogël në "Historinë e letërsisë shqiptare" që botoi në New York.

Mund të ishte me vlerë ribotimi i këtij vëllimi të vogël që të dëgjohej nga lexuesit e sotëm ky zë i butë dhe i ëmbël poetik që mund të nxjerrë edhe tinguj të ashpër.

Gjëmimi i rënkimit të Margarita Xhepës

Nga Enver Kushi

Margarita Xhepa, zonja e madhe e skenës dhe filmit shqiptar, lindi me 2 prill te vitit 1934, sapo pranvera kishte hyrë në muajin e saj të dytë. Ndoshta protoprilli i atij viti në Lushnje, ka qënë me qiell të pastër apo dhe me re të bardha, që vinin nga hapësirat e paana të fushës së Myzeqesë dhe pasi kalonin mbi qytetin e vogël, iknin tutje kodrave të buta. Me siguri ka qënë një ditë me shumë dritë, siç janë shumica e ditëve në Myzeqe. Dhe nga kjo dritë ka marrë shumë Margarita Xhepa. Është një dritë e veçantë që më vonë do të shpërfaqet në portretin, sytë, buzëqeshjen dhe mirësinë e saj. Ndoshta në qarjen e saj të parë, sapo ka ardhur në jetë, në një shtëpi të bukur rrethuar me pem ë dhe lulë, që ishte pas shtëpisë së Kongresit të Lushnjes, është prologu i vajeve të mëvonshme, që nga ai i nënës myzeqare në filmin "Pylli i Lirisë" e der te Hekuba e tragjedisë "Trojanët" të Euripidit. Dhe në shikimin e saj të parë, kur sapo ka hapur sytë, do të jenë mijra e mijra vështrime, herë të buta, njerëzore dhe herë të mbushura me lot dhe drama, në interpretimet e ardhshme në skena teatrosh, apo sheshe xhirimesh.

Margarita Xhepa në moshë të re, rreth viteve '50

Jashtë tekstit

Aktorët, këta magjistarë të interpretimit të fjalës, i kam parë dhe i shoh me nderim dhe adhurim të veçantë. Mbaj mend që në adoleshencën time dëgjoja emisionet, ku transmetoheshin të inçizuara pjesët teatrale ose ato me recitime të fjalës artistike. Zërat e tyre më dukeshin qiellorë, ndërsa fjalët të shenjta. Ndoshta që atëherë më ka mbetur në kujtesë edhe një fakt tjetër: kur isha vetëm lexoja me zë të lartë poezitë ose pjesë në prozë të teksteve shkollore, duke imituar zërat e aktorëve shqiptarë që dëgjoja në radio….

Kur nisa studimet në degën gjuhë- letërsi të Universitetit të Tiranës, gjëja e parë që bëra, bashkë me disa shokë të mi, ishte shkuarja në Teatrin Popullor për të parë dhe prekur forcën dhe magjinë e interpretimit skenik. Ato vite zinim radhë që në mëngjes herët në sportelin e Teatrit, për të siguruar bileta… Mrekullohesha nga talenti i shumë aktorëve, që ndoshta do t'i duhen dekada t'i vinë prap skenës shqiptare. Dhe kur disa prej tyre i shihja rrugëve apo kafeneve të Tiranës, më dukeshin ndryshe nga njerëzit e zakonshëm… Ata ishin dhe nuk ishin si njerëzit e zakonshëm. Ata kinse flisnin, qeshnin,silleshin si njerëzit e tjerë. Unë shihja te secili prej tyre shumësi portretesh ose më saktë, ringjallje të të vdekurve.

Mbaj mend, diku te lulishte "Rinia", kur m'u shfaq përballë aktori i madh Naim Frashëri. Ishte pranverë dhe një ditë me shumë diell…. Befas unë qëndrova dhe më pas ndoqa tërë qenien e tij, që ecte si me nxitim nëpër diell. Ku po shkonte? Nga ç'kohëra vinte? Ndoshta nga epoka Shekspiriane, me mantelin tragjik hedhur krahëve dhe me një kafkë në duar…. Më ka mbetur në kokë kjo pamje dhe silueta e Naim Frashërit tragjik. Vite më pas kam menduar për të veçantën e talenteve në fushën e aktrimit: ata ringjallin dhe ribëjnë si asnjë lloj tjetër arti shpirtin njerëzor. Forca e artit të interpretimit dhe ndikimi i tij në shoqëritë njerëzore në të gjithë kohërat, ka qenë i jashtëzakonshëm. Ata, aktorët, si askush tjetër, e kanë shndërruar fjalën në kujtesë dhe trokitje në ndërgjegjen njerëzore. Kujtesa e njerëzimit, herë- herë e përgjakur, dramatike, por edhe e gëzuar, nëpërmjet aktorëve, këtyre magjistarëve të interepretimit dhe artikulimit të fjalës, ka ardhur e gjallë dhe e prekshme. Asnjë lloj arti, përfshi këtu edhe librin, që siç thotë Borhesi "është shtrirja e kujtesës dhe imagjinatës " , nuk e ka ndikimin emocional (dhe jo vetëm), sesa teatri dhe forca e interpretimit aktoresk. Nuk është i rastit kulti i aktorit dhe teatrit në Greqinë dhe Romën e Lashtë, si dhe në qytetërime të tjera. Nuk është e rastit pasuria e madhe që ka trashëguar edhe vendi ynë në këtë fushë. Do t'u kujtoja amfiteatrot e zbuluara në territorin e sotëm shqiptar e jashtë tij si në Epir (Thesproti) apo gjetkë.

Rikthim në tekst: Energjia tronditëse e Margarita Xhepës

Margarita Xhepa është një nga ato aktore, ndoshta të rralla në historinë e shkollës interpretative shqiptare, që rrezaton në tërë qenien e saj shumë dritë. Mendoj se është një dritë e brendshme, që nga lindja e saj dhe që më pas është bërë pjesë e pandarë e portretit, gjestikulacionit, të folurit …. Mos ndoshta kjo dritë apo rrezatim lidhet me vendlindjen e Margarita Xhepës? Them se po. Margarita Xhepa ka shumë nga drita e tokës dhe e qiellit myzeqar. Myzeqeja ka shumë dritë. Është një dritë që vjen jo vetëm nga qielli, por edhe nga toka…. Nga ana tjetër në portretin e saj ka shumë mirësi , butësi si dhe bukuri e hijeshi prej aristokrateje. Mendoj se gjatë karierës së saj të gjatë, janë dy elementë që përbëjnë thelbin e talentit të papërsëritshëm të Xhepës: goja dhe sytë. E para lidhet me fjalën dhe mënyrën si artikulohet ajo dhe e dyta, pra sytë, fshehin dhe shfaqin botën e brendshme të njeriut.

Fjala, mënyra sesi ajo artikulohet, vibracionet e zërit deri në magji, duke shprehur butësinë dhe dallgëzimet e shpirtit njerëzor te aktorja Margarita Xhepa, duket sikur kanë shenjtërine e fillesave të botës dhe dramat e njeriut nga lindja deri në vdekje. Ajo e trajton fjalën si të shenjtë. Nga ana tjetër, ajo i bën ato të heshtin, të këndojnë, të qajnë, ulërijnë nga dhimbja….Margarita Xhepa i jep fjalës ngjyrim emocional. Kur sheh dhe dëgjon këtë aktore në skenë, harron se je në tokë. Befas, me zërin e saj të veçantë, ajo të çon në ca hapësira mes qiellit dhe tokës apo hapësira ëndrre. Zëri i saj, shkruan Angjelina Xhara në librin "Margarita Xhepa, artiste e popullit", është si tingull harpe që pushton jo vetëm një sallë të stërmadhe, por një botë të tërë. Po risjell në kujtesmes shumë roleve të interpretuara nga ajo, atë të nënës myzeqare në filmin shqiptar "Pylli i Lirisë", ku vaji i Margarita Xhepës është tej kuptimimit të fjalës dhimbje dhe tronditje.

Nuk është e rastit që regjisori grek i "Elektrës" së Sofokliut, ku Margarita luan në rolin e dados, flet për "gjëmimin e rënkimit të saj" . Po të perifrazoja vlerësimin e kritikës botërore për Aleksandër Moisiun, veçanërisht zërin e tij, unë do të thoja se dhe Margarita Xhepa ka një zë tipik shqiptar nga timbri, tonaliteti dhe shqiptimi. Nga ana tjetër aktorja fsheh një energji të jashtëzakonshme interpretimi në sytë dhe vështrimin e tyre. Kushdo që ka ndjekur në skenë interpretimet e saj, por veçanërisht rolet në filmat shqiptarë, me siguri ka vënë re forcën dhe energjinë e syve të aktores së madhe. Dhe jo vetëm te sytë të fshihet energjia e saj krijuese. E kam të vështirë të depërtoj në laboratorin interpretativ të Aktores së Popullit Margarita Xhepa dhe shumë nga kulmet e realizimeve të saj në skenë dhe ekran. Dhe padyshim një nga kulmet e saj është edhe roli i Hekubës, në tragjedinë e Euripidit "Trojanët", venë në skenë nga regjisori grek Vangjelis Theodhoropulos. Kur kam parë këtë tragjedi dhe Hekubën e Margarita Xhepës, për një kohë të gjatë kam jetuar me një nga klithmat më të mëdha të njerëzimit dhe dhimbjen mijëravjeçare të botës. Hekubën e "Trojanëve" të tragjedianit të madh grek Europidi, e kanë interpretuar në këto 2500 vjet, ndoshta qindra aktore, por Hekuba e aktores sonë të madhe Margarita Xhepa, është më e vërteta. Ajo është Hekuba e Trojës së shkatërruar dhe djegur në themel, por edhe Hekuba shqiptare, veçanërisht shqiptare, po aq dhe ballkanase. Tragjediani i shquar grek Europidi, ashtu si dhe të tjerët bashkëkohës të tij, ju rikthye Trojës dhe gjëmës së saj, për t'i treguar bashkëkombasve dhe pasardhësve të tyre se ajo gjëmë nuk duhej përsëritur dhe se mallkimi i saj, do t'i ndiqte gjatë grekët. Për fat të keq nuk ndodhi kështu. Gjëma e Trojës dhe klithma ulëritëse e Hekubës është përsëritur disa herë në Ballkanin tonë e në mënyrë të veçantë me trojet dhe popullin shqiptar. Margarita Xhepa, duke njohur mirë historinë e popullit të vet, por edhe atë fqinjit tonë jugor e më gjerë, solli në skenën shqiptare dhe më pas edhe në atë greke, një Hekubë sa Trojane, aq edhe shqiptare. Këtu qëndron suksesi dhe shkëlqimi befasues i Margarita Xhepës te "Trojanët". Nuk është i rastit vlerësimi dhe entuziazmi i regjisorit grek Theodhoropulos për interpretimin e aktores shqiptare: "Ajo përcolli me energji tronditëse rolin e Hekubës, duke i dhënë frymë dhe ritëm në rritje gjithë shfaqjes. Dua t'i puth dorën për energjinë tronditëse me të cilën përballoi rolin dhe situatën dramatike".

Shtojcë: Zëri ëndërr i Margarita Xhepës

Tirana është gri, një gri e përgjumur ëndrre. Jemi në palcën e dimrit, mendoj duke nxituar për të shkuar në studion e mikut tim, regjisorit Kujtim Gjonaj. Tashmë filmi ynë "Ëndrra e Çamërisë" ka përfunduar.

I kam dhënë shumë shpirt këtij filmi, thotë shpesh Kujtimi. Jam bërë pjesë e komunitetit çam kudo që ndodhet. Jam bërë pjesë e dhimbjes çame, shton ai. Ka të drejtë miku im, Kujtim Gjonaj. Tashmë që filmi është montuar dhe unë e

kam parë disa herë pa muzikë dhe tekst, kam ndjerë emocione të veçanta. Eci nëpër grinë e Tiranës dhe nuk mbaj mend se ç'kam shkruar për tekstin e filmit. Herë- herë më vinë nëpër mend pjesë teksti për lumin Aheron, Dodonën, Nikopojën, Sulin, Marko Boçarin, Daje Sakon, rënien e Janinës. Vetëm tekstin e prologut të filmit nuk mund ta harroj kurrë. Atë e kam shkruar natën vonë, ndoshta pasmesnate. Ishte janar, kur nëpër gjumë më erdhi zëri i nënës time... Pastaj edhe zëri i Nusë, Ilmijes. Edhe zëri i Hatixhes. Zëri i Nesos, Zelos, Hallë Fahros, babait tim e gjyshërve të mi të vdekur, gjyshes Hafize. U ngrita menjëherë, ndeza dritën e kuzhinës dhe nisa të hedh në letër zërat e nënave çame, zërat e të vdekurve dhe të gjallëve.

... Futem në oborrin e studios, ku do të regjistrojmë tekstin e prologut të filmit. Aktorja e madhe Margarita Xhepa vështron e befasuar oborrin e shtëpisë së vjetër tiranase, trëndafilat, limonat dhe portokallet... Unë i flas për Faik Konicën, ku në një nga shkrimet e tij flet për kopshtijet e Tiranës dhe trëndafilat që lulëzojnë edhe në palcën e dimrit. Aktorja e madhe, me përmasa ballkanike dhe europiane, e cila ka interpretuar mrekullisht në Athinë tek "Trojanët", e menduar futet në studio...E teksa ulet përballë mikrofonave, në portretin e saj të bukur, përpiqem të shoh diçka nga gjëma e nënave trojane dhe gjëma tjetër ballkanike, ndodhur disa dekada më parë, në Çamëri.

Lulzim Sula, montazhieri i filmit "Ëndrra e Çamërisë", ka bërë gati aparaturat... Kujtimi qëndron në këmbë pranë Margaritës, ndërsa unë në pjesën tjetër të studios, pranë Lulit. Ti je një nënë e vjetër çame, thotë Kujtimi. Ajo ka mall për Çamërinë dhe flet si në ëndërr. Më kupton Margaritë? Është një zë ëndrre...

Aktorja e madhe nuk flet... Ajo nuk është më në këtë studio. As para mikrofonave... Është larg, shumë larg. Unë i kam folur aktores për nënën time, e cila shpesh thotë: "Më çoni në Qafë Botë. Më mbillni sitë e atje lerméni. Me si të mbillur vete në Spatar. Se më njeh çdo gjë atje. Edhe gurët më njohin. Edhe zogjtë më njohin....".

Gati, thotë Luli. Regjistrim.

Dhe Margarita Xhepa nis interpretimin e tekstit të prologut:

"Në si i kam ato vende. Në si i kam ullinjtë, bahçetë me limona e portokale, gurët e bardhë, detin. Dhe varret... Atje jam, në vendin tënë. Më shpie ëndrra atje me krahët e saj. Në ëndërr më hapen portat e Çamërisë. Kapërcej Qafën e Botës dhe marr dhromnë për në Çamëri. Mbill sitë dhe ashtu eci, me si të mbillur. Se më njeh çdo gjë atje. Edhe drurët më njohin. Edhe gurët, edhe zogjtë më njohin...".

Befas Luli më vendos kufjet. Aktorja e madhe vazhdon leximin e tekstit, ndërsa mua më duket sikur nuk është një zë, por janë mijëra zëra. Vështrimi më mjegullohet, teksa zëri i aktores më shpie qindra kilometra larg kësaj studioje, pranë brigjeve të lumenjve Kalama dhe Aheron...

"Ktheuani zërin të vdekurve të mi. Kthejani zërin djelthit e mi Çamërisë. Më merr malli dhe në ëndërr llafosem me të vdekurit dhe vëndin tënë, Çamërinë ...".

Ajo ka përfunduar leximin... Heq menjëherë kufjet dhe mes vështrimit të mjegulluar nga emocionet, përqafoj aktoren e madhe Margarita Xhepa. M'u duk sikur përqafova mijëra nëna çame dhe preka ëndrrën, ëndrrën për Çamërinë.

Rikthim në tekst: Të flasësh me detin

Margarita Xhepa është një nga gurët e çmuar të kulturës shqiptare, vlerë dhe bukuri e rrallë, në gjerdanin e kësaj kulture. Që nga marsi i vitit të kaluar, për shkak të pandemisë ajo është mbyllur në shtëpi. Flas shpesh në telefon me të dhe sa herë dëgjoj zërin e saj, të kadaiftë, të butë e shumë njerëzor, mendoj se vitet nuk e kanë ndryshuar atë. As vështrimin. As dritën që buron nga portreti fisnik i aktores së madhe.

Dhe gjatë vitit të shkuar, si edhe këtij në vazhdim, herë herë në zërin e saj kam ndjerë edhe dhimbje, ose ofshama, që vetëm ajo mund t'i transmetojë si me magji. Fjalën e kam për ofshamat e aktores, kur kanë ikur nga kjo jetë Rikard Ljarja, Moikom Zeqo, Arben Bajo, Faslli Haliti, Zenepe Luka, Muharrem Fejzo, Kujtim Gjonaj etj. etj.

Këtyre shënimeve modeste për zonjën e madhe të skenës shqiptare, po i shtoj edhe një fakt të fundit. Mbaj mend, që ishte shtator i vitit të shkuar. E mora në telefon dhe ndjeva në zërin e saj një gëzim të brendshëm. Sapo ishte kthyer nga Kukësi dhe Himara, ku pas disa muajsh izolimi, më në fund kishte marrë pjesë në dy veprimtari, në qytetin verior dhe në Himarën e bukur, pranë detit. Më tha se në Himarë ishte ditë me diell dhe se kishte pak njerëz dhe se deti ishte shumë i qetë. E di ç'bëra, vazhdoi rrëfimin e saj Margarita. U ktheva nga deti dhe nisa të recitoj. Ishte hera e parë në jetën time si aktore, që interpretoja jo përballë spektatorëve, por përballë një spektatori që dukej se po më ndiqte me shumë vëmëndje. Dhe ky ishte deti. Këto emocione i kam akoma. Atje në Himarë i fola detit me gjuhën e tij të përjetshme.

Kaq tha Mrgarita Xhepa dhe kur unë mbylla telefonin, m'u duk sikur dëgjoja dialogun e aktores me spektatorin më të çuditshëm të jetës së saj: DETIN.

Tiranë, fillimprilli 2021

NARRACIONI DHE ASPEKTE TË NDËRTIMIT TË TIJ NË NOVELËN "STUDENTI NË SHTËPI" TË MIGJENIT

Nga Fjorentina Balla

Migjeni është një vlerë universale e letrave shqipe. Është shkrimtari, i ulur në prehër të skamjes, i cili fshikullon çdo dogmë, rregull, normë, kanun shoqëror që imponon në qenien e individit të kohës, mjerimin në të gjitha trajtat e tij: fizik, moral, shpirtëror dhe intelektual.

Migjeni kërkon tëhuajësimin e shoqërisë. Kërkon një shoqëri të re. Ai ka futur në mes tyre një person të tëhuajësur, si Nushi, por kjo gjë është arritur për shkak të shoqërisë perëndimore. Ky autor e fton shoqërinë në ndryshim: *"Unë jam pa moral, koncepti i em menduer – mos me thanë ideologjik – nuk pajtohet më moralin, të cilin mue kjo shoqni ma imponon. Por unë e marr moralin e saj për sy e faqe , nsa mbrpa ia loz lojën kur të due. Kështu si une ia lozin lojën shoqnis me qindra veta në vendin tonë. Prandaj, shoqni, po deshe të mos lozin në kurriz tand, ndrro format. Hiqi bragashat"* – ky është qëllimi që autori, si një instancë e jashtme e veprës, kërkon të arrijë.

Në këtë novelë nuk kemi një subjekt vargor, ku episodet ndjekin njëra-tjetrën, por rrëfimtari zgjedh që të na japë vetëm disa linja veprimi. Këtë gjë, sigurisht e bën më vetëdije të plotë, sepse qellimi I autorit që del me zërin e rrëfimtarit nuk është që të tregojë fabulën; ai tregon fabulën e veprimit dhe nëpërmjet saj krijon një subject të brendshëm te personazhi I tëhuajësuar I Nushit, të cilin rrëfimatri e bën motiv për tëhuajësimin e shoqërisë.

Migjeni përdor një rrëfimtarë të vetës së tretë, I cili në vetvete është një rrëfimtar anonim, që shpreh zërin e një personazhi të novelës, Nushin. Ai zgjedh këtë lloj rrëfimatri për novelën e tij, në mënyrë që të marrë rolin e interpretuesit të ngjarjeve apo motiveve që trajtohen. Në këtë mënyrë ai do të jetë më afër lexuesve, si një interpretues, I cili shpalos këndvështrimin e tij për ngjarjet e ndodhura, këndvështrim, të cilin di si ta tejçojë te lexuesi në atë mënyrë që ato t'i godasë. Për këtë gjë ai zgjedh ironinë, sarkazëm, si një ndër format origjinale të shprehjes së tij, që shpesh është forma më ininteligjente për të shpalosur të vërteta te hidhura.

"E Nushi ndëgjon. Don me qenë djal i mirë. Si mos me ndëgjue babën i cili e lindi, rriti dhe e bani kaq! Pale mos ndëgjo. Megjithëse kunda ndërgjegjës së vet, Nushi ndëgjon. Nga fjalët e t'et i shtrembërohet fytyra, por me ndëgjue-ndëgjon.... Ndëgjon dhe nana në dhomë të zjarrmit fjalët e burrit të vet dhe me frigë çuditet për ditunin e madhe të bashkëshortit.."

"Nuk e due! Jo,deri tash nuk asht ndëgjue në farefisin tone ajo fjale nga një vajzë e fejueme. Se secili burrë, çfarëdo qoftë, s'paku mashkull asht. E me ba mos me qenë mashkull?"

"Nderi i shoqnis asht i pacënueshëm. I mjeri ai, i cili provon ta cënojë...E pse një grue, tue fjetë me burrin e vet plak ose idiot, vuen dhe mendon ndoj tjetër, s'ka gja... Jeta bashkëshortore njësoj asht e hyjnueshme. Këtë e ka vërtetue institute fetar.*"*

Siç e thamë më lart, kemi një rrëfimtar të vetës së tretë të gjithëdijshëm. Rrëfimatri di më shumë se personazhet e tjerë, pasi ai mund te shohë botën e brendshmë të njërit apo tjetrit personazh, botë të cilën brenda veprës nuk e njohin peronazhet e tjerë dhe as nuk ka për qëllim që t'ia tregoj, por ka për qëllim që t'ia demostrojë lexuesit. Ja për shembull: "*Ah, kur të më mësojë mue Nushi, tash ia kallëzoj qejfin – mendonte me vete tue fshi një çini.*" Ose *"Mos të më korisin, - mendonte me vete kryetari i familjes, tue i shikue me rend të gjithë pjesëtarë."* Ose ":*Luli disi nuk e mendonte, nuk mund t;ia parafytyronte vetes se zotnia e tij mundet me qenë dhe burr' i një grueje si Agia"* Etj.

Novela e ndërtuar në vetën e tretë, është ndërthurur edhe me dialogje apo monologje. Kjo zgjedhje e autorit bëhët për të bërë prezent në rrëfim zërat e personazheve, për t'i konkretizuar ato brenda botës së një vepre letrare. Po ashtu, edhe për të dhënë këndvështrimet e personazheve në lidhje me ngjarjet, personazhe të cilët janë perfaqësues të një shoqërie te kohës kur është shkruar vepra, por jo vetëm. Është tepër aktuale edhe sot. Kështu, lihet hapësira që këto këndvështrime të gjykohen e interpretohen nga zëri i rrëfimtarit që vjen nga një botë perëndimore.

Në këtë novelë, prania e dialogut e ndërthurur me rrëfimin bën të mundur që të kemi një rrëfim shumështresor. Pra, ne shembullin: *" – A t'u mbush mendja me ardhë, - i tha i ati kur e pa."*– kemi një shkrirje të dy zërave: te zërit të rrëfimatrit dhe të zërit të personazhit. Po ashtu, në shembullin:*"Mamë! Nushi thotë se ëdhe vajzat sa unë, edhe të martueme bile, shkojnë në shkollë. Ha-ha-ha! U përplas qeshja e vajzës në ftyrë të s'amës."*–kemi praninë e tri zërave: zëri i vajzës, zëri i Nushit dhe zëri I rrëfimtarit. Kështu, zëri I vajzës është: "*Mamë! Nushi thotë... Ha-ha-ha!",* zëri i Nushit *është*: "...se edhe vajzat sa unë, edhe te martueme bile, shkojnë n*ë* shkollë" dhe zëri i rrëfimatri është: *" u përplas qeshja e vajzës në ftyrë të s'amës."*. Siç mund ta shohim, marrëdhëniet me lexuesin nuk I krijojnë personazhet, por rrëfimtari. Nushi I flet vajzës, vajza I flet nënës dhe këtë ligjërim e mërr përsipër ta rrëfeje rrëfimatri, I cili I flet lexuesit, duke lidhur kështu një marrëdhenie të drejtëpërdrejtë me të. Në këtë fjali kemi gjithashtu edhe një ligjëratë të drejtë të lirë, sepse mungojnë shenjat identifikuese të ligjëratës së drejtë.

Përsa i përket kohës së rrëfimit dhe kohës reale të ndodhjes së ngjarjes, kemi dy perspektiva: ne pjesën e parë të novels kemi një kohë të tashme të caktuar, që tregon që veprimi po ndodh në momentin që po tregohet ngjarja:" *Në një ndër qytetet e Evropës së Mesme Nushi po lexon letrën që posa ia kish prumë letërshpërndarësi.".* Gjithashtu, perveç kohës së tashme, kjo gjë përforcohet edhe nëpërmjet lidhezës kohore "posa" dhe ndajfoljes së kohës "tashti". Ne pjesën e dytë koha e rrëfimit dhe koha e ngjarjes nuk përputhen me njëra-tjetrën. Kjo na tregohet në fjalinë: *"Mbas tri vjetëve të tjera Nushi u kthye në shtëpi si mjek i kryem.".* të pjesës së dytë të novelës. Edhe këtu kemi motive përqasjesh midis dy pjesëve të novelës. Në pjesën e parë ai ishte vetem një student, ndersa në pjesën e dytë kthehet si një mjek dhe ky post I ka ndryshuar atij marrëdhënien me të tjerët, madje edhe babi I tij, tashme I flet me nje ton miqësor. Ky ndryshim e bën Nushin të futet në një dilemë te brendshëm: *" Vërente me kujdes të madh sjelljen e babës kundrejt tij dhe kundrejt të tjerëve të shtëpis. E një mendim i ri, si stuhi, ia pushtonte trute dhe ia perplaste andej. Ai ma vone tundte kryet, si me dashte me e largue at mendim. Ishte mendimi se edhe i ashtëquajtuni ideali familjar asht mpshtetun n'interes.".* Ky interes egoist që ë*s*htë ndërfutur në bazën familjare, tregon këmbanën e alarmit për të githë boshtin shoqëror. Babai patriarkal shqiptar për shkak te interesit bëhet hipokrit dhe nuk ndjehet për tradhëtinë e së bijës, e cila nga ana tjetër është një viktimë e "moralit" të mendësisë shqiptare.

Të gjitha citimet të bëra më sipër, mund t'I marrim si shembuj për të konkretizuar faktin që kemi të bëjmë me një rrëfim subjektiv, pasi rrëfimtari shpreh kryesisht këndvështrimin e Nushit dhe mënyrën se si ai I analizon ngjarjet e ndodhura, e jo vetëm, por edhe kendvështirme të personazheve të tjerë, siç është babai, Aga, nena, burri I Agës, Luli.

Migjeni I jep kësaj novele formën e një subjekti të hapur, pasi ai e përfundon këtë novelë me një thirrje ndaj shoqërisë për ndryshim: "*Por unë e marr moralin e saj për sy e faqe , nsa mbrpa ia loz lojën kur të due. Kështu si une ia lozin lojën shoqnis me qindra veta në vendin tonë. Prandaj, shoqni, po deshe të mos lozin në kurriz tand, ndrro format. Hiqi bragashat.".*

UR-LIBRI

Tregim nga Ismail Kadare

I

Kur miku im K. V. më foli për pasionin e tij të fundit, ngaqë kishte bindjen se edhe ky do të ishte diçka e përkohshme si gjithë të tjerët, e dëgjova duke u përpjekur të hiqem si i vëmendshëm, ndërsa, të them të drejtën, mendjen e kisha gjetkë.

- A po më ndjek? - pyeti ai papritur, ngaqë e ndjeu, siç duket, që unë s'isha aty.

- Natyrisht, - i thashë dhe u përpoqa të mos e vështroj. - S'është herë e parë që flasim për këtë.

Në të vërtetë, s'ishte herë e parë që bisedonim lidhur me artificin në letërsi. Kohët e fundit, çdo ditë e më tepër ai ngulte këmbë se kishte shumë artifice në librat që botoheshin, aq shumë, saqë habitej se si njerëzit, të lodhur prej tyre, nuk i braktisnin libraritë, duke thënë "mjaft!". Ka shumë mbërthecka, stisje, sajime të qepura me pe të bardhë, vazhdonte ai. Ne qeshim sot me ato romane, ku autorët i fillojnë krerët me fraza të tilla, si: "Dhe tani, i dashur lexues, le ta lëmë heroin tonë në brengën e tij dhe le të ndjekim fatin e heroinës etj., etj.". Ne shqyhemi gazit me to dhe nuk mendojmë aspak se ajo që shkruajmë vetë nuk është më pak e stisur se këto dhe se brezat e ardhshëm do të qeshin me ne njëlloj si ne me të mëparshmit.

Kishim folur, pra, gjatë për këtë. Ai ngulte këmbë për domosdoshmërinë e një freskimi rrënjësor, sidomos në gjininë e romanit, një rinovimi (ose risie, siç thoshin kohët e fundit kritikët), të tillë, që të ishte i aftë t'i bënte të panevojshme të gjitha gjetjet letrare, klishetë, trajtat e ngrira, gjithë këtë zhguall bezdisës, që po i merrte frymën artit.

Unë e kundërshtoja. Po ta merrje kështu, vetë akti i të shkruarit ishte i stisur, pra, artificial. Ca shenja e shenjëza mbi letër, mbi të cilat njeriu rrinte me orë të tëra seriozisht, si i lajthitur. A s'është kjo gjë, shpikja, gjetja, risia, kinserisia, kriptokinserisia, me fjalë të tjera, marifeti (merre si ta duash) më i madh që ka shpikur njerëzimi, në krahasim me të cilin gjithë freskimet e mundshme të gjinive letrare s'janë veçse çikërrima?

Ai hutohej një çast, po hutimi qe i përkohshëm. E merrte veten më shpejt se ç'e prisja, për të më kujtuar Floberin, i cili, i pakënaqur nga ato që kishte krijuar, ëndërronte të shkruante një libër "për asgjë", por që do të ishte në të vërtetë një libër për gjithçka. A nuk e kishte joshur mendjen e kaq krijuesve të mëdhenj ëndrra e librit të përgjithshëm, përmbledhës, total, me fjalë të tjera, të një ur-libri? Bibla qe përpjekur ta luante atë rol, por ajo qe ende larg, shumë larg. Të tjerë krijues, madje të kohës sonë, si Ezra Paundi e Borgesi, kishin rendur pas kësaj ideje, po pa e njëmendësuar dot. Kishte dhe institucione të tëra që merreshin me këtë, si për shembull, në SHBA, ku në një bunker kolosal nën tokë, në fletore apo shirita të pafundmë po regjistroheshin gjithë emrat e njerëzve që kanë jetuar e jetojnë në këtë planet. Është një gjë e hatashme, më kupton, vazhdonte ai. Gjithë emrat e racës njerëzore, siç janë gjetur në dokumente, libra, shënime, kujtime, brez pas brezi e epokë pas epoke. Vetë ideja është e bukur: përftimi i botës si një shtëpi, një familje, me të gjallët e të vdekurit e vet. Ide e bukur, pa dyshim, po prapë mbetet e mangët. Lënda ishte tepër e shtrirë, e palidhur nga mendimi. Ishte njëlloj si të përpiqeshe ta kuptoje këtë botë vetëm nëpërmjet leximit të fjalorit ose të enciklopedisë. Kurse unë e mendoj këtë gjë ndryshe. E përfytyroj, për shembull, që kjo botë, ky trup qiellor, ku breznitë njerëzore erdhën e ikën, u shua një ditë, mbaroi dhe ti, për një lojë rrethanash, shpëtove. Ti i vetëm, pra, i ike vdekjes, shuarjes dhe, ashtu vetmitar, dëshmitar vetmor i globit tokësor, ndien për detyrë t'i rrëfesh universit atë çka u shua në globin e vogël të kaltërt, çka ndodhi atje gjatë mijëra vjetësh, si lindën e vdiqën breza njerëzish e gjallesash, shtete e popuj, pamje, ëndrra e tinguj. Ti nuk ke arritur të marrësh me vete asgjë nga ky planet: asnjë shtatore a kristal, asnjë dosje a gjymtyrë femre, asnjë fotografi, hartë, mineral, send të çfarëdoshëm, madje asnjë grusht dhé. Ti s'ke asgjë nga këto, por ti ke një libër të vogël, ku je përpjekur të përmbledhësh mbarë botën, një libër që e ke hartuar për një rast të tillë fatkeq. Me të nën sqetull, ti do të dalësh përpara universit për të dëshmuar.

Merret me mend se sa i vështirë ka qenë shkrimi i këtij libri. Atje s'duhej të kishte asgjë të tepërt e, ndërkaq, asgjë të mangët. Por edhe më e vështirë se kjo ishte ruajtja e përpjesëtimeve të drejta për vendin që do të zinin në faqet e librit ngjarjet, gjallesat e dukuritë e ndryshme. Se nuk ishte e lehtë të gjeje ç'kishte qenë më e rëndësishme në këtë botë: oqeanet, ligjet, seksi femëror, simfonitë e njëfarë Bethoveni, piramidat, elektriciteti, ulërima e erërave, pendimi njerëzor, përmbysja e shtetit, ankthi i letrës së vonuar, gjumi i miliardave, hyjnitë, çmenduria, alfabetet, kinezët, thika mbretvrasëse, ferri, sperma e njeriut, zbërthimi i uraniumit, kryqëzimi i Krishtit, revolucionet, mallkimi, pikëllimi vjeshtor nën pikat e para të shiut që s'ka rënë prej kohësh, egërsimi i tiranit, netët me hënë, netët makbethiane (sipas emrit të njëfarë Makbethi), tërmetet, vetmia e Don Kishotit (kalorës endacak), komunizmi, internimet, ankthi i kthimit të të vdekurit, krediti bankar etj., etj.

Ndërsa fliste, ai përsëriste vazhdimisht "më kupton tani" dhe unë duhej të tundja kokën gjithmonë e më energjikisht, në mënyrë që ai të mos më lodhte me atë "më kupton tani" të mallkuar.

Kështu e mbaj mend prej vitesh: të shqetësuar, në ankth, në kërkim të së pamundurës.

- Ti mendon se një libër i tillë është i pamundur? - pyeti pas pak. - E shoh që ashtu mendon, s'ka nevojë ta thuash.

- E mundur është vetëm ideja e tij, po mendoj që edhe kaq mjafton.

Ai tundi kokën.

- Kurse unë mendoj ndryshe. Kur lind ideja për diçka, ajo diçka është në prag.

- Ndoshta, - iu përgjigja i lodhur. - Po ndoshta njerëzimi s'ka nevojë për librin total, kjo është ndoshta edhe arsyeja që ai s'është shkruar.

Ai prapë tundi kokën në mënyrë mohuese.

- S'mund të jetë ashtu. Shumë gjëra njerëzimi s'i ka arritur ende, po kjo s'do të thotë se s'ka nevojë për to.

Përpiqesha të mos e acaroja, ngaqë e dija se çdo shpërthim i tij e lodhte atë vetë më tepër se mua. Në të vërtetë, kisha kënaqësi ta dëgjoja, kur fliste më i qetë. Kisha kënaqësi, sepse shumë nga idetë e tij ishin të bukura, megjithëse të parealizueshme. Një vit më parë më kishte thënë se dëshironte të shkruante një libër vërtet të jashtëzakonshëm: Historia e Perandorisë Osmane me TV, një libër, pra, të hamendësuar, se si do të ishte historia e këtij shteti sikur të kishte ekzistuar rrjeti televiziv, ç'ngjarje do të qenë shpejtuar e ç'të tjera do të frenoheshin ose do të ndaleshin fare e kështu me radhë. Për fat të mirë, e kishte braktisur shpejt këtë projekt, për t'u dhënë pas një tjetri, që mua m'u duk tepër i arsyeshëm: një libër për rrugën ku banonte, një libër i vogël alla George Perec, me përshkrimin e të gjitha banesave e të gjithë banorëve që banonin në to, me të dhënat e plota për jetën, gëzimet, brengat, sëmundjet, gjyqet, librezat e kursimit etj., etj., që plotësoheshin me kanalizimet e nëndheshme, rrjetin e ujësjellësit, rrjetin telefonik, faturat, prishjet etj., etj., e gjer te të dhënat e tjera, që ngjanin si vocërrima: riparimet e ndryshme, vizitat e së dielës e gjer te numrat që mbanin varret sipas regjistrimit në librin e varrezës së qytetit.

Një libër i tillë, pavarësisht nga teprimet, më qe dukur i mirë, për arsyen e vetme se e lidhte atë me jetën dhe njerëzit. Mirëpo kurrsesi nuk e kisha menduar se ai do të ishte një shkallë, e cila do ta shtynte atë drejt një synimi të ri: librit total.

II

Veç të mos jetë për atë, mendova, kur më mori pas disa muajsh në telefon dhe me një zë të rëndë më ftoi në kafene. Një parandjenjë jo e mirë më thoshte se ishte pikërisht për atë... librin total. Dhe parandjenja nuk më gaboi. Porsa hyra në kafene, ku ai më priste, e kuptova që jo vetëm e kishte shkruar, por e kishte me vete librin.

E larguam sa mundëm të dy bisedën për të, unë me një shpresë të fundit, të dobët, se ndoshta pendohej e nuk ma tregonte, ai për ta shijuar ndoshta më shumë pritjen përpara lumturisë, gjersa erdhi çasti kur asgjë nuk mund të shtyhej më.

Kisha një nervozizëm të brendshëm, të shurdhër, saqë, fill pas fjalëve të tij të para, e ndërpreva.

- Po si arrite t'i futësh të gjitha ato që më ke thënë: të gjallët, të vdekurit, zhurmat, sendet, me një fjalë, tërë atë kazan që zien ditë e natë e që quhet botë?!

Ai më vështroi ngulazi.

- Unë nuk kam bërë asgjë nga këto, - tha ngadalë. - Madje, kam bërë të kundërtën.

- Të kundërtën?

Ai buzëqeshi me vete.

- Më tepër se pasuria e të dhënave, librin tim e bëri total e kundërta e tyre, domethënë mungesa.

- S'po kuptoj asgjë.

Ai buzëqeshi prapë. Siç dukej, kështu e kishte menduar këtë punë: sa më tepër që libri të shkaktonte habitje, mundësisht, shastisje të bashkëbiseduesit, aq më origjinal ishte.

- E, pra, mungesa, heshtja, shkretimi, sidomos për tre-katër mijëvjeçarët e fundit të njerëzimit, atëherë kur ai ka qenë edhe më i zhurmshëm, është karakteristika kryesore, baza e ngrehës së librit tim.

Ai priti që unë të lëshoja klithma të tjera habie ose mosbesuese, por unë e kisha mbledhur ndërkaq veten për të mos ia dhënë atë kënaqësi. Pa i hequr sytë nga çanta e tij e zezë, e fryrë pak në mes, si të ishte shtatzënë me djallin (pikërisht me një zë të tillë, që do ta përdorja për t'i thënë: "tregoma më në fund atë djall"), i thashë:

- Tregoma më në fund librin.

Ai e hapi çantën dhe me një lëvizje të kujdesshme nxori prej saj atë që gjer në grimën e fundit e prisja që të ishte gaforre,

shishe rakie, orë muri e ndrequr a dreqi e di çfarë, sesa libri për të cilin më kishte folur.

III

Gjatë më shumë se një ore më shpjegoi thurjen e tij, e cila, duhet ta pohoj, m'u duk më se e çuditshme.

Ishte vërtet një libër total, për botën dhe njerëzimin gjatë njëqind mijë vjetëve të fundit, domethënë nga njeriu i Neandertalit gjer në ditët tona. Gjer këtu s'kishte ndonjë gjë origjinale, përderisa ishin shkruar me qindra të tillë. Origjinale ishte tjetër gjë dhe pikërisht sasia e faqeve ose e rreshtave që i kushtohej çdo periudhe. Kjo sasi ishte në përpjesëtim të drejtë me gjatësinë e periudhës që përshkruante. Në bazë të këtij parimi, përderisa të dyqind faqet e librit ngërthenin një kohë njëqindmijëvjeçare, çdo mijëvjeçari i takonin vetëm dy faqe, rrjedhimisht çdo shekulli rreth gjashtë rreshta. Gjithmonë sipas kësaj qoke, gjithë historia e njohur e qytetërimit njerëzor (rreth katër mijë vjet) përmblidhej në rreth tetë faqe, kurse shekullit të njëzetë mezi i takonin gjer tani pesë rreshta.

Ai priti, me siguri, që t'ia bëja unë pyetjen: "po pjesa tjetër e librit, pra, njëqind e nëntëdhjetë e dy faqet e tjera, me se merret?", po, kur pa se unë vonova, e humbi durimin.

- Ti do të thuash, po pjesa tjetër e librit me se merret? Tani do të ta shpjegoj.

Ajo që më shpjegoi ishte edhe më e habitshme. Në të njëqind e nëntëdhjetë e dy faqet e tjera, domethënë, në faqet që i përkisnin periudhës përpara qytetërimit, përshkruhej koha e gjatë, e errët e monotone e njerëzimit dhe kjo nuk bëhej as me përfundime a zhbirime shkencore, po thjesht në trajtë kronike. Dhe pikërisht këtu qëndronte kyçi i librit. Ndërsa, sipas këtij kriteri, Luftën e Dytë Botërore autori duhej ta jepte me një të tretën e një rreshti (pra rreth dy-tri fjalë), mprehjen e kockave, fërkimin e drurëve për të ndezur zjarrin ose veprime të tilla të ngjashme të njeriut parak ai i përshkruante me dhjetëra e dhjetëra faqe dhe në një mënyrë të përsëritur, monotone e lodhëse, që t'i përgjigjej pak a shumë kohëzgjatjes së tyre nëpër shekuj. Është e tepërt të nënvizohet se, ndërsa gjithë shpikjeve të mëdha të botës, me vështirësi u takonin një ose dy rreshta, mprehjes së kockës në trajtë thike i kushtoheshin gati dhjetë faqe të librit.

- Ti e kupton se sa mund më ka kushtuar e gjithë kjo, - më tha ai. - Mund i tmerrshëm për të dhënë tërë atë përsëritje lodhëse, të pafundme, skëterrore të përparimit të ngadaltë të njeriut, nga njëra anë, dhe po aq mund, në mos më tepër, për të dhënë në mënyrë sa më të dendur, ashtu siç ta shpjegova, kohën e re.

Ai më shpjegoi pastaj se kishte një mënyrë për të zgjedhur vendin që zinte koha moderne, po kjo sillte ndërlikime të tjera. Kështu, për shembull, në qoftë se e rriste gjer në pesë herë kohën e re, duke i dhënë një shekulli jo gjashtë, po tridhjetë rreshta, gjë që dukej një luks i madh, ishte i detyruar që librin nga dyqind, ta kthente në një mijë faqe. Rrjedhimisht, mprehja e kockave ose fërkimi i drurëve nga njeriu parak, që edhe kështu siç qe ngjante i zgjatur e monoton, do të zinte qindra faqe.

- Ja në ç'mëdyshje ndodhem, - tha ai. - E vështirë, apo jo?

Porositëm edhe nga një kafe tjetër dhe unë më kot përpiqesha të kujtoja nga njohuritë e përcipta që kisha për psikiatrinë se në çfarë deliri mund të hynte shkrimi i një libri të tillë.

- E megjithatë kjo s'është dhe aq e vështirë për ta krahasuar me projektin e parë, të cilin, e pohoj sinqerisht, e braktisa, ngaqë nuk ma mbante. - Sipas tij, në libër do të jepej jo vetëm koha që nga njeriu i Neandertalit, po që nga njerëzit e parë, me fjalë të tjera, jo njëqind mijë, po një milion vjet. Dhe atëherë, gjithçka do të ishte shumë më e dendur dhe një shekulli nuk do t'i takonin më gjashtë rreshta, po dhjetë herë më pak, domethënë pak më shumë se gjysmë rreshti, me fjalë të tjera, rreth dyzet shkronja...

Nuk e di ç'na shtyu të vështroheshim të dy në sy dhe në vend të ndriçimit të marrëzisë unë dallova në to një pikëllim të madh. Si të qe kapur në grackë, ai u përpoq më kot ta hiqte vështrimin, pastaj befas zuri kokën me duar dhe u shkund i gjithi nga gulçi.

Nuk e pyeta "ç'ke?", sepse m'u duk më e udhës ta lija të çlirohej. E kishte ende zërin të zbutur nga gulçimi, kur më tha:

- Mua s'më do gruaja.

Qëndruam të dy në heshtje, pa i hequr sytë nga çanta e zezë, brenda së cilës ishte libri, ai që duhej të ishte streha e tij e sigurt kundër vogëlsirave të jetës, pika madhështore e krahasimit, në varësi me të cilin gjithçka tjetër duhej të dukej e përkohshme, e parëndësishme dhe kalimtare; ngushëllimi i tij, harresa, çlodhja, burimi i smirës e i admirimit të të tjerëve: (sa lart, në ç'sfera të paarritshme endet mendja e tij) shkurt, droga e tij, që për herë të parë ndoshta nuk po e mpinte dot.

Nuk di sa qëndruam ashtu, unë pa e hequr shikimin nga çanta e zezë, ai duke fshirë herë pas here sytë me shuplakat e duarve, gjersa erdhi kamerieri dhe ne, për habinë e tij, porositëm nga një kafe të tretë.

Tiranë, 11 korrik 1986

E di që ëndërron, (dhe përgjërohesh), të jemi bashkë

Nga

DELVINA KËRLUKU

Sikur ta dije çdo të doja të të dhuroja sot në ditëlindjen tënde,
unë që s'kam në dorë as fuqinë, as mbretërinë,
tek ëndërroj të marr bukuritë e natyrës, botës,
e t'i shtroja pranë derës tënde, ku ulesh e thur ëndrra, e pret,
e më pret...
E di që ëndërron, (dhe përgjërohesh), të jemi bashkë.
Me mua që s'jam lule, që ti adhuron,
(lule, as emrin s'ma thonë),
por të sjell aromë pranvere (në dimër, në acar)...
Nuk e di si të lë vetëm, këtë ditë (kur ti linde, e mua vonë më rilinde)..,
pa ta shtrënguar dorën, pa të përqafuar, ashtu siç ndizet flaka,
pa të shikuar në sytë e tu të zjarrtë, që më shtojnë mall në çdo ikje...
Si u ndanë këto rrugë, si u zgjatën kilometrat, nuk e di,
Për ne që s'na ndalte as shi, as borë, as suferinë...
Janë vitet që na rëndojnë hapin, është bota që na ka vënë para nesh "shuplakën",
ne që qeshemi me jetën, e jo me fatin.
Ne që japim e marrim dashuri nga njëri – tjetri
e mbjellim dashurinë në çdo cep që shkelim.
Ne që i falim paqe shpirtrave tanë të trazuar dhe që jemi paqedashës..?!
Kush na e ndal hapin, në këtë ditë gëzimi, fati?!
Të të shtrëngoja dorën (të marr forcën tënde),
t'i biem fatit tonë të parathënë...
Atëherë, do të fluturoja me dhe pa flatra.
Do të merrja rrugë e ti derë çelë, do të më prisje,
krahë hapur, ashtu siç ke ëndërruar e ëndërron...
E di: për dore do të ecnim rrugëve tona pa shtigje,
si deti e qielli, pa brigje.
Pastaj, nuk e di se kush do të ndjehej më krenar, me njëri – tjetrin.
Ty një lumë – lumturie do të rrëmbente,
e mua më mbetet të të quaj pasuri.
Pra, po të pyes ç'mund t'i fal pasurisë, në këtë ditë me shenjë?
Nëse do buzëqeshjen, lumturinë, harenë, paqen,
të gjitha merri pa yjem.
Jemi aq larg, e ndjehemi aq pranë, këtë ma ke thënë e ta them.
Si u bë kjo jetë, larg, larg..,
e të duhemi kaq shumë.
Dhe kur e them se të dua, të kam jetë, të kam të shtrenjtë e të shenjtë,
këto rrëke fjalësh kanë bulë lotësh.
Kurrë nuk kisha dashtë të të fal lum-lotësh, në ditëlindjen tënde...
Por, kjo pasuria ime, ky është ngushëllimi im.

(*Vjeshtë*, 2020)

GENTIANA MINGA

NJË VËLLIM POETIK NË TRI GJUHË: ITALISHT-SHQIP-GJERMANISHT

Sapo ka dalë nga shtypi prej shtëpisë botuese Terra d'Ulivi (2021, Itali) botimi i ri i autores Gentiana Minga. Libri i dedikohet Anthony-it, një djali të vogël pesëvjeçar prej Sierra Leones, që u gjënd, i vetmuar e thuajse i ngrirë, një mëngjes të ftohtë nëntori të 2017-ës nga oficerët e policisë hekurudhore të Breneros, në kufi me Austrinë, në tentativë për të kaluar kufirin.

Vëllimi, që përbëhet prej katër ciklesh: Për Anthony, Marshi i vendasve, Jehona e foshnjës e Kohë që janë, është shkruar në tri gjuhë, italisht, shqip e gjermanisht.

Gentiana Minga ka lindur në Durrës më 1971. Ka botuar mes të tjerash: Autopsia e shkatërrimit (1993, Europa, Tiranë, tregime); Zonja e Shkodrës (poezi, Florimon, Tiranë,2003); Ciao mamma, un saluto da Bolzano (poezi, Terra d'Ulivi, Itali, 2017; Tempi che sono/ Zeiten wie diese/ Kohë që janë -(poezi, Terra d'Ulivi,Itali, 2021). Pjesë të krijimtarisë së saj janë përfshirë në antologji të ndryshme e janë përkthyer e botuar në spanjisht dhe gjermanisht. Bashkëpunon me revista të ndryshme letrare. Më poshte është shkëputur një cikël nga vëllimi " Tempi che sono/Zeiten wie diese /Kohë që janë"

Një

Kohët janë gjithmonë të drejta
e shtegtari im po më nxit
që të shkoj Entheos, me hare.
Ta palos në katërsh kohën që u krye.
Do të na kryqëzohen bebëzat e përmalluara
kur të fërshëllëjë me duf treni
mbi dritaren e tjetrit.
Do të largohemi përtej trupave tanë vertikal.
Ca jetë mbarështrohen kur u vjen fundi.
Njeriu është i plogët për të qënë i lumtur. Copë mishi e flashkët.
Janë kohët që janë...

Unë vetë e shoh veten të paplotë kudo
ku u linda e për ku shkoj, grua dhe e huaj,
fole merimange, kashtë mbi fusha armike.
Akrep i rrethuar nga flakët në strofullën
që e kujtoja timen.
Po stërvitem mos të kem frikë.
Po stërvitem mos të kem frikë
nga ajo që ndjej:
ngecur në vënd
poshtë ndonjë hijeje,
e kujdesshme si një hardhucë.
Asnjë hap para. Asnjë mbrapa.
Unë pres e çelin lule.
Sy e buzë të bardha fildishi.
E harlisen kërcellat,
gojët ninullojnë vargje

të hutuara e të trazuara lulet
e hutuar dhe e trazuar gjuha.

Dy

Iknim prej rrënojave të "Një për të gjithë e të gjithë për një".
Tanët mund të kenë zgjedhur gabim
në udhëkryqe.
Tani, mjerisht, në këtë situatë të re
kujdesemi për lehen tonë.
E kemi për zemër
e përkujdesemi për sythat e dherat.
Zgjeruam shtëpitë.
Dhomat me dysheme të lëmuara,
dritaret kanë xhama të fortë.
Njerëzia dashurohen e puthen.
Flenë mbi dyshekë të lartë,
e kujdesen për çarcafët e nënkresat.
E bëjnë fëmijë, qumështorë që të luajnë mëndsh.
Merakosen për fëmijët e tyre.

Sikur një ditë të na duhej të luftonim e të fitonim,
fitore kalimtare dhe e harruar në çast,
përtej gjëmimeve të lodrave,
britmave që çojnë peshë zemrën,
pas trumfit të përbashkët,
shpesh, njëriu mbetet fillikat.

Ti bë që kjo mos të jetë prag i makthit tënd,
e do të fitosh urtësi
në të gjitha humbjet.

Tre

U bë kohë që nuk shoh luledelet.
Të gjitha lëndinat janë në anën tjetër,

ndërsa unë shfaqem këtu si përherë
më dymbëdhjetë e dyzet,
ku gjithçka ujëzohet pas shëtitores Hikmet,
tek përshkoj udhë e rrugica që më çojnë për në shtëpi,
pa mundur të krijoj një lëvizje të re
që të mos jetë katrore, e drejtë, vezore.

Dikur, çdo mes natë, diçka
më urdhëronte të zgjohesha e të drejtohesha për nga ballkoni.
Si për t'u nisur për në një ishull të largët,
për t'ju afruar mëdyshasi breshkave të vogla e detit.
Si të doja të kërkoja nëpër ujëra
binjaken time të urtë,
atë që kam dashur të jem.

Katër

Mbrëmjen e gushtit, aloja ime, dhuratë e papritur,
harlisej njomëzake. Diçka e kuqe, trup i qiellit,
një sy regëtues, dukej si rastësi
mbi çatinë e bujtinës.
Krahu i epërm i Colle-s vezullonte mbi buzë të shpatit
me shtëpitë e çatitë përbrënda të freskuara nga rrebeshi,
ndërsa sakaq, nëpër rrugë, shpatulla u shfaqën,
koka të zeza e flokëkaçurrele.

- Njëqind të tjerë vdiqën dje... i fola vetes,
të gjithë të zinj...

Mund të ishte ndryshe po të shkonin njerëzia
në barkën e Sciacca-s.
E të shihnin kapitenin Giarratano në ujërat e Maltës e peshkatarët,
mëngëpërveshurit që hedhin rrjeta e peshkojnë ikanakët
me sy të shpuar nga dy bishtukë.
Mes syve të kuq si të lemurëve, vagullimeve diellore mbi tëmtha,
e atyre që ja dalin ta kalojnë detin të pacënuar,
do t'i vënë re! Oh, patjetër do t'i vënë re
trupat që dalin prej thellësive
si delfinë të helmuar,
përmbys me qerpikë mbi valë,
ose të kthyer në ajër, me barqe të shtendosura.

Ti vije kapur pas një treni, mall prej kufijsh me dëborë!
Oh, Anthony, i vogli Anthony, je nga të shpëtuarit!
Kristal i agimit të nëntorit e pistil lulëkuqesh,
je nga të shpëtuarit!
Për fatin tënd ogurmirë është gjumëzhegu i ri e shtrati,
ura e ngrohtë e prekja jote mbi brymë të mollëve.

Veç dije që mes nesh
ka nga ata që janë
më të brishtë
se një gjeth mështekne.

Pesë

Shpesh, do të vësh re njerëz
tek heqin tinëz bukë nga pjata e dikujt tjetër,
pasi ky, i ngopur, të jetë çuar.

Shumë prej nesh bëjnë gjëra që nuk duan t'i bëjnë.
Madje edhe ai që në emrin tënd, me fjalë bindëse,
- të gjitha të shenjta, të gjitha me mënd -
armatosur me kryq mbi gjoks,
o me gjysëm hënë jeshile,
o me drapër e çekiç,
arrin majën e lakmuar.

Si ai që i duhet vetëm të fusë duart në xhepa,
të vëzhgojë sheshin nga dritarja, si të ishin pronë e tij
ata që aty shkojnë e vijnë të pambrojtur
me kafkën delikate,
nën peshën e një lufte të padukshme,
e shpërndarë përditë.
Hapërdarë në ajër dhe e frymëmarrë.
Thuajse e paqtë në gjatësi
e shtrirje.
Thuajse e paqtë, Zoti im!

Urimi im, i hajthëm sa një vjollcë,
i fortë si tel me gjëmba,
ka kufij të mirfilltë, e shpreson
që ti të jesh i lehtë, thuajse freskia
që qeton zagushinë mbi zhavorr e zift,
ose në mbrëmje
kur bulkthat e fushës klithin.

Gjashtë

I.
Ajo ishte si unë, kudo e paqetë, e ngjashme
me një ketër idhanak.
Krijuar, si miliarda gjëra,
për një qëllim të panjohur,
për të mendoja si për një bishë.
I druhesha siç i druhem kobrës.
Besnike e përkushtuar,
ose armike e zellshme.
Aleate kurreshtare,
me sy natësor e të merakosur, dukej
sikur donte të ishte unë.
Jo për pak e për lojë,
jo për të marrë e për të falë dashuri,
por për të zotëruar krahun e harkëtarit.

Nuk ja kisha besën.
Veçse më vonë i vura re
edhe njollat e mia.
As më shumë e as më pak se të tjerë.
Krejt të ndryshme hera herës. Mendova se po vdes.
Po të mos e kisha vendosur të mbijetoja
me ndërgjegjen e re
do kisha vdekur patjetër.

II.
Tjetra është gruaja që këndon,
e padije shpërhap rrezet e saj të mira
prej kaçurrelash korb të argjënduar, nga supe kodrinore
e nga goja e kuqe rubin, e çelur
si zemër e kthyer përmbys. Asnjë fundërrinë nga mendime moçalore
mbi faqet e sytë vjeshtor.
Mjafton që të shfaqet vetëm si lëkurë,
vetëm si tingull o vetëm si dorë,
që të ngazëllojë shpirtërat
që banojnë trupat pa i zotëruar.

Njoh të tjera zemërbuta me bijtë e tyre,
me bij nënash të panjohura,
me bijtë e atyre që i kanë kundërshtarë.

Që të lirohen prej zinxhirësh mrekullitë e ndrydhura,
të padukshme në gjëndjen e tyre veçmas,
ndonjëherë, Anthony, mjafton
që të shpërfillet gjaku,
jehona e viseve të lindjes.

Shtatë

Ujisja dikur tre lulet e mia,
e bëhesha thikë e mprehtë.
Errësira ime bëhej liqen, ku unë shkoja e notoja,
si i burgosuri në birucë që noton në liqenin e tij,
e në qiellin e tij fluturon.
E nën diellin e tij ngrohet.

Mbërrinte pastaj agimi, i vërteti.
Krahët e mi dy ngjala në qafën e tij të purpurt.
Buzët e mia mbi gojën e tij të kulluar.
Gati për t'u bërë këpucë, lugë,
këmbët që besimtari lan
para se të shkojë në xhami.
E kujt i vlen pra, të mbushë lot në liqenin e lotëve?

Ti pra ndiqi
ata që shkojnë për pyje të egra
e që u hipin maleve,
që përgjojnë kamoshët e ujqërit, gjuhët e kuqe e dhëmbët,
kur çapëlojnë pretë,
e kur fërkohen shkrepave
kthyer në shpinë.
Ndiq të zellshmit e palodhur,
ata që përpiqen për pak paqe të vërtetë
që të zgjasë. E ata që bëhen pemë
ku të mbështetet shpina, e zemra,
e armët.
Edhe ti ashtu.
Ata,
pemë.
Me rradhë.

Tetë

Tha: O Zot, kjo unë, që shpesh rikrijohet,
mjerisht, e gërvishtur, ka frikë të ardhmen,
gabimet që ribëhen, të vetes e të dashurve të saj.
Kjo unë ka pak mëshirë për mua.
Ndonëse, së fundmi, lëviz në terr
si të lëvizte në dritë,
pa e ndjerë humnerën.

Tha: Bë që të kem guxim kundër të keqes së beftë.
Kur pema më bëhet armike e armik thoi i këmbës.
Më bë burrë – grua, fshikëz mëndafshi.
Ki kujdes për miqtë që kurrë nuk më braktisën.
Balli im ku nëna mbështeste buzët e saj të holla
e gishtat e saj njomnin me akull, kishte nevojë për një frymë
të gjatë.
Shpresat e mia të vogla zbresin e ngjiten në mua.
Të mëdhajat presin jashtë meje.

Tha: Dikur shkoja në paqe me shoqet.
A shkojmë të shohim kur lulëzojnë hurmat?
Kthehemi vonë.
Çuni i shisheve mbledh shishe
përballë dyqanit të peshkut.
Do ta mallkojë pijaneci i lodhur.
Tha: Ndoshta është koha që të përpiqem e lehtë.
Zanafillë në dritën e parë.
Më mirë do bëhemi.

Një roman i ri nga Botimet "POLIS"

IGINIO UGO TARCHETTI

Në kthetrat e dashurisë

Xhorxhoja, një burrë i ri dhe i pashëm, shkëputet përkohësisht nga jeta ushtarake për shkak të një sëmundjeje dhe shkon në Milano, ku njeh Klarën, një grua të bukur dhe plot jetë, e cila i përket një burri tjetër.

Në kulmin e lumturisë, Xhorxhoja detyrohet të kthehet në detyrë, në një qytezë monotone, ku takon Foskën, kushërirën e kolonelit dhe njëkohësisht komandantit të tij. Ajo është një grua tejet e shëmtuar dhe e sëmurë, por edhe inteligjente dhe e kulturuar, ndien një tërheqje fatale për Xhorxhon.

Klara përfaqëson dritën dhe jetën, ndërsa Foska terrin dhe vdekjen. Njëra dhuron lumturi, ndërsa tjetra ushqehet me energjinë e Xhorxhos dhe ia përthith gjithë harenë dhe freskinë e moshës djaloshare.

Ajo çka e bën këtë histori aktuale edhe në ditët e sotme është ankthi, dyzimi midis realitetit të jashtëm dhe atij të ndërtuar në brendi, racionales dhe joracionales, dritës dhe hijes.

Deri ku mund të shkojë ideja e ngulët e një gruaje?

Si të shpëtosh nga kthetrat e dashurisë?

"Unë kisha lindur me një pasion të jashtëzakonshëm. Nuk dija të dashuroja apo të urreja përgjysmë; nuk mund ta ulja shkallën e ndjenjave të mia në atë të burrave të tjerë. Natyra më kishte bërë rebel, krahas masës së përgjithshme dhe ligjeve të zakonshme. Ndaj ishte e drejtë që edhe pasionet e mia të kishin arsye, mënyra, zhvillime dhe përfundime të jashtëzakonshme.

Pata dy dashuri të mëdha, dy dashuri të përjetuara ndryshe, gjithaq fatale dhe të jashtëzakonshme. Me to dhe për to u shua rinia ime.

Do të shkruaj vetëm për njërën nga këto dashuri. Për tjetrën do të flas pak, sa për të treguar kontrastin e frikshëm që krijoi me të parën. Nuk qe aspak një dashuri fatlume. Ta rrëfeja, do të qe sikur ta përsëritja sërish historinë fill e për pe, por nuk ekziston deri më sot ndonjë krijesë që e kam njohur mirë pa e dashur. Ose na braktisin, ose braktisim - shpesh me dëshirë, të kënaqur nga kjo braktisje. E tillë është gatuar zemra njerëzore.

Atë dashuri unë nuk e ndjeva: e pësova. Nuk e di nëse ka në botë të tjerë burra që e kanë kapërcyer një sprovë të këtillë, për më tepër në rrethanat që e kalova unë; nuk e di as nëse ata do t'i mbijetonin dot."

Iginio Ugo Tarchetti (1839-1869) jetoi fare pak, vetëm 30 vjet. Po ndërkaq ai la dhjetëra poezi, romane e tregime. Hoqi dorë nga jeta ushtarake ngaqë ishte pacifist dhe antikonformist.

Në krijimtarinë e tij dashuria shfaqet si një sëmundje patologjike që mund ta çojë njeriun drejt fundit të tij. Po ashtu, spikat për zhbirimet psikologjike dhe përshkrimin e hollësishëm të labirinteve shpirtërore, çka nuk haset tek autorët e tjerë italianë të shekullit të tij.

IGINIO UGO TARCHETTI
Në kthetrat e dashurisë
roman
Përktheu: Geverina Muzhaqi
ISBN 978-9928-352-00-3
Nr. i faqeve: 226
Çmimi: 800 lekë

PO SIKUR TË KEM QENË SPIUN?

Tregim nga Stefan Çapaliku

Dukej si një ditë e zakontë. Lëvizje të njohura, të ngathta. As ftohtë dhe as ngrohtë. Një ditë, kur dimri s'ka ikë dhe pranvera s'ka ardhë. Kisha nevojë për pak diell, sa me të ngrohë kurrizin dhe për pak hije sa me të fresku kokën. Shkurt, një ditë e përsosur për ta çu dëm.

Kështu ka qenë ajo ditë e këtij fillim marsi kur mësova se, për të aplikuar në atë vend pune, duhej të paisesha veç tjerash edhe me një vertetim se nuk kisha qenë bashkëpuntor i sigurimit të shtetit.

Se çka më duhej edhe mua ajo punë, hajde mere vesh?! Boll mirë isha këtu në kateder, ku kam një jetë që punoj.

Mirëpo, ja. Kisha në dorë aplikimin, që sapo e kisha shkarkuar nga interneti, kur u ula në një kafene, diku përkundruall ndërtesës së Autoritetit të Dosjeve. Ky institucion qe ndërtuar tani vonë, domethënë shumë kohë më mbrapa sesa të rrëzohej sistemi. E thënë ndryshe, që ndërtuar tani, që thuajse nuk i duhej askujt, përveç meje apo ndonjë kuriozi tjetër, që donte të dinte nëse kishte qenë ndonjëherë ndën përgjim. Mund t'i duhej edhe ndonjë historiani, që kujdesej individualisht për restaurimin e kujtesës kolektive.

Përndryshe viktimat e komunizmit kishin vdekë ose ishin në të vdekur, të paktën prej kësaj pandemisë së fundit. Xhelatët gjithashtu po rënkonin në të veten. Pra historia po pastronte vetveten si ky kamarieri, që po dëlirte tavolinën, ku kishin pirë kafe disa të tjerë para meje.

Kamarierit, një djali me puçra, i kërkova një kafe dhe një stilopals, sepse formulari duhej plotësuar me dorë.

Megjithëse në kafene s'ishte pothuajse askush, unë i ktheva shpinën të vetmit klient të ulur diku nga fundi i lokalit, që dukej se priste dikë. M'u duk se kur kamarieri solli kafen, qe më i shkurtër se më parë. S'di pse mu duk se ai i hodhi një sy edhe letrave, që sapo kisha vënë mbi tavolinë. Interesant. Njerëzit, sado analfabet të jenë, prapëseprapë mbeten kuriozë. Aty anash filxhanit qe një copë pusull, që ia sillnin të gjithë klientëve. E hapa edhe unë. Zakon dreqi ky, të lexoj gjithçka. Te pusulla ime qe shkruar "Kush vrapon pas së vertetës nuk lodhet kurrë."

Kur isha në Pragë, si student pasuniversitar më 1993, dëgjoheshin gjithfarë lajmesh, për njerëz që thërrisnin me të madhe nëpër kishat e Çekisë se kishin qenë spijunë. Kjo ndodhte kryesisht të dielave dhe më së shumti në kishat e fshatrave dhe qytezave periferike. Aso kohe shihej qartë se po ndodhte një katarsis kolektiv. Ata gjenin vendin më të përshtatshëm për t'u rrëfyer dhe për të kërkuar falje në sy të gjithëve. Kishte prej atyre që kërkonin edhe ndëshkim.

Ndërkaq shkrova emrin me germa kapitale: STEFAN ÇAPALIKU. Atësia LAZER. Amësia ELEFTERIA. Ditëlindja: 10. 03. 1965.

Kurse në vendin tim në Shqipëri, aso kohe pata marrë vesh se presidenti pat deklaruar se ne qenkërshim të gjithë bashkëvuajtës dhe bashkëfajtor. Mua më dukej se ky qe një sinjal i qartë për t'i bërë me dije gjithë xhelatëve, se nuk ishte nevoja të prishnin qetësinë publike nëpër kisha dhe xhamia, si në Çeki, por të rrinin rehat nëpër shtëpitë e veta, se askush s'kishte për t'i ngacmuar.

Më poshtë vinin me radhë disa opsione që duheshin të klikoheshin, të tipit, arsyeja e paraqitjes së kërkesës për informim mbi dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit: "Për të qartësuar fatin e të vdekurve a të zhdukurve", "Për të vertetuar se nuk keni qenë bashkpunëtor", "Për t'u informuar nëse keni qenë ndonjëherë i survejuar"

Fillimisht mendova të klikoj vetëm mbi pikën e dytë se nuk kam qenë bashkëpuntor, por mandej thashë se s'kishte me qenë keq me marrë vesh edhe nëse kam qenë në survejim. Dikur, sidomos kur qeshë student, kam pas llapur pak si shumë.

Erdhi prapë kamarieri dhe më tha se kafen e kisha prej atij burrit në qoshe. Ktheva kokën ta përshëndesja, por ai as që m'i hodhi sytë. Atëhere u ktheva edhe njëherë te formularët me një farë çudie se ku e njihja atë njeri. Por, do ishte e mira të shkoja diku tjetër. Në një kafene tjetër ndoshta. Nuk po e kuptoja. Në të vertetë diçka po ndodhte brenda meje. Atëhere, do të paguaj stilolapsin, i thashë kamarierit. Më duhet, se fillova të punoj me të dhe ndoshta nuk ishte e mira ta ndërroja. Pse më kapi kjo ndjesia e të mos ndenjurit gjatë në një vend?! Kamarieri ma fali stilolapsin, si të mos e kishte kuptuar gatishmërinë time për ta paguar.

Dola. Plot njerëz në rrugë. Vëreja se formuloja ca si buzëqeshje kote dhe të pangjyra dhe se ia tundja kokën me një mirësjellje të shtirur gjithë fytyrave që shikoja rrotull.

Kur ra komunizmi unë sapo kisha mbushur të 25 vjetët. Pra në një farë mënyre pata qenë në një moshë kur mund të hamendësohej mospërlyerja, por nga ana tjetër asgjë nuk e përjashtonte mundësinë teorike që edhe të kisha qenë ndën vëzhgim apo prite Zot edhe bashkëpuntor.

Pra me pak fjalë qeshë nisur të shkoja në një vend të pazakontë. Dakort se i pazakontë, dakord edhe se veç njëherë në jetë shkoje në të, por ç'e kisha atë si farë sikleti në fund të barkut?! Unë në fund të fundit thjeshtë po çoja kërkesën për të vertetuar pastërtinë e figurës sime, gjatë periudhës së diktaturës. Kaq. Asgjë më shumë e asgjë për t'u çuditur... Pastaj kur unë isha student komunizmi kishte marrë fund *de facto*. Nuk kishte kurrfarë mundësie të merrej me ne, të rinjtë...

Me siguri që të nesermen e asaj ditë kur presidenti tha se të gjithë kishim qenë bashkëvuajtës dhe të gjithë bashkëfajtor, një pjesë e shoqërisë shqiptare ka pasur një çlirim të madh, si të ishin këmbë që çliroheshin nga një palë këpucë fort të ngushta apo kasnakë, që pushonin në paqe mbas heqjes së protezave të dhëmbëve.

Të kisha qenë ndën vëzhgim do kishte qenë mirë dhe njëfarë mënyrë edhe mund ta përdorje si një kartë desidence, por të kishe qenë bashkëpunëtor, atëhere ishte ç'ishte. Imagjinoni ta marrin vesh fëmija se i ati kishte qenë bashkëpuntor në krim, qoftë edhe i bërë me forcë apo ndën presion?! E tmerrshme.

Por unë nuk kisha kurrfarë frike të kisha pas qenë spijun. Unë nuk kisha qenë kurrë spijun. Kjo është e qartë. Por..., por, ku i dihet. Po sikur të kisha qenë? Si të kisha qenë, kur unë nuk e dija të kisha qenë?! Ç'flet kështu?! Je në vete?! Gjithçka bën vaki. Në këtë vend, bën vaki gjithçka, gjithçka... Po sikur të më kishin rekrutuar, ashtu pa e dijtë unë, pa qenë i ndërgjegjshëm domethënë. Kushedi se si kishte qenë puna. Si kushedi?! Po unë e di. Si nuk e ditkam.

Dhe kjo mëdyshje u zgjua dhe mori krahë sapo takova Markun. Markun e takova sapo hyra në katin e parë të ndërtesës, aty te recepsioni... Dhe e dini se ç'më tha Marku, duke dashur të më jepte zemër? Se ai në fakt duhet të ketë ndjerë një farë ankthi, që kisha brenda vetes. Sepse ndoshta se kisha vetëm brenda vetes. Si duket më kishte dalë edhe jashtë. Dhe Marku me të drejtë e kishte vënë re.

Një shok i tij, piktor, më tha Marku, doli spijun pa pas qenë. Si doli spijun pa pas qenë, e pyeta unë i çuditur. Po, tha Marku, i kënaqur prej kuriozitetit tim. Po, atij i kishin dhënë aso kohe një studio pikture. Ndaj dhe një ditë, një i njohur, që paska pas qenë oficer sigurimi, ia kishte kërkuar çelësin. Kurvar i madh, pati menduar piktori dhe ia kishte dhënë çelësin e studios pa një pa dy. Mirëpo ai zotëria, në vend që të fuste në studio një femër, paska pas futë një rrezikzi, për ta rekrutuar e për ta bërë informator. Mandej në darkë ka shkruar një raport mbi rekrutimin e këtij informatori të ri, duke nënvizuar se takimin me rishtarin e kishte realizuar te një bazë, siç qe studioja e filan fistekut. Kësisoj emri i piktorit rezulton në listën e bashkëpuntorëve të sigurimit, a po më kupton, më pyeti Marku, me një nëntekst, që dreqi e di se ku të çonte.

Hej more dreq... Nejse. Lashë aplikimin atje dhe ika. Ajo zonja te recepsioni më tha se po të kisha klikuar vetëm opsionin "nëse kisha qenë bashkëpunëtor", përgjigja vinte për dy javë, por meqenëse unë kisha kërkuar të dija edhe se a kisha qenë në survejim, atëhere kjo e zgjaste procedurën, që mund të shkonte deri në një muaj a më tepër.

Po sikur unë të kisha qenë në vëzhgim atëhere kjo donte të thoshte se kishin qenë shokët e mi ato që më kishin paditur. I kujtova me radhë ata që kisha pasë në fakultet, sepse në gjimnaz, vështirë t'i ketë rënë ndër mend njeriu për mua. Po sikur ndonjëri prej tyre të dilte spijun? Dy prej tyre unë i kisha dhe i kam si vëllezër.

Ika. Po jetonim kohë të mbrapshta. Te puna ime kishin lajmëruar se së shpejti do fillojmë e vaksinohemi kundër koronavirusit. Ne profesorëve universitarë do na vaksinonin me një markë të dyshimtë "AstraZeneca". Unë jam njeri që besoj te shkenca. Nuk kam dyshime për këtë. Por "AstraZeneca" ka pasë disa kontestime të tipit: nuk lejohet mbi 65 vjeç se të trashë gjakun dhe rrezikon për tromboza apo se janë numëruar edhe të vdekur në radhët e atyrë që e kanë bërë.

Nuk di njeriu i shkretë me kë të merret më parë: me të shkuarën apo me të ardhmen e vet. Shpesh e shkuara përcakton të ardhmen, por këtu te ne mundet që edhe e ardhmja të të përcaktojë të shkuarën.

Në kthim ndalem ta pyes atë kamarierin, ku piva kafen e mjesit, se kush ishte ai tipi që më qerasi. Është burrë i mirë, më tha kamarieri, jeton këtu mbi klub, në katin e tretë. Të gjithë flasin mirë për të. Ka qenë operativi i lagjes gjatë kohës së komunizmit dhe tani në demokraci ka punuar si inspektor në Shërbimin informativ kombëtar. Ashtu?! Po ç'ne që më pagoi kafen, i thashë kamarierit. Ia pagova profesorit, më tha, se kam shumë respekt për të.

Dola me vrik. Zot, çfarë qefi! Po, a ishte mirë që një ish operariv të kishte respekt për ty?



Mjelma në dëborën që bie

poezi amerikane përkthyer nga Roland Gjoza

HOWARD SIMON
unë zgjedh malin

Më thërret fusha
Dhe unë s'kam si të mos i përgjigjem
Më jep një copë tokë falas
Pa qenë nevoja që ta grabis
Mali masiv lëviz
Më thërret që të ngjitem
Në një shteg shumë të vështirë
Nëpër kthesa të rrëshqitshme
Nuk mund t'i zgjedh të dyja
Po kam përpara një zgjidhje
Dhe duhet të tregohem i matur
Se kam të bëj me fatin
Unë zgjedh, unë zgjedh malin
Me gjithë stresin dhe mundimet e tij
Sepse vetëm duke u ngjitur
Mund të ngrihem mbi fushën
Unë zgjedh malin
Dhe ngjitem e ngjitem pa u ndalur
Unë zgjedh malin
Dhe do të jem gjithmonë duke u ngjitur
Unë zgjedh malin

ROBERT FROST
asgjë prej ari nuk rron, po vdes

Ngjyra e gjelbër në natyrë është prej ari
Po sa vështirë të mbetet
Një lule është gjethja e saj e parë
Rron vetëm ca orë dhe tretet
Kështu dhe vetë gjethja zverdh mbi gjethe
Edeni në trishtim e shkon jetën
Agimi shuhet në ditën me diell
Asgjë prej ari nuk rron, po vdes.

KAY RYAN
lumi niagara

Sikur lumi
të ishte dysheme
dhe ne të vinim mbi të
tryezën dhe karriget
mbi lumë të hanim,
të flisnim.
Dhe sëbashku të lëviznim
duke vënë re
se si pikturat në dhomën e ngrënies
po zëvendësoheshin
me pamjet që ndryshonin
përgjatë bregut. Ne
e dimë, e dimë sigurisht
që ky është lumi Niagara, por
është e vështirë të mbajmë mend
këtë që ndodhi.

WILLIAM CARLOS WILLIAMS
lule në breg të oqeanit

kur lulëzimi ngre kullotën lart mbi breg
nuk duket oqeani i kripur

ngrenë format e tyre çikorja dhe margarita
lidhur e përqafuar sikur nuk duan të rrinë vetëm

ngjyra dhe lëvizje, forma të shqetësimit ndoshta
dhe oqeani rrethohet, lëkundet

në një paqe rrëqethëse
mbi kërcejtë e luleve.

MAYA ANGELOU
grua fenomenale

Gratë e bukura duan të dinë se ku fshihet sekreti im
Sepse unë nuk jam e veçantë as nuk jam krijuar sipas modës
Kur përpiqem t'ua shpjegoj
Ato mendojnë se unë po i gënjej
Atëherë unë po iu them
Se është te shtrirja e krahëve të mi
Sensualiteti i ijeve
Hapat energjik
Buzët e mishtorme
Unë jam një grua
Fenomenale
Një grua fenomenale
Jam unë

Hyj në një dhomë
Më indiferente se çdo të donin
Ai burrë, apo miqtë e tij
Apo ata që
Janë ulur në gjunjë
Pastaj të gjjithë më rrethojnë
Si bletët në një zgjua me mjaltë
Dhe unë iu them se kjo ndodh
Prej zjarrit në sytë e mi
Shkëlqimit verbues të dhëmbëve
Lëkundjes drithëruese të belit
Gëzimit brafullues të këmbëve
Unë jam një grua
Fenomenale
Një grua fenomenale
Jam unë

Burrat janë mjaftuar
Tek ajo që shohin tek unë
Ata përpiqen të zbulojnë
Misterin që fshihet te gruaja
Por nuk e arrijnë dot
Kur nis t'ua shpjegoj
Ata s'më kuptojnë
Dhe unë iu them
Është te harku që merr shpina ime
Te buzëqeshja me një diell që vetëm lind
Te tundja e gjinjve
Hiri i stilit tim
Une jam një grua
Fenomenale
Një grua fenomenale
Jam unë

Tani e kuptoni, besoj
Pse nuk e ul kokën
Nuk ulërij, nuk nxehem
Nuk flas me zë të lartë
Kur më shihni duke kaluar
Dua t'iu bëj krenar.
Unë iu them se kjo
Fshihet te goditja e thembrave të mia
Përdredhja e flokëve të mi
Pëllëmba e dorës sime
Kujdesi për veten
Unë jam një grua
Fenomenale
Një grua fenomenale
Jam unë

ANNE SEXTON
natyra e saj

Po shkoj, fuqi e shtrigës jam unë
e përhitura në ajrin e zi, trimëreshë e natës
kam ëndërruar djallin, mori fund dhe tundimi im
mbi shtëpitë që duken dritat ndizen dhe fiken aty-këtu
e vetmja gjë; të kesh dymbëdhjetë gishtërinj anormalë dhe t'ia mbathësh prej këtu.
Një grua që e pëlqen këtë gjë nuk është një grua e vërtetë
Natyrën e saj kam unë.

Gjej guva të ngrohta në pyje, në drurë
i mbush me tiganë, art, rafte
dollapë, mëndafshe, sende pa fund
gatuaj një darkë për krimba dhe kacabuj
dua të vë rregull, po është e pamundur
Një grua që e pëlqen këtë gjë nuk kuptohet kurrë
Natyrën e saj kam unë.

Më hip në këtë karro spitali dhe më nis
mbi fshatra të tund krahët e mi lakuriq
të përshkojmë rrugët e fundit në infinit, rrugët më të ndritshme
të ringjallem sërish, flaka jote kofshët të m'i përpijë
brinjët të më shkallmohen prej erës që fryn me pohe e bujë.
Një grua që e pëlqen këtë gjë nuk e mallkon vdekjen
Natyrën e saj kam unë.

DENISE LEVERTOV
mjelma në dëborën që bie

Në ndajnatherë, krejt i hollë ky imazh i çuditshëm
Përgjysmë ngrica që kërcet
Një dukje e gënjeshtërt shfaqet
I ngjan kaq shumë një fuçie në këmbë, një zemre - fantom në dëborën që bie
Ngricë kumbimtrishtë, kjo bardhësi që po shohim
Ka një identitet dritherues në një palëvizshmëri tronditëse
Në breg të liqenit. Nga afër një shfaqje zie
Sqep dhe maskë- bëjnë majë më qartë, qafa e gjatë si
Cilindër dhe gishtërinjtë me membranë e këmbëve
Vënë në balancë trishtimin,
Është krejt e palëvizshme. I zi uji pas saj
Duket sikur e ka braktisur
Ende i butë ajri, flokët e dëborës
Bien dhe bien. Heshtje infernale
E thellë, e thellë. Dita e mbetur,
Shkurton veten e vet, gjersa humbet

MARK STRAND
NË VERANDË, NATËN

T'ia ngulësh shikimin asgjëse është si të rrëmosh në zemër
Kush nga ne nuk do të pastrojë diçka dhe të zbulojë vetveten
Era të bën të ndjesh të paimagjinueshmen diku afër teje
Pemët lëkunden ose rrinë pa lëvizur. Dita ose nata bëjnë c't'iu teket.
Çfarë ne dëshirojmë është nje stinë më tepër, një mot i ri, komforti
Për të qenë të panjohur, qoftë dhe me vetveten, Ky është thelbi i çështjes
Pse ne tani dukemi sikur presim diçka që e kemi humbur-
Fërmimin e gjetheve që bien, ose të nje gjetheje të vetme,
Ose asgjënë. Nuk është kjo ç'kemi mësuar. Libri s'bën punë
Nuk tregon kaq shumë dhe ne kurrë nuk kemi shkruar më tepër se ç'kemi patur në mendje.

SAMANTA SCHWEBLIN

dyzet centimetra katrore

Tregim

Përktheu nga spanjishtja Erion Karabolli

Vjehrra ime më kërkon t'i blej aspirina. Më jep dy kartëmonedha dhe më tregon se si të shkoj deri te farmacia më e afërt.

- E sigurt që nuk e ke bezdi të shkosh?

I them se jo dhe shkoj drejt derës. Përpiqem ta heq nga mendja historinë që sapo më tregoi, por apartamenti është i vogël dhe duhen shmangur aq shumë mobilie, aq shumë sergjene dhe rafte të mbushura plot e përplot, sa e kam të vështirë të mendoj për tjetër gjë. Dal nga apartamenti në korridorin e errët. Nuk e ndez dritën, parapëlqej që drita të vijë vetë, kur dyert e ashensorit të hapen dhe të më ndriçojnë.

Vjehrra ime vendosi një pemë krishtlindjesh mbi oxhak. Është një oxhak me gaz e me gurë artificialë dhe ajo ngulmon ta marrë me vete, sa herë që ndryshon apartament. Pema e krishtlindjeve ka gjatësinë e një xhuxhi, është e hollë dhe ka një ngjyrë të blertë e të çelur artificiale. Ka ca poçe të kuqe, dy kurora të praruara dhe gjashtë kukulla babagjyshërish të varura te degët, si të ishte ndonjë klub të varurish. Unë ndalem ta shoh disa herë gjatë ditës, ose mendoj për të, ndërkohë që merrem me punë të tjera. Mendoj se ime ëmë blinte kurora shumë më të lehta dhe të buta, dhe se sytë e babagjyshërve nuk janë të vizatuar saktësisht mbi gropat e syve, ku duhet të ishin.

Kur mbërrij te farmacia që më tha vjehrra, shoh se është e mbyllur. Është ora dhjetë e një çerek e natës dhe do më duhet të kërkoj ndonjë farmaci të hapur. Nuk e njoh lagjen dhe nuk dua ta thërras Marianon, kështu që, duke parë lëvizjen e makinave, marr me mend se nga ndodhet bulevardi më i afërt dhe eci në atë drejtim. Duhet të mësohem sërish me këtë qytet.

Para se të udhëtonim për në Spanjë, e dorëzuam apartamentin që kishim me qira dhe i paketuam gjërat që nuk do t'i merrnim me vete. Ime ëmë solli kuti nga puna e saj; dyzet e shtatë kuti vere nga Mendosa, të cilat i mbushëm pak nga pak, sipas nevojës. Dy herët që Mariano na la vetëm, ime ëmë më pyeti sërish përse po iknim në të vërtetë, por asnjërën nga të dyja herët nuk munda t'i përgjigjesha. Një kamion shpërnguljesh i çoi gjithë gjërat deri te një depo. Këtë e mbaj mend, sepse jam thuajse e sigurt që në kutinë ku shkruhet "banjë», ka një pako me aspirina. Por tani, sërish në Buenos Aires, ende nuk kemi shkuar t'i marrim gjërat. Më parë, duhet gjetur një apartament dhe përpara kësaj, duhet mbledhur prapë një pjesë e gjithë parave që humbëm.

Pak më parë, vjehrra më tregoi atë historinë e tmerrshme, por ma tregoi me krenari dhe tha se dikush duhet ta shkruante. Ka ndodhur përpara divorcit të saj, përpara se të shitej shtëpia dhe ajo të na ndihmonte me pará për të ikur në Spanjë. Pastaj i ra tensioni, e kapi ajo dhimbja e tmerrshme e kokës dhe më dërgoi të blija aspirina. Ajo mendon se më ka marrë malli për time ëmë dhe nuk e kupton përse nuk dua ta marr në telefon.

Një bllok më tej, mbi bulevard, më zënë sytë një farmaci. Pres të hapet semafori, për të kaluar rrugën. Edhe ajo është e mbyllur, por ka një listë me orare farmacish. Nëse jam e orientuar mirë, ka një farmaci të hapur në anën tjetër të bulevardit *Santa Fe*, pasi kalon shinat e stacionit *Karransa*. Është nja katër blloqe më tej, por tashmë jam larguar mjaft. Mendoj se do të ishte mirë që Mariano të mbërrinte tani në shtëpi e ta pyeste të ëmën për mua, dhe asaj t'i duhej ta sqaronte, duke i thënë se më ka dërguar të blej aspirina në dhjetë e gjysmë të natës, në një lagje që unë s'e njoh. Pastaj pyes veten për çfarë do të shërbente kjo gjë.

Gjëja e parë që më tregoi vjehrra, qe se, në atë moment, ajo ishte në këmbë në mes të dhomës së ngrënies së shtëpisë së saj. I shoqi ishte në punë, por do të kthehej së shpejti. Katër fëmijët gjithashtu ishin jashtë, njëri në punë me të atin, të tjerët në shkollë. Një natë më parë, ishte zënë sërish me të shoqin dhe i kishte kërkuar divorcin. Shtëpia ishte e madhe dhe ajo e kishte humbur kontrollin mbi të. Tani, kontrollin e kishte marrë në dorë gruaja që pastronte dhe ajo nuk mund të thoshte se çfarë kishte nëpër dollapë apo çfarë mungonte në raftet e kuzhinës. Kur uleshin në tryezë, fëmijët kënaqeshin teksa e shihnin duke ngrënë. Nëse kishte pulë, ajo i kruante kockat tërë ankth, nëse kishte ëmbëlsirë, ajo merrte dy racione për vete dhe pinte ujë me gojën plot. Ngaqë ndihem shumë e vetmuar, thoshte ajo me vete, dhe fëmijët e mi i besojnë vetëm babait të tyre.

Marr rrugën e parë drejt shinave, por është e mbyllur, është një rrugë pa dalje, dhe e njëjta gjë ndodh edhe me rrugën e mëpasshme. Kërkoj dikë, për ta pyetur. Gjej një grua, e cila më vështron me mosbesim. Thotë se dy rrugë më poshtë, mund të kalohet në anën tjetër të bulevardit *Santa Fe*, nëpër tunelin e metrosë.

Pra, atë ditë vjehrra ime ishte në këmbë, mu në mes të dhomës së ngrënies, këqyri duart e saj dhe vendosi për hapin e mëpasshëm. Kapi pallton dhe çantën e dorës, doli nga shtëpia dhe mori një taksi deri në rrugën *Libertad*. Binte rrebesh, por ajo ndiente se, po të mos e bënte në çast atë që duhet të bënte, nuk kishte për ta bërë kurrë më. Kur zbriti nga taksia, sandalet iu bënë qull, uji i mbërrinte deri në nyell të këmbës. I ra ziles së një shitoreje shitblerjeje floriri. E pa shitësin tek afrohej mes banakëve të shndritshëm. Ma ha mendja se ai ia hapi derën, duke e këqyrur nga koka te këmbët, duke i ardhur keq që dikush po hynte e bërë qull në shitoren e tij. Brenda, kondicioneri ishte në majë dhe ajri e godiste vjehrrën prapa koke.

- Dua të shes këtë unazë, - tha ajo.

Mendoi se do ta kishte të zorshme ta hiqte nga gishti, ngaqë ishte shëndoshur shumë, por ishte bërë qull dhe unaza doli pa forcë.

Shitësi e vendosi mbi një peshore të vogël elektronike.

- Mund t'ju jap tridhjetë dollarë.

Ajo u mendua disa sekonda për t'i kthyer përgjigje. Pastaj i tha:

- Është unaza ime e martesës.

Dhe shitësi ia ktheu:

- Kaq vlen.

Tani po zbres te hyrja e metrosë dhe ndjek tunelin, për të kaluar në anën tjetër të bulevardit. Përballë tabelave të bigëzimit, e njoh vendin dhe më kujtohet se kam qenë edhe herë të tjera aty. Në të djathtë, pasi i zbret akoma shkallët, është stacioni ku ndalon metroja, në të majtë është dalja. Ndoshta ngaqë mendoj se duhet të ketë ndonjë farmaci në metro, ose ngaqë dua ta kujtoj pak më shumë stacionin, zbres shkallët në të djathtë. E harxhoj kohën kot, ngaqë kjo më ndihmon të vazhdoj përpara, u bë një muaj e gjysmë që nuk kam absolutisht asgjë për të bërë. Kështu që, shkoj në drejtim të stacionit. Kam me vete një kartë metroje, e cila vlen ende. Po mbërrin një tren. Në stacion ka pak njerëz, ngaqë metroja mbyllet në orën njëmbëdhjetë. Dikush zgjat kokën nga vagoni i parë, ndoshta është ndonjë rojë, i cili pyet veten në do të hipi unë apo jo. Kur treni largohet, ulem në njërin nga stolat e zbrazët. Stacioni mbetet në heshtje dhe atëherë diçka lëviz pak më tutje stolit. Është një burrë plak, i ulur përtokë.

Është një lypës, këmbët e tij përfundojnë në dy cungje, pak më poshtë gjunjëve. Ai këqyr reklamën e shampos që është në krahun tjetër të shinave.

Vjehrra ime i pranoi paratë, më tregoi se doli nga shitorja duke fërkuar gishtin e unazës. Jashtë, shiu kishte pushuar, por uji ende arrinte deri te shitoret dhe sandalet e lagura i vrisnin këmbët. Pas disa ditësh, ajo do t'i këmbente dollarët që kishte në xhep, për një palë sandale, të cilat kurrë nuk do ta merrte guximin t'i mbathte, e megjithatë, do të vazhdonte e martuar edhe njëzet e gjashtë javë të tjera. Këtë ma tregoi në kuzhinë, teksa lyente thonjtë. Tha se nuk i nevojiten paratë që na dha për të shkuar në Spanjë dhe se mund t'ia kthejmë kur të duam. Tha se e merr shumë malli për fëmijët, por e di se ata janë të zënë me punët e tyre dhe nuk dëshiron të bëhet e bezdisshme, duke i telefonuar aq sa do të donte ajo në të vërtetë. Mendova se duhet ta dëgjoja, se e kisha për detyrë, sepse po jetoja në shtëpinë e saj dhe sepse ndihesha fajtore që nuk e kishte më unazën e saj tridhjetëdollarëshe. Sepse këmbëngulte të na gatuante dhe të na hekuroste rrobat sa herë që i lanim, sepse ajo qysh në fillim ishte treguar aq e mirë me mua. Gjithashtu më tha se i kërkoi fqinjës së apartamentit "C» gazetën e së dielës dhe kontrolloi mos kishte ndonjë apartament të ri për t'u shpërngulur, pasi as ky nuk i dukej mjaft i ndriçuar. E dëgjova, sepse nuk kisha tjetër gjë për të bërë dhe e pashë, sepse ishte ulur përpara pemës së krishtlindjeve. Dhe, së fundmi, tha që i pëlqente shumë të bisedonte me mua, ashtu, si dy shoqe. Tha se, kur kishte qenë e vogël, në kuzhinën e shtëpisë së saj bisedohej për gjithçka, se do të donte që nëna e saj të jetonte ende me të. Qëndroi një copë herë e heshtur, kështu që unë u përpoqa të hapja sërish revistën, por ajo tha:

- Kur i kërkoj diçka Zotit, i lutem kështu: Zot, ti bëj aq sa mundesh, - dhe psherëtiu thellë. - Me gjithë mend, nuk i kërkoj asgjë në veçanti. Duke i dëgjuar aq shumë njerëzit, mësova se jo gjithmonë kërkojnë atë çka është më e mira për ta.

Atëherë tha se po i dhembte shumë koka, se po i merreshin mendtë dhe më pyeti nëse nuk e kisha bezdi të shkoja për të blerë aspirina. Një tren tjetër po ikën nga stacioni. Lypësi më vështron dhe më thotë:

- As ju nuk po prisni asnjë tren?

- Më duhen kutitë e mia, - i them, sepse papritur kujtohem për to dhe në këtë mënyrë e kuptoj se çfarë është ajo që kërkoj, përse jam ende e ulur në këtë stol.

Por vjehrra ime tha edhe diçka tjetër. Diçka shumë të pamend, e cila nuk më hiqet më nga koka. Tha që, pasi doli nga shitorja me tridhjetë dollarët e saj, nuk mund të kthehej në shtëpi. Kishte pará për të marrë taksi, e mbante mend adresën, nuk kishte ndonjë gjë tjetër për të bërë, por thjesht nuk mund të kthehej. Eci deri te qoshja e rrugës, ku ishte një ndalesë autobusësh, u ul në stolin prej metali dhe ndenji atje. Këqyri njerëzit. As nuk donte e as nuk mundej të mendonte për asgjë, e as të nxirrte ndonjë përfundim. Thjesht mund të këqyrte e të merrte frymë, sepse trupi i saj e bënte automatikisht këtë. Një kohë e papërcaktueshme përmbushej në mënyrë ciklike, autobusi mbërrinte dhe ikte, ndalesa mbetej e zbrazët dhe mbushej sërish. Njerëzit që prisnin, përherë ishin të ngarkuar me diçka. I mbanin gjërat e tyre në trasta, në çanta, nën sqetull, të varura në duar, të mbështetura përtokë mes këmbëve. Ata ishin aty për t'u kujdesur për gjërat e tyre dhe si shkëmbim gjërat e tyre i mbanin ata.

Lypësi kacavaret te stoli im. Nuk e kuptoj se si e bën dhe më tremb fakti që ai mund të lëvizë aq shpejt. Kundërmon erë plehrash, por është i sjellshëm. Nxjerr një hartë rrugësh nga qesja e tij.

- Ju doni kutitë tuaja, - më thotë dhe e hap hartën para meje, - por nuk dini si të shkoni deri atje...

Ndonëse është një hartë e vjetër, unë arrij t'i dalloj stacionet e metrosë së qytetit, të shënuara në të. Nga *Retiro* në *Konstitusion*, dhe nga *Qendra* deri në *Çakarita*.

Vjehrra ime thotë se i kujtohet gjithçka, aq mirë i kujtohet sa mund ta përshkruajë çdonjërën prej gjërave që mbanin njerëzit. Por ajo vetë i kishte duart e zbrazëta. Dhe nuk shkonte asgjëkund. Më tha se ishte e ulur në dyzet centimetra katrore, këtë më tha. Mezi e kuptova. Është e vështirë ta mendosh vjehrrën time duke thënë diçka të tillë, ndonëse ato qenë fjalët e saj: që ishte e ulur në dyzet centimetra katrore dhe që ajo ishte gjithë hapësira që zinte trupi i saj në këtë botë.

Lypësi më pret. Ai i ul një sekondë sytë dhe unë zbuloj se, mbi qepalla, ka të vizatuar një palë sy të tjerë, ashtu si babagjyshërit e pemës së krishtlindjeve. I them vetes se duhet të ngrihem në këmbë, se, me të mbërritur te depoja, do ta dalloj menjëherë kutinë që më duhet. Por s'mundem. Nuk mundem të lëviz dot nga vendi. Po të ngrihem, nuk do ta shmang dot të mos e shoh se sa vend zë realisht trupi im. Dhe, po ta vështroj hartën - lypësi tani ma afron edhe pak më shumë, që ta shoh më mirë, - do të zbuloj se, në tërë qytetin, nuk ka asnjë vend, të cilin unë mund t'ia tregoj me gisht.



Romani "Me lumin midis"
i shkrimtarit kenian
NGŨGĨ WA THIONG'O
botuar nga "Arka e Noes"

Një histori dashurie Romeo dhe Zhuljeta afrikane

NGŨGĨ WA THIONG'O (1938) është një prej shkrimtarëve më të rëndësishëm kenian dhe prej tri vitesh kandidat për Çmimin Nobel në Letërsi. Ai është profesor i Letërsisë së Krahasuar në Universitetin e Kalifornisë dhe ka shkruar romane, jetëshkrime, tregime dhe drama. Ndër romanet e tjera më të njohura të tij janë "Petale gjaku" dhe "Magjistari i korbave", ky i fundit i botuar më 2006 dhe i cilësuar si kryevepra që ka kurorëzuar gjithë jetën e tij shkrimore. Librat e Ngũgĩ Wa Thiong'o-s janë përkthyer në mbi 30 gjuhë të botës.

"Me lumin midis" (romani i dytë i autorit) është një histori dashurie e vendosur në periudhën koloniale, njëfarë *Romeo dhe Zhuljeta* afrikane, ku rrëfehet dashuria midis dy të rinjve të fiseve kundërshtare Gikuju të kreshtave, si dhe përpjekja e tyre për të shuar mërinë e lashtë midis fiseve të tyre. Romani rrëfen Kenian para-koloniale dhe atë koloniale, ardhjen e "një populli të veshur me flutura" të cilët ishin britanikët, sjelljen e kulturës së tyre, fetare dhe administrative. Ndërkohë, popullsia jeton ende me zakonet e vjetra që janë shtylla e mbijetesës së tyre, të forcës, besimit dhe pastërtisë. Përplasja midis dy fiseve është gjithashtu ballafaqimi me kolonizatorët, po aq sa dhe vendimi për t'iu nënshtruar atyre apo të qëndruarit të paepur në besimin e lashtë që i ka udhëhequr.

KAPITULLI NJË

Dy kreshtat shtriheshin pranë e pranë. Njëra ishte Kameno, tjetra ishte Makuju. Mes tyre ndodhej një luginë. E quanin Lugina e Jetës. Mbrapa Kamenos dhe Makujut kishte shumë lugina e kreshta të tjera, të cilat shtriheshin pa ndonjë përvijim të qartë. Ato përngjanin me luanë të shumtë e të fjetur që nuk zgjoheshin kurrë. Thjesht bënin gjumin e madh e të thellë të Krijuesit të tyre.

Përmes Luginës së Jetës rridhte një lumë. Po të mos ishin shkurret dhe pemët pyjore që mbulonin shpatet, lumin mund ta shihje kur rrije majë Kamenos apo Makujut. Por ashtu siç ishte, duhej të zbrisje poshtë. Madje edhe atëherë nuk e shihje dot gjithë gjatësinë e lumit, tek spërdridhej nëpër luginë me hijeshi e pa ndonjë ngut të dukshëm, si një gjarpër. Lumi quhej Honia, që do të thoshte shërim apo kthim në jetë. Lumi Honia nuk thahej kurrë, ai dukej se zotëronte një vullnet të fortë për të jetuar, duke përçmuar thatësirat dhe ndryshimet e motit. Ai rridhte po njësoj, pa nxituar, pa nguruar. Njerëzit e shihnin këtë dhe ishin të lumtur.

Honia ishte shpirti i Kamenos dhe Makujut. Ai i bashkonte ato. Edhe njerëzia, bagëtitë, kafshët e egra dhe pemët, të gjithë bashkoheshin nga kjo rrjedhë jete.

Kur rrije në luginë, dy kreshtat, të bashkuara nga burimi i tyre i përbashkët i jetës, nuk ishin më si luanë të fjetur. Ato bëheshin kundërshtare. Këtë e kuptoje jo nga ndonjë gjë e prekshme, por nga mënyra sesi përballeshin me njëratjetrën, si dy rivale gati për t'u kapur me grushte në një ndeshje për jetë a vdekjeje për udhëheqjen e asaj krahine të veçuar.

***

Kishte nisur shumë kohë më parë. Një njeri u ngrit në Makuju. Ai mëtonte se Gikuju dhe Mumbi ishin ndalur aty me Murungun, rrugës për në Mukuruve va Gatanga. Si rrjedhojë e atij qëndrimi, thoshte ai, udhëheqja i ishte lënë Makujut. Nuk e besuan të gjithë. Ngase a nuk ishte pëshpëritur e përfolur gjithnjë se Gikuju dhe Mumbi ishin ndalur në Kameno? Dhe a nuk kishte mbirë një kodër e vogël nga trualli mbi të cilin kishin qëndruar, në jug të Kamenos? Dhe Murungu u kishte thënë: "Këtë tokë po ua jap juve, o burrë dhe grua. Është juaja që ta sundoni dhe ta lëroni, ju dhe pasardhësit tuaj".

Toka ishte pjellore. Ishte mbarë krahina Gikuju, nga njëri horizont që përqafonte qiejt deri te tjetri i fshehur ndër re. Kështu rrëfehej historia në Kameno. Që atëbotë epërsia shpirtërore dhe udhëheqja kishin mbetur aty.

Kamenoja kishte një dëshmi të mirë që e vërtetonte këtë histori. Një zabel i shenjtë kishte mbirë në vendin ku kishin qëndruar Gikuju dhe Mumbi; njerëzit ende e përnderonin. Po ashtu, kushdo që merrte mundimin të numëronte, mund ta shihte se Kamenoja kishte nxjerrë më shumë heronj dhe udhëheqës se çdo kreshtë tjetër. Mugo va Kibiro, profeti i madh gikuju i njëherë e një kohe, kishte lindur aty. Ai ishte rritur duke parë vizione të së ardhmes dhe ua kishte treguar ato njerëzve të shumtë që vinin ta shihnin e ta dëgjonin. Por disa, më cinikë se fqinjët e tyre, nuk pranonin të shkonin tek ai. Ata e quanin mashtrues. Pastaj, një natë, kur njerëzit ishin në gjumë, ai u zhduk prej kodrave. Shpejt erdhën lajme për të nga viset e përtejme: Nieri, Kiambu, Muranga; nga mbarë krahina Gikuju, në të vërtetë. Ai vazhdonte ta thoshte me zë të lartë mesazhin e tij dhe thërriste: "Do të vijë një popull me rrobat si flutura".

Këta ishin të bardhët.

Por ishte edhe magjistari i madh Kamiri, shtrigëritë e të cilit kishin lënë gojëhapur edhe të bardhët në Muranga. Shtrigëritë dhe magjitë e tij, para se të bardhët ta vinin poshtë me buzëqeshje dhe dhurata, i kishin dhënë famë të madhe. Thuhej se edhe ai kishte lindur në Kameno. Ashtu si Mugoja para tij, edhe ai ishte zhdukur nga kodrat drejt viseve të përtejme. Jeta e ngushtë e kreshtave nuk e mbante dot.

Një tjetër ishte Vaçiori, një luftëtar i madh që kishte udhëhequr gjithë fisin kundër masajve. Në rini kishte vrarë një luan krejt i vetëm. Kur vdiq, në duart e një të bardhi endacak, la një emër të madh, idhull i shumë luftëtarëve të rinj.

***

Kreshtat ishin të izoluara. Njerëzit atje bënin jetën e tyre, pa u trazuar nga çka ndodhte rreth e rrotull. Burrat dhe gratë nuk i trembeshin asgjëje. Ukabit nuk shkonin dot kurrë atje. Do të humbnin nëpër kodra, kreshta e lugina. Madje edhe gikujut e tjerë, nga Nieri apo Kiambu, e kishin të vështirë ta gjenin udhën nëpër kodra. Kështu pra, vendi i kreshtave të shumta qe lënë vetëm, pa u ndikuar nga forcat e turbullta atje jashtë. Ato kodra e kreshta të lashta ishin zemra dhe shpirti i tokës. Ato i ruanin të dëlira dhe të paprekura magjitë dhe ritualet e fiseve. Njerëzit aty gëzonin së bashku, duke i dhënë njëri-tjetrit gjakun dhe ngrohtësinë e të qeshurës së tyre. Ndonjëherë ndesheshin. Po kjo ndodhte mes tyre dhe asnjë i jashtëm nuk duhej ta dinte. Për të huajt ata ishin memecë, nuk nxirrnin asnjë nga të fshehtat, roja të të cilave ishin. *Kagutui ka Mucii gatihakagwo Ageni*; hesapi i shtëpisë nuk del në pazar.

Andej kishin dalë udhëheqësit e vendit. Sepse, ndonëse kreshtat qenë të izoluara, disa njerëz largoheshin. Këta, që kishin guximin të shikonin përtej së tashmes, drejt një jete dhe visesh të përtejme, ishin të përzgjedhurit e paktë që dërgoheshin nga Murungu për të shpëtuar popullin në orën e nevojës: Mugo, profeti i madh; Vaçiori, luftëtari i lavdishëm; Kamiri, magjistari i fuqishëm.

Ata u bënë të huaj për kodrat. Tek e fundit, hesapi i shtëpisë nuk ishte për ta. Ishte për ata që jetonin brenda. Këta ishin njerëzit, gjaku dhe kockat e të cilëve flisnin gjuhën e kodrave. Pemët mbanin vesh, ofshanin me erën dhe heshtnin. Zogjtë dhe bishat dëgjonin e mbanin vesh qetësisht. Vetëm herë pas here jepnin ndonjë kundërpërgjigje, brohoritje gazmore apo ndonjë hungërimë të zemëruar.

SI TA USHQESH MUZËN

Nga Ray Bradbury

S'është e lehtë. Askush s'e ka bërë përgjithnjë. Kush përpiqet më shumë se të gjithë, e tremb për vdekje. Atë që e shpërfill dhe bredh duke fishkëllyer lehtë, ajo e dëgjon duke e ndjekur në heshtje nga pas, e joshur nga një lloj përçmimi i matur dhe i shfaqur me kujdes. Sigurisht që po flasim për Muzën. Termi sot ka dalë nga përdorimi i përditshëm. Na ndodh shpesh që kur dëgjojmë të flitet për të, buzëqeshim dhe në mendje na mësyjnë imazhe të ndonjë perëndeshe të brishtë greke, veshur me rroba të zbukuruara, me harpë në dorë, duke ledhatuar ballin e Skribit që djersin. Muza, pra, është ajo që tmerrohet më shumë nga të gjitha virgjëreshat. Ajo fillon të lëvrij nëse dëgjon një tingull, zbehet nëse i bën pyetje, të kthen shpinën dhe zhduket nëse e ngacmon. Çfarë e shqetëson? - mund të pyesni ju. Pse dridhet ndërsa shikon ngultas? Nga vjen dhe ku shkon? Si mund ta bëjmë që të na vizitojë për një kohë më të gjatë? Cila është temperatura e përshtatshme? Ku blihet ushqimi për të, çfarë cilësie dhe sasie, dhe cilat është orar i darkës? Mund të fillojmë me poezinë e perifrazuar të Oskar Uajldit, ku fjalën "dashuri" e zëvendësojmë me fjalën "art". *Arti fluturon nëse mbahet shumë çlirët/Arti vdes nëse shtrëngohet tepër, /Çlirët, shtrënguar, s'i mund ta di/Nëse po rri apo do të ik?*

Po të doni, fjalën "art", mund ta zëvendësoni me fjalën "aftësi krijuese" ose "nënvetëdije" ose "zjarrmi" cilado qoftë fjala që përdorni për atë që ndodh kur vërtitesh si fugë dhe "shkruan një histori". Një mënyrë tjetër e përshkrimit të Muzës mund të jetë rivlerësimi i njollave të vogla të dritës, atyre flluskave prej ajri para syve, defektet e vogla në lente ose në lëkurën e jashtme të syrit. Të pavëna re për vite me radhë, kur i pikasni për herë të parë, ato mund të kthehen në shqetësim të padurueshëm, të shpërqendrojnë në të gjitha orët e ditës. Pengojnë atë që po shikoni, duke u dalë përpara. Njerëzit kanë shkuar te psikiatri për problemin e "njollave" në sy. Këshilla e pashmangshme: shpërfillini dhe do të zhduken. Fakti është se nuk zhduken, mbeten, por përqendrohemi përtej tyre, te bota dhe objektet gjithnjë në ndryshim, ashtu siç duhet të bëjmë. Kështu ndodh edhe me Muzën tonë. Nëse përqendrohemi përtej saj, ajo s'na del përpara.

Është bindja ime që për ta mbajtur pranë teje një Muzë, së pari duhet ta ushqesh. Se si mund të ushqesh diçka që ende nuk ekziston, është pak e vështirë të shpjegohet. Por ne jetojmë të rrethuar nga paradokse. Një më tepër s'prish punë.

Është kaq e thjeshtë. Gjatë gjithë jetës, duke pirë ujë dhe duke u ushqyer, krijohen qeliza, rritemi, bëhemi më të mëdhenj dhe më thelbësorë. Ajo që nuk ishte, është. Procesi nuk vihet re. Bie në sy vetëm kohë pas kohe. E dimë që po ndodh, por s'e dimë mirë se si dhe pse. Në mënyrë të ngjashme, ne e mbushim veten gjatë një jete me tinguj, pamje, aroma, shije dhe përshtypje të njerëzve, kafshëve, peizazheve, ngjarjeve, të mëdha dhe të vogla. E mbushim veten me këto përshtypje, përvoja dhe reagimin tonë ndaj tyre. Në nënvetëdijen tonë s'regjistrohen vetëm të dhëna faktike por të dhëna reaguese, lëvizja jonë afër ose larg ngjarjeve të ndiera. Kjo është lëndë, ushqim me të cilën rritet Muza. Kjo është depoja, skedari, tek i cili duhet të kthehemi çdo orë kur jemi zgjuar për të kontrolluar realitetin me anë të kujtesës dhe gjatë gjumit për të kontrolluar kujtesën me anë të kujtesës, që do të thotë fantazmën me anë të fantazmës, që të çlirohemi nga e keqja, nëse është e nevojshme.

Çfarë është nënvetëdija për çdo njeri tjetër, në aspektin krijues, për shkrimtarët bëhet Muza. Janë dy emra për një gjë. Por, pavarësisht se si e quajmë, këtu është thelbi i individit që mëtojmë të lartësojmë, ai për të cilin ndërtojmë faltore dhe i thurim lavde në shoqërinë tonë demokratike. Këtu gjendet lënda e origjinalitetit. Sepse kjo lëndë përbëhet nga tërësia e përvojës së regjistruar dhe të harruar, që secilin prej nesh e bën të ndryshëm. Sepse askush s'i sheh të njëjtat ngjarje në të njëjtin rend, në jetën e tij. Dikush e sheh vdekjen më i ri se një tjetër, një njeri e njeh dashurinë më shpejt se një tjetër. Dy njerëz, siç e dimë, kur shohin të njëjtin aksident, e përshkruajnë duke dhënë dëshmi të ndryshme, me një pjesë tjetër të alfabetit të tyre të huaj. E dimë se sa befasues dhe origjinal është çdo njeri, madje edhe më i ngadalti dhe më i mërzitshmi, nëse i drejtohemi si duhet, bisedojmë me të, e pranojmë siç është, dhe më në fund i themi, "Çfarë do në jetë? (Ose nëse është shumë i moshuar, çfarë ke dashur në jetë?) çdo njeri do të flasë për ëndrrën e tij. Dhe kur dikush flet me fjalë që i burojnë nga zemra, në çastin e tij të së vërtetës, flet sikur po krijon poezi.

Kjo më ka ndodhur jo një herë, por një mijë herë në jetën time. Im at dhe unë nuk ishim miq të shkëlqyer, deri shumë vonë. Gjuha, mendimi i tij, nga dita në ditë, nuk ishte e jashtëzakonshme, por sa herë që i thoja, "Babi, më trego për qytetin e Tombstone në Arizona që e ke vizituar kur ke qenë shtatëmbëdhjetë vjeç", ose "për fushat e grurit në Minesota, kur ishe njëzet vjeç", babai fillonte të fliste për ikjen nga shtëpia në të gjashtëmbëdhjetat, tregonte si kishte shkuar drejt perëndimit në fillim të shekullit XX, para se të përcaktoheshin kufijtë e fundit, kur s'kishte autostrada, por vetëm shtigje kuajsh, shina trenash, dhe arkërkuesit mësynin Nevadan.

Muza ishte befas atje për babanë. E vërteta shfaqej lehtë në mendjen e tij. Nënvetëdija thoshte fjalën e saj, e paprekur duke e ndihmuar të fliste rrjedhshëm. Ashtu siç duhet të mësojmë të bëjmë në shkrimet tona. Ashtu siç mund të mësojmë nga çdo burrë, grua ose fëmijë përreth nesh kur të prekur dhe emocionuar, tregojnë për diçka që e deshën ose e urryen sot, dje ose një ditë në të kaluarën e largët. Në një çast të caktuar, siguresa hiqet, dhe shpërthejnë fishekzjarret. Jo në minutën e parë, as në të dytën, as në minutën e tretë, jo, nuk ndodhte kjo te zërit i babait, ritmi i duhur, apo fjalët e duhura vinin pasi kishte biseduar pesë ose gjashtë minuta ndërsa thithte i qetë llullën, atëherë, krejt papritur i shfaqej pasioni i ditëve të hershme, meloditë e dikurshme, moti, pamja e diellit, tingulli i zërave, karrocat që udhëtonin vonë natën, burgjet, udhët e pluhurta që ngushtoheshin pas tij, ndërsa përpara shtrihej horizonti i Perëndimit, të gjitha, të gjitha, ritmi i të ecurit, çasti, çastet e shumta të së vërtetës, dhe, për këtë arsye, poezia.

Po, është tejet e vështirë ta përdorësh gjuhën ashtu siç flitet në këto vende. Por unë kam dëgjuar fermerë që tregonin për korrjet e para të grurit në fermë pasi ishin zhvendosur nga një shtet tjetër, dhe nëse s'ishte Robert Frosti që po fliste, ishte kushëriri i tij, i zhvendosur pesë herë nëpër shtete. Kam dëgjuar inxhinierë lokomotivash që flisnin për Amerikën me tonin e personazheve të Thomas Wolfe i cili udhëtoi mbi kalë nëpër vendin tonë me veprën e tij letrare ashtu si inxhinierët udhëtuan me lokomotiva. Kam dëgjuar nëna që tregonin për natën e gjatë me të porsalindurin e tyre se si kishin frikë se mund të vdisnin bashkë me foshnjën. Kam dëgjuar gjyshen që fliste për ballon e saj të parë kur ishte shtatëmbëdhjetë vjeçe. Dhe kur shpirtrat e tyre ngroheshin, ata ishin të gjithë poetë.

Dua të them se ajo që kemi të gjithë te vetja, ka qenë gjithmonë aty, dhe kaq pak prej nesh mundohen ta vënë re. Kur më pyesin se ku i marr idetë, qesh. Sa e çuditshme, jemi kaq të zënë duke kërkuar mënyra dhe mjete letrare, sa harrojmë të shikojmë brenda vetes. Muza, për t'i shkuar në thelb çështjes, është aty, një depo fantastike, qenia jonë e plotë. Gjithçka që është më origjinale pret që ta nxjerrim prej aty. E megjithatë e dimë që s'është kaq e lehtë. E dimë se sa e brishtë është pëlhura e endur nga etërit, ungjët ose miqtë, të cilëve mund t'u prishet kjo magji e çastit nga një fjalë e gabuar, një derë e përplasur ose një zjarrfikëse që kalon. Kështu, edhe sikleti, vetëdija, kritikat e kujtuara, mund ta pengojnë një person që të jetë gjatë gjithë jetës gjithnjë e më pak i hapur.

Le të themi se secili prej nesh e ka ushqyer veten me jetën, në fillim, dhe më vonë, me libra dhe revista. Dallimi është se shumë ngjarje na ndodhën, dhe me të tjera u detyruam të ushqehemi. Nëse do ta detyrojmë nënvetëdijen të mbajë dietë, si do ta përgatisim menunë? Epo, mund ta fillojmë listën tonë kështu: Lexoni poezi çdo ditë të jetës. Poezia është e mirë sepse i shkrifëron muskujt që s'i përdorni shpesh. Poezia i mpreh shqisat dhe i mban në gjendje të shkëlqyer. Të mban të vetëdijshëm për hundën, syrin, veshin, gjuhën, dorën. Dhe, para së gjithash, poezia është metaforë e ngjeshur ose krahasim. Metafora të tilla, ashtu si lulet japoneze prej letre, mund të zgjerohen në forma gjigande. Idetë janë kudo nëpër libra me poezi, megjithatë sa rrallë kam dëgjuar mësues të shkrimit të prozës t'i rekomandojnë për shfletim.

Tregimi im, "Bregdeti në perëndim", është një fyrit i drejtpërdrejtë i leximit të poezisë së bukur të Robert Hillyer-it që flet për gjetjen e një sirene pranë Plymouth Rock-ut. Tregimi, "Do të bien shira të butë", mbështetet në poezinë me këtë titull të Sara Teasdale-it, dhe pjesa mëe madhe e tregimit përfshin temën e poezisë së saj. Nga poezia e Bajronit, "Dhe hëna do të jetë ende shkëlqimtare", doli një kapitull për romanin "Kronikat Marsiane". Në këto raste, dhe dhjetëra të tjerë, kanë qenë disa metafora që më kanë mbërthyer, më kanë dhënë shtysë dhe janë bërë shkak të krijoj një histori.

Çfarë poezie? Çdo poezi që të rrëqeth. Mos u mundo



shumë. Merre shtruar. Me kalimin e viteve mund të mbërrish te T. S. Elioti, madje edhe të kalosh më tej në endet e tua nëpër fushat e poezisë. Po thua se nuk e kupton Dylan Thomas-in? Po, por nyjet nervore të trurit e përthithin, ashtu si zgjuarsia jote e fshehtë, dhe të gjithë fëmijët e tu të palindur. Lexoje, ashtu siç mund të lexosh me sy lëvizjet e një kali të shpenguar në një livadh të gjelbër, të pa fund, gjatë një dite me erë.

Çfarë tjetër i përshtatet dietës tonë? Librat me ese. Përsëri, zgjidh dhe merr, më të mirët në shekuj. Do të kesh shumë për të marrë duke nisur nga kohët para se eseja të bëhej më pak popullore. Asnjëherë s'i dihet se kur mund të duash të dish përparësitë dhe të bukurën e të qenit këmbësor, si të mbash bletë, si të gdhendësh gurë varri ose rrathë. Ja kur duhet të hiqesh si diletant dhe shpërblehesh për këtë. Në fakt, je duke hedhur gurë në pus. Sa herë që dëgjon një jehonë nga nënvetëdija, e njeh veten pak më mirë. Një jehonë e vogël mund të lind një ide. Një jehonë e madhe mund të japë një histori. Për të lexuar, gjej libra që e përmirësojnë shqisën për ngjyrat, format dhe madhësitë në botë. Pse të mos mësosh për nuhatjen dhe dëgjimin? Personazhet ndonjëherë duhet të përdorin hundët dhe veshët ose mund të përkapin gjysmën e aromave dhe zhumave të qytetit, dhe të gjithë dridhjet pemëve dhe fëshfëritjet në lëndinat e qytetit.

Pse gjithë kjo këmbëngulje për shqisa? Sepse që ta bindësh lexuesin se është aty ku janë personazhet, duhet t'i drejtohesh secilës shqisë të tij, me ngjyra, tinguj, shije dhe cilësi. Nëse lexuesi e ndien diellin në mishin e vet, dhe era ia lëkund mëngët e këmishës, gjysma e luftës është e fituar. Edhe rrëfenjat më të pabesueshme mund të bëhen të besueshme, nëse lexuesi, përmes shqisave, ndihet i sigurt se është midis ngjarjeve. Ai s'mund të refuzojë atëherë, të bëhet pjesë e tyre. Logjika e ngjarjeve gjithmonë ia lëshon vendin logjikës së shqisave. Nëse, sigurisht, s'bëni diçka me të vërtetë të pafalshme për ta hequr lexuesin nga konteksti, të tilla si ngadhënjimi i Revolucionit Amerikan me mitralozë, ose shfaqja e dinosaurëve dhe njerëzve të shpellave në të njëjtën skenë (kanë jetuar miliona vjet larg). Edhe pse, në rastin e dytë, një Makinë Kohe e përshkruar mirë, teknikisht e përsosur mund ta mbajë pezull lexuesin dyshimtar.

Poezi, ese. Po tregimet, romanet? Sigurisht. Lexoni ata autorë që shkruajnë në mënyrën që shpreson të shkruash, ata që mendojnë ashtu siç do të donje të mendoje. Por lexo edhe ata që s'mendojnë dhe nuk shkruajnë ashtu siç do të doje të mendoje dhe shkruaje ti, sepse kështu e nxit mendimin në drejtime të reja. Dhe përsëri, mos lejo që snobizmi i të tjerëve të të pengojë të lexosh Kiplingun, për shembull, edhe nëse askush tjetër nuk e lexon.

Kemi një kulturë dhe jetojmë në një kohë jashtëzakonisht të pasur si me gjepura letrare ashtu si edhe me thesare. Ndonjëherë është pak e vështirë të dallosh gjepurat nga thesari, kështu që përmbahemi. Por meqë duam t'i japim vetes tekste cilësore, për të grumbulluar të vërteta në shumë nivele, dhe në shumë mënyra, për të testuar veten kundrejt jetës dhe të vërtetave të të tjerëve, të ofruara si vizatime komike, shfaqje televizive, libra, revista, gazeta, shfaqje, dhe filma, s'duhet të kemi frikë të shihemi në shoqëri të çuditshme. Unë jam po aq Çarli Çaplin më 1935 sa jam lexuesi-shok i Aldous Huxley-t në 1961. Nuk jam një gjë. Jam shumë gjëra që Amerika ka qenë në kohën time. Kisha aq aftësi të kuptuari sa për të ecur përpara, sa të lëvizja, të mësoja, të rritesha. Dhe kurrë s'ua kam kthyer kurrizin gjërave që më kanë rritur. Kam mësuar nga Tom Swift ashtu si edhe nga George Orwell. Jam kënaqur me Tarzanin e Edgar Rice Burroughs (dhe ende e respektoj atë kënaqësi të vjetër edhe pse s'më bën dot lavazh truri) ashtu siç kënaqem sot me "Letrat e Skrutejpit" të C. S. Lewis-it. E kam njohur Bertrand Russell-in ashtu si edhe Tom Mix-in, dhe Muza ime është rritur nga ajo që ka qenë shumë e mirë, e keqe dhe pa interes. Jam një krijesë e tillë që mund të kujtoj me dashuri jo vetëm



tavanet e Vatikanit të Michelangelo-s por tingujt e lashtë të emisionit radiofonik, "Viki dhe Sad".

Cili është modeli që i mban të gjitha së bashku? Besoj se një gjë i ka mbajtur të gjitha bashkë. Gjithçka që kam bërë, e kam bërë me emocion, sepse doja ta bëja, sepse më pëlqente ta bëja. Mbetet e përhershmja: kërkimi, gjetja, admirimi, dashuria, reagimi i sinqertë ndaj asaj që ke në dorë, pa marrë parasysh sa të turbullta duken një ditë, kur u rikthehesh. Të ushqyerit e Muzës, më duket se është vrapi i vazhdueshëm pas gjërave që i do fort, përballja e këtyre dashurive me nevojat e tanishme dhe të ardhshme, kalimi nga tekstet e thjeshta tek ato më të ndërlikuarat, nga ato naive tek ato me njohuri më të gjera, nga ato jo-intelektuale tek ato intelektuale. Asgjë s'humbet kurrë. Nëse ke përshkuar territore të pamata dhe ke guxuar të duash gjëra pa kuptim, do të kesh mësuar edhe nga sendet më primitive të mbledhur dhe të lëna diku mënjanë. Do të kesh mësuar edhe nga një kureshtje e përhershme për të gjitha artet, nga një progaram i dobët radiofonik, shfaqjet e mira teatrore, nga çerdhet tek simfonitë, nga xhungla deri te "Kështjella" e Kafkës, janë të vërtetat e gjetura, të mbajtura, të shijuara dhe të përdorura më vonë. Të jesh fëmijë i kohës do të thotë t'i bësh të gjitha këto.

Mos hiq dorë, për shkak të parave, nga gjithë ato gjëra që ke mbledhur gjatë një jete. Mos hiq dorë, për shkak të kotësisë së botimeve intelektuale, nga ajo që je, nga ajo që është brenda teje dhe të bën individ, dhe për këtë arsye, të domosdoshëm për të tjerët. Për të ushqyer Muzën, duhet të kesh qenë gjithmonë i uritur për jetën qëkur ishe fëmijë. Nëse s'ke qenë, tani je pak vonë për të filluar. Më mirë vonë se kurrë, natyrisht. A ndihesh gati? Kjo do të thotë se duhet të bësh shëtitje të gjata natën, përreth qytetit ose qytezës tënde, ose shëtitje në fshat gjatë ditës. Dhe shëtitje të gjata, në çdo kohë, nëpër librari dhe biblioteka.

Dhe si ta mbash Muzën është problemi i fundit. Muza duhet të jetë në formë. Duhet të shkruash një mijë fjalë në ditë për dhjetë apo njëzet vjet në mënyrë që të përpiqesh t'i japësh formë, të mësosh mjaftueshëm për gramatikën dhe historinë në mënyrë që këto të bëhen pjesë e nënvetëdijes, pa e kufizuar ose shformuar Muzën. Duke jetuar mirë, duke vëzhguar ndërsa jeton, duke lexuar libra të mirë dhe duke vëzhguar ndërsa lexon, ushqen veten tënde më origjinale. Duke u stërvitur në aftësinë e të shkruarit, me ushtrime të përsëritura, imitime, shembuj të mirë, krijon një vend të pastër dhe plot dritë ku mund ta mbash Muzën. I jep asaj, një hapësirë ku mund të rrijë. Dhe përmes praktikës, e çliron veten aq sa mund ta dallosh menjëherë kur frymëzimi vjen në dhomë.

Për një gjë të jesh i sigurtë: Kur flet dashuria e sinqertë, kur fillon admirimi i vërtetë, kur emocioni rritet, kur urrejtja ngrihet si shtjellë tymi, s'ke pse të dyshosh se krijimtaria do të qëndrojë me ty për gjithë jetën. Thelbi i krijimtarisë duhet të jetë i njëjtë me thelbin e historisë dhe të personazhit kryesor në historinë që po shkruan. Çfarë dëshiron personazhi yt, cila është ëndrra që ka, çfarë forme ka ajo ëndërr dhe si shprehet sepse kjo është dinamoja e jetës së tij, dhe jetës tënde si Krijues. Mu në çastin kur shpërthen e vërteta, e nënvetëdijshmja nxjerr një engjëll që shkruan në një libër të artë. Hidh sytë nga vetja, atëherë. Mendo për gjithçka me të cilën e ke ushqyer veten për vite me radhë. A ka qenë një banket apo një dietë urie? Cilët janë miqtë e tu? A të besojnë? Apo bëhen pengesë të rritjes tënde me tallje dhe mosbesim? Nëse s'ke miq, dil dhe gjej ca.

Dhe së fundmi, a je stërvitur mirë që të mund të tregosh atë që do të tregosh? A ke shkruar aq sa të jesh i çlirët dhe të lejosh që e vërteta të shfaqet pa u tjetërsuar nga qëndrimet e vetëdijshme dhe pa u ndryshuar nga dëshira për t'u bërë i pasur? Të ushqehesh mirë do të thotë të rritesh. Të punosh mirë dhe vazhdimisht do të thotë të mbash në gjendje të mirë atë që ke mësuar dhe ditur.

Përvojë. Punë. Këto janë dy anët e medaljes, të cilat kur rrotullohen s'janë as përvojë, as punë, por çasti i zbulesës. Monedha, prej iluzionit optik, bëhet glob i rrumbullakët, i ndritshëm, rrotullues i jetës. Është çasti kur dera e oborrit hapet lehtas dhe një zë flet. Të gjithë mbajnë frymën. Zëri ngrihet dhe ulet. Babai tregon për vitet e tjera. Një fantazmë ngrihet nga buzët e tij. Nënvetëdija trazohet dhe fërkon sytë. Muza shket nëpër fierin poshtë oborrit, ku në një ditë vere, djemtë e shpërndarë në lëndinë, dëgjojnë. Fjalët bëhen poezi që askujt s' i shkon mendja se janë të tilla, sepse askush s'ka menduar t'i quajë ashtu. Koha është tek to. Dashuria është tek to. Historia është tek to. Një njeri i mirë-ushqyer mban dhe ndan qetësisht me të tjerët racionin e vet të përjetësisë. Kjo duket gjë e madhe në një natë vere. Dhe ashtu është, siç ka qenë gjithmonë nëpër epoka, kur ka ekzistuar gjithmonë një njeri që kishte diçka për të treguar, dhe njerëz të tjerë, të qetë dhe të mençur, që kishin dëshirë për të dëgjuar.

Përktheu: EJËLL MIRAKA

MBI 4 MILIONË KOPJE TË SHITURA

JORDAN B. PETERSON

12 RREGULLA PËR JETËN

NJË ANTIDOT NDAJ KAOSIT

‘Një nga mendimtarët më të rëndësishëm që është shfaqur pas shumë vitesh në skenën botërore.’ SPECTATOR

Minerva